



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



RAPORT VJETOR

Gjendja e Sektorit te Energjise dhe Veprimtaria e ERE-s gjate Vitit 2010

Permbajtja e lendes

- Treguesi i figuravefaqe 5
- Treguesi i tabelavefaqe 6
- Hyrjefaqe 8

Pjesa e Pare

Analize e Gjendjes ne Sektorin e Energjise

Funksioni rregullator dhe struktura e funksionimit

te ERE-s.....faqe 11

I- Rregullimi ne tregun e energjise elektrike

1. **Tregu i energjise elektrike**.....faqe 12
2. **Prodhimi i energjise elektrike**.....faqe 14
 - 2.1. Prodhimi publik i energjise elektrike.....faqe 14
 - 2.2. Mbi kriteret e shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike
Ne kaskaden e lumit Drin.....faqe 19
 - 2.3. Prodhimi energjise elektrike nga TEC-i i Vlores.....faqe 22
 - 2.4. Prodhimi privat i energjise elektrike.....faqe 23
 - 2.5. Eficienca e prodhimit te energjise elektrike.....faqe 27
3. **Konsumi i energjise elektrike**.....faqe 31
 - 3.1. Kerkesa per energji elektrike.....faqe 31
 - 3.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike.....faqe 34
 - 3.2.1.Pesha specifike e energjise se konsumuar ne cdo zone
te OSSH-se.....faqe 37
 - 3.3. Profili i konsumit te energjise elektrike.....faqe 38
 - 3.4. Importi i energjise elektrike.....faqe 40
 - 3.5. Eficienca e konsumit te energjise elektrike.....faqe 43
4. **Operatori i Sistemit te Transmetimit**.....faqe 48
 - 4.1. Struktura e Operatorit te Sistemit te Transmetimit.....faqe 48
 - 4.2 **Operatori i Sistemit te Shperndarjes**.....faqe 49
 - 5.1. Struktura e Sistemit te Shperndarjes.....faqe 50
5. **Siguria e furnizimit me energji elektrike**.....faqe 51

Kapitulli i II

1. Aktiviteti i ERE-s ne fushen e gazit natyror gjate vitit 2010

1. Aktiviteti i ERE ne fushen e gazit natyror gjate vitit 2010.....faqe 54
2. Zhvillimet nderkombetare ne sektorin e gazit natyror dhe efekti ne zhvillimet e ketij sektori ne vendin tone.....faqe 54
 - 2.1 Zhvillimet gjeopolitike dhe ekonomike te lidhura me sektorin e gazit natyror ne BE, zonen e detit Kaspik dhe rajonin Ballkanik.....faqe 55

3. Risi teknologjike. Gazi i Argjilave nje mundesi potenciale per furnizimin e vendit me gaz natyror qe ka nevoje per studimefaqe 59
4. Mbeshtetja e projekteve me interes dhe e perpjekjeve te kompanive te interesuara per investime ne infrastrukturen e gazit natyror ne vendin tone. fq59
5. Arritjet e ERE ne sektorin e gazit natyror gjate vitit 2010 dhe sfidat per te ardhmenfaqe 60
- 5.1 Zhvillimi i kuadrit rregullator.....faqe 60
- 5.2 Zhvillimi i marredhenieve me partneret dhe ndjekja e zhvillimeve te sektorit.....faqe 60
- 5.3 Sfida per te ardhmen per zhvillimin e sektorit te gazit natyror.....faqe 61

Pjesa e Dyte

Analize Veprimtarise se Entit Rregullator te Energjise

Funksioni rregullator dhe struktura e funksionimit te ERE-s

- 1.1 Struktura Organizative dhe menyra e funksionimit te ERE-s.....faqe 64
- 1.1.1 Bordi i Komisionerevefaqe 64
- 1.1.2 Stafi i Ekspertizes Teknike.....faqe 65
- 1.1.3 Stafi Mbeshtetes.....faqe 65
- 1.2 Trajtimi i Burimeve Njerezore te ERE-s.....faqe 66
- 1.3 Administrimi i burimeve financiare te ERE-s.....faqe 66

2.Veprimtaria e ERE-s per Cmimet dhe Tarifate e Energjise Elektrike

- 2.1 Cmimet dhe tarifate e energjise elektrike per vitin 2010.....faqe 68
- 2.1.1 Metodologjite dhe procedurat e percaktimit te cmimeve e tarifavefaqe 68
- 2.1.2 Tarifa e prodhimit te energjise elektrike per KESH sh.a.....faqe 68
- 2.1.3 Tarifa e energjise elektrike per Furnizuesin Publik me Shumice.....faqe 69
- 2.1.4 Cmimi i energjise elektrike per HEC-et egzistues deri 10 MW.....faqe 71
- 2.1.5 Cmimi i energjise elektrike per HEC-et e rinj deri 15MW.....faqe 71
- 2.1.6 Tarifa e sherbimit te transmetimit te energjise elektrike.....faqe 72
- 2.1.7 Tarifa e sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike dhe e Furnizuesit Publik me pakice per konsumatorin tarifore per vitin 2011.....faqe 73
- 2.18 Cmimet dhe tarifate e energjise elektrike ne tregun e BE-se, viti 2009...faqe 77

3 Veprimtaria e ERE-s ne sektorin e Licencimit per vitin 2010

- 3.18 Licensimi ne veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike.....faqe 79
- 3.19 Licensimi ne veprimtarine e tregimit te energjise elektrike.....faqe 81

4 Veprimtaria e ERE-s ne monitorimin e Tregut te Energjise Elektrike

- 4.1 Monitorimi i Tregut te Energjise Elektrikefaqe 82
- 4.1.1 Parimet e monitorimit te tregut te energjise elektrike.....faqe 82
- 4.1.2 Monitorimi i KESH-Gjenerimit.....faqe 83
- 4.1.3 Monitorimi i CEZ Shperndarje.....faqe 83
- 4.1.4 Monitorimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit.....faqe 83

5 Veprimtaria e ERE-s ne sektorin Juridik dhe Mbrojtjes se Konsumatorit

5.1	Aktet nenligjore te miratuara nga ERE	faqe 84
5.1.1	Rregullat dhe procedurat e shitjes se Energjise Elektrike	faqe 85
5.1.2	Rregullat per alokimin e kapaciteteve te Interkonjeksioneve	faqe 85
5.1.3	Rishikimi i kontrates se furnizimit me Energji Elektrike te klienteve tarifore.....	faqe 86
5.1.4	Standartet e cilesesi se furnizimit me energji elektrike.....	faqe 86
5.1.5	Mbi dhenien e statusit te klientit te kualifikuar	faqe 87
5.1.6	Amendimet ne legjislacionin primar ne sektorin e energjise.....	faqe 87
5.1.7	Trajtimi i Proceseve Gjyqesore.....	faqe 88
6	Mbrojtja e konsumatorit nga efekti monopol i tregut	
6.1	Parimet e mbrojtjes se konsumatorit.....	faqe 89
6.1.1	Garantimi i cilesise se sherbimit te shperndarjes dhe furnizimit te energjise elektrike.....	faqe 89
6.1.2	Sigurimi i Transparences.....	faqe 89
6.1.3	Garantimi i Aksesit te paleve te treta ne rrjet.....	faqe 90
6.1.4	Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave te konsumatoreve.....	faqe 90
7	Mardheniet me publikun dhe median.	
7.1	Procedurat e informimit publik.....	faqe 93
7.1.1	Mardheniet me mediat e shkruara dhe vizive.....	faqe 93
7.1.2	Komunikimi nepermjet ngjarjeve dhe aktiviteteve.....	faqe 94
7.1.3	Komunikimi me pjestaret e tregut	faqe 94
7.1.4	Komunikime te brendshme.....	faqe 95
7.1.5	Publikime Institucionale.....	faqe 95
7.1.6	Komunikime ne web.....	faqe 95
8	Marredheniet nderinstitucionale dhe nderkombetare te ERE-s	
8.1	Konferenca per 15 vjetorin e ERE-s.....	faqe 96
8.2	Veprimtaria nderinstitucionale dhe nderkombetare e ERE-s.....	faqe 96
8.2.1	Marredheniet e ERE-s me Kuvendin e Shqiperise.....	faqe 97
8.2.2	Marredheniet e ERE-s me METE-n.....	faqe 97
8.2.3	Marredheniet e ERE-s me Ministrine e Integrimit.....	faqe 98
8.2.4	Marredheniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrences	faqe 98
8.2.5	Marredheniet e ERE-s me Avokatin e Popullit.....	faqe 98
8.2.6	Marredheniet nderkombetare.....	faqe 98
8.2.7	Marredheniet multilaterale te ERE-s.....	faqe 99
8.2.8	Marredheniet bilaterale te ERE-s.....	faqe 100
8.2.9	Pjesmarrje ne konferenca dhe aktivitetet nderkombetare. faqe	100

Pjesa e Trete

Veprimtaria Financiare e ERE-s gjate vitit 2010 dhe Raporti i Auditit kontabel te rregjistruar	faqe 101
---	-----------------

Pjesa e Katert

Perfundime dhe Rekomandime.....faqe 108

Pjesa e Peste

VI-Anekse

Aneks-1- Organograma e funksionimit te ERE-s.....	faqe 113
Aneks-2- Sistemi Elektroenergjetik i Republikes se Shqiperise.....	faqe 115
Aneks-3- 4 Zonat e shperndarjes se CEZ Shpendarje.....	faqe 117
Aneks-4- Regjistri i plote i licencimeve te realizuara nga ERE.....	faqe 119
Aneks-6- Vendimet e Bordit te Komisionereve gjate vitit 2010.....	faqe.123

Treguesi i Figurave

Figura 1.1. Struktura e Modelit Shqiptar te Tregut.....	faqe 12
Figura 1.2 Skema e Sistemit Elektroenergjetik.....	faqe 13
Figura 2.1 Grafiket e Prodhimit ditor te energjise elektrike per vitet 2007-2010.....	faqe 15
Figura 2.2. Prodhimi i Energjise Elektrike ne Shqiperi	faqe 16
Figura 2.3. Prodhimi mujor i Energjise Elektrike.....	faqe 16
Figura2.4. Prodhimi Vjetor i HEC-eve te Sistemit Elektroenergjetik	faqe 17
Figura 2.5 Oret e Punes se HEC-eve te Sistemit Energjetik 2005-2009.....	faqe 18
Figura 2.6. Ecuria e Prodhimit te Energjise Elektrike, sasise se ujit dhe konsumit specifik pergjate viteve 2002-2010.....	faqe 19
Figura 2.7 Grafiket e prodhimit ditor te energjise elektrike per vitet 2007-2010	faqe 20
Figura 2.8 Grafiket e rezerves hidroenergjetike ditore per vitet 2009-2010	faqe 21
Figura 2.9 Prodhimi i Energjise elektrike nga TEC Vlore gjate vitit 2010....	faqe 22
Figura 2.10.Ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjel dhene me koncension dhe private.....	faqe 24
Figura 2.11 Prodhimi i Energjise Elektrike per vitin 2010 nga HEC-et private dhe koncensionet e reja.....	faqe 25
Figura 2.12 Te ardhurat nga shitja e energjise elektrike	faqe 26
Figura 2.13 Cmimi mesatar per HEC-et private me koncension dhe koncensionet e reja	faqe 27
Figura 2.14 Shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskades se Drinit.....	faqe 29
Figura 2.15 Shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskades se Drinit.....	faqe 29
Figura 2.16 Eksporti i Energjise Elektrike gjate vitit 2010.....	faqe 30
Figura 3.1. Konsumi i pergjithshem i energjise elektrike ne vite.....	faqe 31
Figura 3.2 Konsumi mujor i energjise elektrike.....	faqe 32
Figura 3.3 Dinamika e Pikut te Ngarkeses ne Shqiperi (MWh).....	faqe 32
Figura 3.4 Bilanci Energjetik 2010.....	faqe 33
Figura3.5 Konsumi i energjise elektrike sipas kategorive te konsumatoreve..	faqe 34
Figura3.6 Struktura e shitje te energjise elektrike sipas cmimeve.....	faqe 35

Figura 3.7	Struktura e shitjes se energjise elektrike sipas nivelit te tensionit...	faqe 35
Figura 3.8	Konsumi familjar ndaj konsumit total ne vite.....	faqe 36
Figura 3.9	Shperndarja e numrit te konsumatoreve sipas fashave te konsumit mujor.....	faqe 37
Figura 3.10	Pesha specifike e konsumit sipas nenzoneve.....	faqe 37
Figura 3.11	Grafiket ditore per ngarkesen maksimale dhe minimale te vitit 2010.	faqe 38
Figura 3.12.	Grafiku i ngarkesave mesatare mujore gjate vitit 2010.....	faqe 39
Figura 3.13	Ballanca Export-Import i Energjise Elektrike.....	faqe 40
Figura 3.14	Importi i Energjise Elektrike.....	faqe 41
Figura 3.15	Ecuria e Treguesve te prodhimit vendas dhe importit te energjise elektrike gjate 2002-2010.....	faqe 41
Figura 3.16	Grafiku i sasise se importit te energjise elektrike	faqe 42
Figura 3.17.	Cmimi mesatar i importit te energjise elektrike.....	faqe 42
Figura 3.18	Vlera e importit te energjise elektrike	faqe 43
Figura 3.19	Arketimet, humbjet dhe efektiviteti i shitjes	faqe 44
Figura 3.20	Ecuria e humbjeve ne sistemin e shperndarjes.....	faqe 44
Figura 3.21	Humbjet Totale kundrejt energjise se futur ne rrjet.....	faqe 45
Figura 3.22	Faturim Arketim 2002-2010.....	faqe 46
Figura 3.23	Arketimet, humbjet dhe efektiviteti i shitjes	faqe 46
Figura 3.24	Ecuria e Furnizimit me energji elektrike perkundrejt ndalesave te energjise elektrike per periudhen 2002-2010.....	faqe 47
Figura 6.1.	Struktura e cmimeve te energjise elektrike per konsumatorët familjare, viti 2010.....	faqe 75
Figura 6.2	Cmimi mesatar i energjise elektrike.....	faqe 75
Figura 6.3.	Cmimet e energjise elektrike te konsumatoreve jo-familjare te vendeve te BE-s viti 2008.....	faqe 77
Figura 6.4.	Cmimet e energjise elektrike te konsumatoreve familjare te vendeve te BE-s viti 2009.....	faqe 78

Treguesi i Tabelave

Tabela 2.1.	Struktura e centraleve te prodhimit publik te energjise elektrike.....	faqe 14
Tabela 2.2.	Struktura e prodhimit te energjise elektrike nga HEC-et e sistemit energjitik gjate periudhes 2005-2010.....	faqe 17
Tabela 2.3.	Oret e punes te HEC-eve te sistemit energjitik.....	faqe 18
Tabela 2.4	Prodhimi i Energjise nga subjektet private dhe me koncension viti 2010.....	faqe 24
Tabela 2.5	Treguesit e eficences se HEC-eve te sistemit energjitik gjate periudhes 2002-2010.....	faqe 28
Tabela 2.6.	Exporti i Energjise Elektrike per vitin 2010.....	faqe 30
Tabela 4.1	Struktura e OST-se.....	faqe 49
Tabela 5.1	Struktura e OSSH-se.....	faqe 51

Tabela 5.2 Asete qe ka ne dispozicion secila zone.....	faqe 51
Tabela 6.1. Struktura e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2011.....	faqe 76
Tabela 6.2 Konsumi vjetor i energjise elektrike.....	faqe 77
Tabela 7.1 Struktura e licensimit per vitin 2010.....	faqe 78
Tabela 7.2 Karakteristikat e te licensuarve per prodhimin e energjise elektrike per vitin 2010.....	faqe 79
Tabela 7.3 Karakteristikat per shoqerite e licensuara dhe ne proces licensimi per vitin 2010.....	faqe 80
Tabela 7.4 Karakteristikat e te licensuarve per tregtimin e energjise elektrike per vitin 2010.....	faqe 81
Tabela 7.5 Furnizues te Kualifikuar per vitin 2010.....	faqe 81
Tabela 7.6 Kliente te Kualifikuar per vitin 2010.....	faqe 82

Hyrje

Enti Regullator i Energjise (ERE) ne zbatim te ligjit nr.9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, date 30.06.2008 “Per sektorin e gazit natyror”, harton kete Raport Vjetor, i cili prezanton dhe analizon gjendjen e sektorit te energjise dhe veprimtarine e ERE-s gjate vitit 2010.

Ky raport i paraqitet per shqyrtim, ne nje seance te posacme, Komisionit te Veprimtarive Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit te Kuvendit te Shqiperise.

Viti 2010 ne sektorin e energjise eshte karakterizuar nga disa vecori te genesishme sikurse eshte furnizimi i plote dhe pa nderprejje me energji elektrike i konsumatoreve, kthimi per here te pare qe nga viti 1998 ne nje vend eksportues neto i energjise elektrike, zgjerimi i metejshe me tregut te energjise elektrike, vleresimi nepermjet nje studimi serioz te nivelit te humbjeve teknike te energjise elektrike, eliminimi i faturimit aforfe te energjise elektrike, percaktimi i cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2011 per seicilen nga strukturat e pjesmaresve te tregut te rregulluar te energjise elektrike si dhe rritja e metejshe me eficiencies ne prodhimin publik te energjise elektrike.

Viti 2010 shenon gjithashtu nje vit te sukseseshem ne pjesmarrjen e investimeve private per ndertimin e burimeve te reja gjeneruese nepermjet futjes ne pune te 5 HEC-eve te dhena me koncension me nje kapacitet total te instaluar mbi 15 MW ose sa 64% e kapacitetit te instaluar te 43 hidrocentraleve ekzistues te privatizuar apo te dhena me koncension.

Nga pikpamja elektroenergjetike viti 2010 vleresohet si nje vit i jashtezakonshem hidrologjik ku u arrit prodhimi rekord historik i energjise elektrike prej 7.74 TWh., ku KESH sh.a realizoi gjithashtu nje eksport energjie elektrike mbi 2.9TWh dhe nje bilanc pozitiv shkembimi me Republikën e Kosoves.

Raporti eshte organizuar nga pikpamja e permbajtjes ne 5 pjese, ne disa kapituj dhe permban 5 anekse.

Ne pjesen e pare trajtohet analiza e gjendjes se sektorit te energjise ne Shqiperi, ku nje vemendje i vecante i kushtohet analizes se prodhimit te energjise elektrike, konsumit dhe importit dhe eficiencies ne te gjitha keto veprimtari. Nepermjet nje informacioni te bollshem te trajtuar kryesisht ne forme grafike paraqitet situata aktuale ne tregun e energjise elektrike ne Shqiperi por edhe zhvillimet historike dhe prirjet e zhvillimit te tyre ne te ardhmen.

Me rendesi eshte te theksohet se raporti nuk eshte konceptuar vetem si nje dokument informues i situates elektroenergjetike, por ai i ben nje analize te plote kesaj suate dhe zhvillimeve te ndryshme duke arritur ne perfundime dhe rekomandime te rendesishme si per menaxheret e sektorit ashtu edhe per vendim-marresit ne nivel qeveritar.

Ne pjesen e pare te raportit jepen te dhena dhe informacion lidhur me veprimtarine e operatoreve te sistemit te transmetimit dhe te shperndarjes si dhe trajtohen problemet e sigurise se furnizimit te konsumatoreve me energji elektrike.

Ne nje kapitull te vecante jane trajtuar problemet e gazit natyror. Nepermjet nje veshtrimi rajonal dhe global te situates nderkombetare ne projektet e furnizimit dhe diversifikimit me gaz te vendeve te Evropes Jud-lindore dhe te BE-se, raporti jep nje analize realiste dhe objektive te interesave te vendit tone ne kontekstin e zhvillimeve nderkombetare. Ne sektorin e gazit natyror Raporti permban informacion edhe per nivelet e larta vendim-marese te shtetit per situaten konkrete te gazifikimit te mundshem te ekonomise shqiptare.

Ne raport evidentohet gjithashtu puna e kujdeseshme qe po kryhet ne ERE ne bashkepunim te ngushte me konsulencen e financuar nga USAID-i per hartimin e nje kuadri rregullator ne sektorin e gazit natyror, bashkekohor dhe ne perputhje te plote me legjislacionin e BE-se.

Ne pjesen e dyte, raporti paraqet dhe analizon punen e ERE-s ne veprimtarite themelore te saj, perfshire veprimtarite e Bordit te Komisionereve, te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, licensimit te veprimtarive te sektorit te energjise elektrike, monitorimit te tregut dhe te licensuarve, veprimtarine juridike dhe te mbrojtjes se konsumatorit, mardheniet e ERE-s me publikun, me institucionet brenda vendit dhe ne arenen nderkombetare si dhe per burimet njerzore.

Ne nje pjese te vecante raporti i kushtohet administrimit te burimeve financiare te EREs si dhe raportit te nje auditi te pavarur kontabel.

Ne menyre te permbledhur, ne pjesen e katert jane paraqitur konkluzionet qe ERE ka evidentuar nga analiza nepermjet ketij raporti dhe rekomandimet per nje permiresim te metejshem te punes ne sektorin e energjise.

Se fundi, ne pjesen e peste, jane paraqitur 5 anekse me grafike dhe tabela qe i bashkelidhen permbajtjes se raportit.

Raporti eshte hartuar me pjesmarrjen dhe kontributin e te gjitha Drejtorive te ERE-s dhe i eshte nenshtruar nje nje analize te kujdeseshme ne mbledhjen e Bordit te Komisionereve te ERE-s te dates 21 Shkurt 2010 ku me vendimin nr.14, u be edhe miratimi i tij.

Pershendetje e Kryetarit te ERE-s

I nderuar lexues,



Viti 2010 per Entin Rregullator te Energjise perfaqeson vitin e 15te te krijimit te tij. ERE eshte nga te paret rregullatore ne sektorin e energjise, ne te gjithe vendet e Europes Lindore.

15 vjet veprimtari jane karakterizuara me perballimin me sukses te shume sfidave. Se pari, sfida per te kapercyer mentalitetet e trasheguara ne ndarjen institucionale te pergjegjesive per krijimin e nje rregullatori te pavarur. Se dyti, koncepti rregullator ne treg futej per here te pare ne vendin tone dhe per pasoje, nuk kishte tradite dhe gjithshka niste nga fillimi.

Me kete rast e ndjej per detyre te kujtoj me respekt, kryetaret e nderuar te ERE-s

ne vite, Zotin Agim Nashi, Zotin Engjell Çuçi dhe Zotin Pjeter Dema, se bashku me Bordet e Komisionereve, perkatesisht per periudhat 1995-1998, 1998- 2004 dhe 2004-2006 gjat te cilave ne kushte fillimisht te veshtira, por me mbeshtetje dhe vizione te qarta te qeverive te kohes, krijuan dhe me tej konsoliduan nje institucion me profil gjithnje e me te qarte transparent, te paanshem dhe te pavarur.

Me pas, me privatizimin e sektorit te shperndarjes te energjise elektrike ne vitin 2008 dhe me perfshirjen e nje numri te madh te licensuarish ne veprimtarite e sektorit te energjise, ERE prezantohet si nje institucion me tipare te spikatura te transparences, pavaresise dhe kompetences profesionale, te vleresuara keto jo vetem nga opinioni publik i vendit tone, por dhe nga institucionet nderkombetare qe asistojne sektorin e energjise.

Konferenca nderkombetare e organizuar nga ERE me 7 Tetor 2010, ne kuader te 15 vjetorit te krijimit te ERE-s, ne te cilen moren pjese personalitete te shquar te fushes rregullatore si dhe 20 kryetare Autoritetesh Rregullatore nga Europa e me gjere, ishte nje eveniment qe prezantoi me dinjitet jo vetem nivelin e sotem te

institucionit rregullator ne sektorin e energjise, por edhe te progresit qe Shqiperia ka bere ne kete sektor.

Per te gjithë kete rruge te sukseseshme 15 vjecare, i shprehim mirenjohjen e thelle, per mbeshtetjen shume te fuqishme qe na ka dhene ne menyre te vecante USAID-i duke na asistuar ne menyre te vazhdueshme me ekspert nga me te shquarit ne fushen e energjise. Falenderojme gjithashtu edhe institucionet e tjera nderkombetare si Banken Boterore, IFC, BERZH, KfW etj per asistencen e cmuar ne perballimin me sukses te sfidave te zhvillimit.

Viti 2010, shenon historikisht, nje vit te jashtezakonshem nga pikpamja hidroenergjetike. Viti 2010 eshte viti ne te cilin u arrit prodhimi dhe eksporti rekord i energjise elektrike, nje vit gjate te cilit kapacitetet hidroenergjetike u shfrytezuan ne menyre efience dhe nje vit qe e shnderroi vendin tone ne eksportues neto te energjise elektrike pas shume vitesh.

Me gjithë permiresimet modeste ne fushen e efektivitetit te konsumit te energjise elektrike, sektori i energjise vazhdon te perjetoje nje veshtiresi lidhur me humbjet e energjise elektrike dhe ne menyre te vecante me ato qe quhen humbje jo teknike si dhe me nivelin e ulet te arketimeve te faturave te konsumit te energjise elektrike.

Viti 2010 shenon per sistemin energjetik nje arritje te rendesishme, me perfundimin dhe futjen nen tension, te linjes ajrore te interkoneksionit 400 kV, me kapacitet transmetues 1,000 MW Elbasan – Tirane - Podgorice dhe pergatitjes per ndertimin e linjes tjetere te interkoneksionit, me te njejtin kapacitet, Shqiperi-Kosove.

Ne kete raport, qe i paraqitet Kuvendit te Shqiperise, behet nje analize me e thelluar dhe me e plote e gjendjes se sektorit te energjise si dhe e veprimtarise se Entit Rregullator te Energjise gjate vitit 2010.

Konkluzionet dhe rekomandimet e paraqitura ne kete raport, shprehin ne menyre te koncentruar, disa nga aspektet me te qenesishme te zhvillimeve te derisotme te sektorit te energjise si dhe te vizionit per zhvillimet e ardheshme te ketij sektori te rendesishem per ekonomine e vendit.

Pershendetje,

Bujar Nepravishta

Pjesa e Pare

Analize e Gjendjes ne Sektorin e Energjise

Funksioni rregullator dhe struktura e funksionimit te ERE-s.

Struktura dhe menyra e organizimit dhe funksionimit te Entit Rregullator te Energjise eshte e mbeshtetur ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003, "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9946, date 30.6.2008 "Per Sektorin e Gazit Natyror".

ERE eshte nje person juridik publik, me seli ne Tirane dhe perbehet nga Bordi i Komisionereve me nje Kryetar dhe 4 antare, te cilet kane funksion vendim-marres dhe emerohen nga Kuvendi i Shqiperise. Pervec Bordit eshte edhe personeli teknik i organizuar ne 4 drejtori dhe perkatesisht ne Drejtorine e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut, Drejtorine e Cmimeve dhe Tarifave, Drejtorine Juridike, te Mbrojtjes se Konsumatorit dhe te Mardhenieve me Publikun si dhe Drejtorine e Administrate, Finances dhe Burimeve Njerzore.

Aktualisht ne ERE punojne gjithesej 32 punonjes, nga te cilet 4 jane punonjes ndihmes. I tere personeli teknik gezon statusin e Nepunesit Civil.

Ne Aneks-1- eshte paraqitur bllok-skema e strukture organizative te ERE-s se bashku me numurin perkates te punonjesve.

ERE e ushtron veprimtarine e vet ne perputhje me ligjet "Per Sektorin e Energjise Elektrike" dhe "Per Sektorin e Gazit Natyror" dhe eshte autoriteti i vetem rregullator ne Shqiperi ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.

ERE si nje institucion i pavarur ne sektorin e energjise, ushtron pergjegjesite e veta ne keto drejtime kryesore:

- Ne licensimin e shoqerive qe kryejne veprimtari ne sektorin e energjise elektrike apo te gazit natyror.
- Ne percaktimin e tarifave te shitjes me pakice ose me shumice te energjise elektrike si dhe te tarifave per lidhjen dhe hyrjen ne rrjetet e gazit natyror dhe te hapsirave te depozitimit apo te instalimeve te gazit natyror te lenget.
- Ne mbrojtjen e interesave te konsumatoreve ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.
- Ne monitorimin dhe kontrollin e kontratave dhe sherbimeve te te licensuarve dhe sigurise se furnizimit ne sektoret e energjise.
- Ne miratimin e kodeve te funksionimit te rrjeteve dhe te matjes si dhe te rregulloreve apo akteve te tjera nenligjore ne sektoret e energjise.
- Ne nxitjen e efciences, konkurences dhe permiresimin e cilesise se sherbimit ne sektoret e energjise.

Burimet e financimit te ERE-s perbehen nga pagesat e regullimit te te licensuarve dhe nga pagesat e licencave ne sektoret e energjise.

ERE paraqet brenda 31 Marsit te cdo viti ne Kuvend, nje raport vjetor per gjendjen ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror si dhe te veprimtarise te ERE-s, perfshire veprimtarine financiare dhe auditimin e veprimtarise financiare te saje.

Bordi i Komisionereve te ERE-s



Zj. Entela Shehaj



Z. Ardian Haçi



Z. Abaz Aliko



Z. Shkelqim Bozgo

Personel mbështetës i Bordit te Komisionereve



Z. Petrit Ahmeti
(Keshilltar i Bordit)



Zj. Zerina Pulaha
(Sekretare e Bordit)



Z. Zija Kamberi
(Konsulent i AEIA)



Z.. Ralph Zarumba
(Konsulent i AEIA per tarifat)



Kapitulli i Pare

Rregullimi ne tregun e energjise elektrike.

1. Tregu i energjise elektrike:

Tregu i energjise elektrike ne Shqiperi funksionon ne baze te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike i miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.338, date 09.03.2008. Ky model eshte hartuar ne zbatim te Direktivave te Bashkimit Evropian per energjine elektrike si dhe te kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjise te vendeve te Evropes Juglindore, per krijimin e Tregut Rajonal te Energjise Elektrike.

Modeli Shqiptar i Tregut eshte konceptuar per te shpene perpara politikat e Qeverise Shqiptare per reformimin e sistemit elektroenergjetik dhe vecanerisht per privatizimin e sektorit te shperndarjes se energjise elektrike ne nje periudhe afatshkurter. Ai ka per qellim gjithashtu te krijojte nje treg te thjesht te rregulluar, transparent dhe te balancuar te energjise elektrike, mbi bazen e kontratave dypaleshe.

Nje parim i rëndesishem i Modelit te Tregut, i cili mbron ne menyre te drejteperdrejte klientet tarifore dhe rrit sigurine e furnizimit te tyre me energji elektrike, eshte parimi i perdorimit te prodhimit te energjise elektrike prej burimeve hidro ne favor te klienteve tarifore. Ky parim eshte specifik per kushtet e Shqiperise, ku mbi 95% e prodhimit vendas te energjise elektrike realizohet nga HEC-et egzistues me kosto shume te ulet.




Figura 1.1.

(Burimi ERE)

Objektiva te tjera te rëndesishme qe synon te arrije Modeli i Tregut jane edhe permiresimi i efciences se energjise si dhe qendrushmerise financiare te sektorit

elektroenergjetik nepermjet sigurimit te nje shkalle te larte informacioni tregu si dhe te nje strukture te qarte per transaksionet e tregut elektroenergjetik.

Ne figuren -1.1.- eshte paraqitur bllok-skema e struktures se tregut te energjise elektrike.

Per te pasur nje ide me te qarte grafike, mbi skemen parimore elektrike te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve dhe kufijt e juridiksionit te seiciles shoqeri publike qe operon ne sistemin elektroenergjetik te vendit tone, KESH-Gen.sh.a, OST sh.a. dhe CEZ-Shperndarje sh.a, (ose gjenerimi, transmetimi dhe Shperndarja), ne figuren -1.2.- eshte paraqitur nje skeme parimore ilustrative.

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figura 1.2.

(Burimi ERE)

Eshte me vlere te theksohet nje tipar tjeter i rendesishem i Modelit te Tregut, qe konsiston ne kerkesen e tije se te gjitha perfitimet e realizuara nga te

licensuarit duhet te shkojne ne dobi te klienteve tarifore. Ky princip i rendesishem eshte mbajtur ne konsiderate nga ERE edhe ne vleresimin e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2011.

2. Prodhimi i energjise elektrike

Prodhimi i energjise elektrike realizohet nga shoqerija publike KESH- Gen dhe nga prodhuesit privat te cilet jane pronare te centraleve elektrike si dhe nga prodhuesit privat te cilet e kane marre me koncension nga shteti centralin elektrik, ose kane nenshkruar mareveshje koncensionare me Qeverine per ndertimin dhe shfrytezimin e centraleve te rinj.

2.1. Prodhimi publik i energjise elektrike

Prodhimi publik i energjise elektrike kryhet nga Shoqeria Aksionere KESH-gen me 100% te aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqeria “TEC-Vlora” gjithashtu me 100% te aksioneve nga shteti, e cila eshte pjese e holdingut KESH.

Struktura e centraleve elektrike te prodhimit publik eshte paraqitur ne Tabelen -2.1 - ku fuqia e pergjitheshme e instaluar arrin ne 1,531 MW, nga te cilat fuqia e instaluar e HEC-ve eshte 1,433 MW dhe e TEC-eve 98 MW. Duke marre parasysh edhe fuqine e pergjitheshme te instaluar te prodhuesve private te energjise

Karakter. e Centralit	Centrali								
	HEC Fierz	HEC Koman	HEC V.Dejes	HEC Ulez	HEC Shkopet	HEC Bistric 1	HEC Bistric 2	HEC Lana- bregas	TEC Vlore
Nr. Agregat.	4	4	5	4	2	3	1	2	2
Fuqia e Agregat. MW	125	150	50	6.3	12	7.7	5	2.5	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	25	24	24	5	5	98
Fuqia Totale MW	1,531								

Tabela 2.1.

(Burimi KESH sh.a.)

elektrike prej 42 MW, fuqia e pergjitheshme e instaluar ne vendin tone rezulton 1573 MW. Ne kete vleresim nuk eshte marre ne konsiderate TEC-i i Fierit, mbasi ai eshte hequr nga shfrytezimi qe ne vitin 2008, si central me rendiment shume te ulet.

Prodhimi publik i energjise elektrike ne vitin 2010 u realizua kryesisht, ose ne masen 96.3% nga centralet hidroelektrike (HEC-et) dhe vetem 3.7% nga TEC-i i Vlores.

Gjate vitit 2010 prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga shoqerite publike te gjenerimit ka qen 7,555.506 Milion kWh, kurse prodhimi total qe merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 159.04 Milion kWh arrin ne 7,743.295 Milion kWh (7.743 TWh)

Viti 2010 nga pikpamja hidrologjike vleresohet si nje vit i jashtezakonshem, me prurje me shkalle sigurie rreth 2%, gje qe ka ndikuar pozitivisht ne prodhimin e energjise elektrike ne vend, duke arritur prodhimin rekord te te gjitha kohrave ne Shqiperi.

Ne menyre grafike, ecuria e prodhimit ditor te energjise elektrike gjate vitit 2010 si dhe krahasimi i tije me prodhimin ditor te viteve 2007, 2008, dhe 2009 eshte paraqitur ne grafikun e figures -2.1-




Figura 2.1.

(Burimi OST)

Prodhimi ditor pik, i vitit 2010 eshte shenuar ne daten 18 Prill me 29.994 milion kWh. Ky prodhim eshte realizuar vetem nga hidrocentralet ne administrim te KESH sh.a., kapaciteti i instaluar i te cileve eshte 1433 MW. Per kete prodhim koha e shfrytezimit me kapacitetin maksimal te instaluar, per cdo agregat ne te gjitha HEC-et, rezulton 20.91 ore ne 24 ore pune ose nje koeficient ngarkese maksimale 0.87. Treguesi i kohes se shfrytezimit me ngarkese maksimale per vitin 2010 rezulton $T=5349$ ore, ose nje koeficient shfrytezimi me ngarkese maksimale per vitin 2010 $K_{ng}=0.61$. Me perjashtim te muajve Korrik, Gusht dhe Shtator, ne gjith pjesen tjeter te vitit koeficienti i shfrytezimit te ngarkeses maksimale rezulton mbi 0.78, cka perfaqson nje rekord jo vetem per Shqiperine por dhe ne shkalle Evropiane dhe me gjere, mbasi koeficient te tille jane karakteristik kryesisht per TEC-et ose centralet nuklear.

Pervec kushteve shume te favorshme hidrologjike, nje rekord i tille eshte arritur ne saje te nje koeficienti maksimal gadishmerije te 25 aggregateve te HEC-eve. mbasi koeficient te tille jane karakteristik kryesisht per TEC-et ose centralet nuklear.

Prodhimi ditor minimal gjate vitit 2010 eshte realizuar ne daten 30 Shtator me 6.432 Milion kWh, ose 4.66 here me pak se prodhimi ditor maksimal.

Ne grafikun e figures 2.2. eshte paraqitur prodhimi i energjise elektrike ne vendin tone gjate periudhes 1985 deri ne 2010. Sikurse vihet re nga ky grafik, prodhimi i vitit 2010 eshte prodhimi me i madh historik.

Per periudhen 2007-2010 ERE ka evidentuar ne menyre te detajuar te dhenat e prodhimit te energjise elektrike per cdo dite te seicilit vit. Nga krahasimi i prodhimit te energjise elektrike gjate periudhes 2007 – 2010 verehen ndryshime jashtezakonisht te medha. Prodhimi me i ulet vjetor gjate kesaj periudhe eshte ai i




Figura 2.2. (Burimi KESH,OST)

vitit 2007 me 2,918 milion kWh ose me nje prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndersa prodhimi me i madh eshte ai i vitit 2010 me 7,743.295 milion kWh ose me nje prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndermjet ketyre dy prodhimeve ekstremale arrin ne 2.7 here. Nje tregues i tille shpreh ne menyre sinjifikative shkallen e larte te riskut ne stabilitetin e prodhimit te energjise elektrike nga sistemet elektroenergjetike te mbeshtetur vetem ne HEC-e.

Ne keto kushte ERE thekson edhe nje here, se sa i rendesishem eshte realizimi i integritimit te dy sistemeve energjetike komplementare, atij te Republikes se Shqiperise, i bazuar pothuaj teresisht ne HEC-e dhe atij te Republikes se Kosoves i bazuar pothuaj teresisht ne TEC-e me qymyr.




Figura 2.3. (Burimi KESH,OST)

Eshte e rendesishme te theksohet se ne keto sisteme kostot e prodhimit te energjise elektrike jane nga me te ultat, cka e ben me shum interes per te dy vendet integrimin ne nje sistem unik energjetik mbas ndertimit te linjes se interkoneksionit 400 kV Shqiperi-Kosove

Ne grafikun e figures -2.3. – eshte paraqitur per krahasim prodhimi publik i energjise elektrike per vitet 2007, 2008 dhe 2009. Ne krahasim me vitin 2008 prodhimi i vitit 2009 eshte rritur me 36% kurse ne krahasim me vitin 2007 ka nje rritje prej 2.7 here.

Nje analize me e hollesishme per prodhimin publik te energjise elektrike per vitin 2010 dhe per gjithe periudhen 2005-2010 konsiston ne evidentimin e prodhimit dhe te kohes se punes per cdo agregat te hidrocentraleve te ketij sektori.

Tabela-2.2.-

Viti	Fierze	Koman	V.Dejes	Ulez	Shkopet	Bistrice-1	Bistrice-2
	Prodhimi TWh						
2005	1.86	2.187	0.927	0.121	0.058	--	--
2006	0.94	2.119	0.952	0.107	0.032	--	--
2007	0.69	1.199	0.630	0.071	0.034	--	--
2008	1.07	1.551	0.817	0.092	0.079	0.119	0.119
2009	1.54	2.000	1.082	0.126	0.102	0.137	0.137
2010	2.29	2.420	1.510	0.150	0.120	0.130	0.04

Ne tabelen -2.2- jane paraqitur sasite e prodhuara nga seicili hidrocentral, kurse ne figuren -2.4. jane paraqitur grafikisht keto parametra.




Figura 2.4.

(Burimi KESHsh.a.)

Ne figuren -2.5 – eshte paraqitur koha totale vjetore e punes se seicilit HEC dhe ne tabelen -2.3- eshte paraqitur ne vecanti edhe koha e punes vjetore per cdo agregat te seicilit central.

Nje dukuri e rendesishme ne punen e hidrocentraleve te sistemit, vecanerisht per vitin 2010, i cili ka qen nje vit hidrologjik i jashtezakonshem, ka qene gadishmerija shume e larte e te gjithë agregateve te centraleve. Me te drejte mund te themi se te gjithë agregatet e sistemit jane shfrytezuar sikur te ishin agregate te termocentraleve, ne saje te shkalles se larte te gadishmerise. Eshte me rendesi te theksohet se ne saje te kesaj gadishmerije eshte bere e mundur qe mos te derdhet asnje pike uji nga turbinat e centraleve pa ju marre me pare energjia.

Tabela -2.3.-

Viti	Fierze	Koman	V.Deje s	Ulez	Shkopet	Bistrice- 1	Bistrice- 2
Ore Pune							
2005	18,580	16,261	19,556	21,324	6,141	18,060	8,300
Mesatare per agregat	4,645	4,065	3,911	5,331	3,070	6,020	8,300
2006	14,753	18,388	22,216	19,430	10,832	23,598	7,924
Mesatare per agregat	3,688	4,597	4,443	4,857	5,416	7,866	7,924
2007	8,435	10,826	15,385	14,430	7,036	25,757	1,584
Mesatare per agregat	2,108	2,706	3,077	3,607	3,518	8585	1,584
2008	11,312	13,477	20,681	17,323	8,606	22,887	5,042
Mesatare per agregat	2,828	3,369	4,136	4,330	4,303	7,629	5,042
2009	15,636	13,121	20,770	22,015	11,215	25,408	8,221
Mesatare per agregat	3,909	3,280	4,154	5,503	5,607	8,469	8,221
2010	21,994	20,735	33,676	26,411	13,519	25,668	8,004
Mesatare per agregat	5498	5,183	6,735	6,602	6,759	8,556	8,004




Figura 2.5.

(Burimi KESHsh.a.)

Nje dukuri tjeter e rendesishme, eshte edhe evidentimi ne vecanti i kohes

shume te larte te punes ne agregatet e HEC-it te Bistrices, ne dallim nga HEC-et e tjere. Kjo dukuri vjen si pasoje e faktit se lumi i Bistrices krijohet nga nje burim natyror dhe ndikohet me pake nga pellgu ujembledhes i reshjeve atmosferike, ne dallim nga lumenjte Drin dhe Mat ku pellgu ujembledhes nga reshjet atmosferike ka rolin kryesor.

Nje tregues me rendesi i efektivitetit te funksionimit te HEC-eve eshte edhe analiza qe i behet konsumit specifik te ujit per prodhimin e energjise elektrike qe shprehet ne (m³uje/kWh) dhe qe gjate periodhes 2008 – 2010 shenon efektivitetin me te larte.




Figura 2.6.

(Burimi OSTsb.a.)

2.2. Mbi kriteret e shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike ne kaskaden e lumit Drin.

Shkarkimet e ujit nga portat e HEC-eve jane nje dukuri qe haset ne kushtet e prurjeve te medha te ujit te cilat rrezikojne rritjen e nivelit pertej nivelit kritik te lejuar qe lidhet me sigurine e diges. Ky lloj shkarkimi eshte i ligjshem, por nuk mund te perligjen ato shkarkime te cilat behen nepermjet turbinave duke mos marre energji elektrike per shkak te mosgadishmerise ne pune te agregateve apo ato shkarkime qe mund te kryhen krahas importit te energjise elektrike nga KESH-i.

Per fat te mire keto dukuri i perkasin te kaluares, mbasi qe nga viti 2007 e deri me sot nuk eshte vertetuar asnje lloj shkarkimi i kesaj natyre.

Sikurse dihet HEC-i i Fierzes eshte nje central me rregullim vjetor te prurjeve, cka ndikon drejtpersdrejti dhe ne prodhimtarine e HEC-eve te Komanit dhe te Vaut te Dejes te cilet furnizohen me uje nga prurjet e rregulluara te HEC-it te Fierzes.

Ne figuren 2.7. jane paraqitur grafikisht per cdo dite te vitit 2010 niveli i ujit ne metra, ne rezervuarin e Fierzes si dhe prurjet ditore ne m³/sek, te lumit Drin ne

ketë rezervuar. Gjithashtu janë paraqitur për krahasim edhe nivelet ditore të ujit dhe prurjet ditore për çdo vit të periudhës 2007 – 2010.




Figura 2.7.

(Burimi OSTsh.a.)

Sikurse vihet re me lehtësi diferencat midis prurjeve të vitit 2010 me prurjet e viteve paraardhës janë shumë të mëdha, çka e bën vitin 2010 një vit të jashtëzakonshëm, me probabilitet rreth 2% për të përket kushteve hidrologjike.

Pamvaresisht këtyre kushteve të jashtëzakonshme hidrologjike manaxhimi i nivelit të ujit në rezervuarin e Fierzes, është trajtuar me kujdes, në mënyrë që të absorbohej prej këtij baseni sasija maksimale e mundshme e prurjeve për të zvogeluar efektet negative në kaskadë për të përket përmbytjeve në zonën e Shkodrës, por duke respektuar nga ana tjetër kushtet e sigurisë së digave.

Në grafikun e figurës -2.8- është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike për çdo ditë të vitit 2010 si dhe për krahasim janë paraqitur përkatesisht edhe grafikët e viteve 2008 dhe 2009.

Sikurse vihet re, kriteret e përpunimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge, ato janë mbështetur në tre parimet themelore të Rregullores së Shfrytëzimit të Digave, të cilat konsistojnë:

- Respektimin e kushteve të sigurisë së digave.
- Shfrytëzimin optimal të rezervës hidroenergjetike.
- Minimizimin e efekteve të përmbytjes.

Ne kete veshtrim egzistenca e Kaskades se Drinit ka luajtur nje rol moderator ne perpunimin e prurjeve dhe per pasoje mund te themi se ne se kjo kaskade nuk do te egzistonte, efektet e permbytjes do te ishin shume me te renda.




Figura 2.8.

(Burimi OSTsh.a.)

Ne mendimin inxhinerik, persa i perket teorise se rregullimit ditor dhe vjetor te prurjeve ne nje kaskade, sherben si model baze rregullimi, ai qe mbeshtetet pergjithesisht ne prurjet me shkalle sigurije ose probabilitet rreth 70%. Mbi kete baze ndertohet modeli i perpunimit vjetor te rezerves hidroenergjetike ne menyre te tille qe te realizohet nje shfrytezim me eficience te larte i kesaj rezerve, ose me fjale te tjera te merret sasija maksimale e energjise elektrike.

Ne projektimin e veprave hidroenergjetike, pra edhe ne HEC-et e kaskades se lumit Drin eshte parashikuar qe kanali i terheqies se ujit ne HEC-in e rjedhes me te poshteme (ne rastin tone ne HEC-in e Vaut te Dejes) te jete me nje shkalle te larte sigurije ndaj ndikimit ne mjedisin rrethues.

Por kjo shkalle sigurije kompromentohet ne se ne kanalin e shkarkimit behen ndertime urbane, demtohen pritrat mbrojtese apo ndodhin koincidenca te tjera negative, per shkak te bashkeveprimit te ndersjellte te faktoreve topografik me ata detar te batice-zbaticave etj. Ne se kjo situat bashkeshoqerohet edhe me prurje te jashtezakoneshme, te cilat zakonisht jane shume te rralla, ose me probabilitet shume te ulet, padyshim qe pasojat ne permbytjen e mjedisit rrethues e me gjere do te jene te renda, sikurse ndodhi ne vitin 2010.

Kriteri themelor qe percakton nivelin e sigurise nga permbytjet eshte kriter ekonomiko-social. Ne kushtet konkrete te mjedisit urban ne rajonin e shkarkimit te prurjeve te kaskades duhet te behet vleresimi i prurjeve maksimale te lejuara ne kete shkarkim (nga HEC-i i Vaut te Dejes) ne menyre qe te mos kete permbytje.

Per kete nivel prurjesh percaktohet shkalla e probabilitetit nga te dhenat shumevjecare hidrologjike si dhe modeli i shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike. Kuptohet qe sa me e larte te jete shkalla e sigurise nga permbytjet aqe me e ulet do te jete sasija e energjise elektrike te prodhuar, mbasi rezervat hidroenergjetike ne basenet e HEC-eve dhe vecanerisht ne rezervuarin e Fierzes do te mbahen te uleta.

Percaktimi i ekuilibrit prurje-permbytje dhe permiresimi i metejshem i ketij faktori shoqerohet me investime per te rritur sigurine nga permbytjet, por nga ana tjetere ndikon ne zvogelimin e prodhimit te energjise elektrike nga kaskada.

Studimi mbi baza shkencore i kesaj dukurije do ti sherbeje rritjes se sigurise nga permbytjet por do te parandaloje edhe kalimin ne ekstremin tjetere te krijimit te rezervave te pastudjuara ne basenet e HEC-eve.

Ne keto kushte, duke mare shkas nga permbytjet e vitit 2010, kryesisht ne ultesiren e Shkodres dhe Lezhes mendojme se do te ishte me rendesi qe ne balancimin e te gjitha faktoreve me ndikim ne permbytjet te konsideroheshin edhe kriteret e Rregullores se Shfrytezimit te Digave.

Ndermarja e vendimit nga ana e Qeverise, qe ndertimi i HEC-it te Skavices ti shtohet burimeve publike te energjise elektrike, eshte pa dyshim nje nisme qe do te kete efektivitet jo vetem ne rritjen e prodhimit vendas te energjise elektrike por edhe ne absorbimin ne nje shkalle me te madhe te prurjeve ne rjedhen e siperme te Drinit, cka do te ishte gjithashtu nje faktor i ndjeshem ne rritjen e shkalles se sigurise nga permbytjet.

2.3. Prodhimi i energjise elektrike nga TEC-i i Vlores

Gjate vitit 2009 perfunduan punimet per ndertimin e TEC-it te Vlores dhe ne fund te vitit filloi testimi i tij. Ne grafikun e figure 2.9. eshte paraqitur prodhimi i realizuar nga ky TEC per cdo dite gjate vitit 2010.

Gjate kesaj periudhe TEC-i prodhoi 28.7 milion kWh energji elektrike dhe me pas u ndal, per shkak te nje zgjidhjeje jo shume te pershtateshme te skemes se furnizimit me uje nga deti per ftohjen e kondensatit. Ky difekt po trajtohet nga investitori per nje zgjidhje te sigurte pa shkakuar ndonje kosto shtese per KESH-sh.a.




Figura 2.9.

(Burimi KESH sh.a. OSTsh.a.)

ERE, tarifen per TEC-in e Vlores per vitit 2010 e ka caktuar ne nje vlefte te tille qe ky subjekt te blente ne treg karburantin e nevojshem prej 43,439 ton naftes diesel, me nje vlere te pergjitheshme prej 3.1 miliard leke, ne menyre qe te

lejonte, sipas kërkeses se tije, prodhimin e 245 milion kWh energji elektrike, sasi kjo per ushtrimin e garancise te pajisjeve teknologjike. Per shkak te ketij shpenzimi, kostua e Furnizuesit Publik me Shumice u rrit nga 1.6 lek/kWh qe ishte ne vitin 2009 ne 2.03 lek/kWh ne vitin 2010. Ne rast se nuk do te ishte parashikuar ky shpenzim, cmimi i FPSH do te ishte 1.45 lek/kWh.

Duke qen se per arsyet e permendura me larte u prodhua vetem 28.7 milion kWh, dhe karburanti mbeti gjendje, kostua e FPSH u zvogelua nga 2.03 qe ishte ne vitin 2010 ne 1.48 lek/kWh per vitin 2011.

Sikurse dihet, ky TEC eshte i projektuar dhe konstruktuar qe te punoj me gaz natyror, por aktualisht ka perdorur si lende djegese nafte diesel, mbasi ende nuk eshte realizuar furnizimi i Shqiperise me gaz natyror, per pasoje kostua e prodhimit te energjise elektrike prej tij eshte shume me e larte se ajo e HEC-eve egzistues, mbasi cmimi i naftes ne tregjet nderkombetare, sikurse dihet, eshte teper i larte. Megjithate duhet te theksojme se ai i sherben ne radhe te pare rritjes se sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike, ne kushtet kur devize e sektorit elektroenergjetik ne Shqiperi, qe nga viti 2008, eshte bere furnizimi pa nderprerje, gjate gjithe vitit, i konsumatoreve me energji elektrike.

TEC-i i Vlores ka te instaluar dy turbina nga te cilat njera turbine me gas dhe tjetra klasike me avull me presion te larte dhe me prodhimtari, perkatesisht 70% dhe 30% te kapacitetit te pergjithshem nga seicili agregat.

2.4. Prodhimi privat i energjise elektrike

Struktura e prodhimit privat te energjise elektrike eshte paraqitur ne menyre te permbledhur ne tabelen -2.4- Aktualisht jane ne prodhim 51 hidrocentrale nga 19 shoqeri private dhe koncensionare, me fuqi te pergjitheshme te instaluar prej 25,874 kW dhe me nje prodhimtari te pergjitheshme per vitin 2010 prej 159.04 milion kWh ose 2.0 % e prodhimit te pergjithshem te vitit 2010.

Ne tabelen 2.4. eshte paraqitur prodhimi mujor i energjise elektrike gjate vitit 2010 nga 19 shoqerite koncensionare dhe private qe kane ne administrim ose pronesi 51 hidrocentrale me fuqi deri 15 MW. Kurse ne grafikun e figures -2.11- eshte paraqitur prodhimi vjetor i energjise elektrike nga seicili prej 51 HEC-eve me fuqi deri 15 MW.

Gjate vitit 2010 u futen ne shfrytezim 5 HEC-e te rinj (Tervoli, Hidro-Albania, Bishnica1, Dishnica dhe Lubonja) me fuqi te pergjitheshme te instaluar prej 16.1 MW dhe nje prodhim prej 41.8 Milion kWh ose sa 26.3% e prodhimit te pergjithshem te vitit 2010 nga HEC-et deri 15 MW.

Prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga HEC-et deri 15 MW arriti ne 159.04 Milion kWh, nga 89.31 Milion kWh qe ishte ne vitin 2009, ose me nje rritje prej 78.1%, nga e cila 46.8 % eshte realizuar nga HEC-et e rinj te futur ne shfrytezim vetem gjate vitit 2010.

Ne grafikun e figures 2.10. eshte paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjel (deri 15 MW) gjate periudhes 2004 – 2010. Te terheqin vemendjen tempet e larta te rritjes se prodhimit nga HEC-et e dhen me koncension mbas vitit 2008.

PRODIMI ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SUBJEKTET (PRIVAT/KONCESION) VITI 2010														(MWh)
Nr.	Subjektet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1	Marjakaj sh.p.k	76	74	79	71	30	0	0	0	0	29	83	145	586
2	WTS Energji sh.p.k	85	78	74	82	77	68	0	0	0	12	26	44	546
3	Selce sh.p.k	149	160	238	272	128	176	101	0	56	176	156	165	1,778
4	Maksi Elektrik sh.p.k	94	108	118	91	101	96	0	0	151	45	93	97	996
5	Spahiu Gjanc sh.p.k	0	0	0	1,359	1,147	999	1,510	1,536	505	0	850	722	8,628
6	Wonder Power sh.a	1,261	1,386	1,543	1,505	1,563	1,429	732	185	0	708	1,122	1,506	12,940
7	Amal sh.p.k	101	120	150	160	169	147	143	118	92	84	108	55	1,445
8	EMIKEL sh.p.k	449	502	417	544	544	532	402	206	374	359	356	332	5,016
9	Favina sh.p.k	543	516	544	556	577	535	0	0	569	386	531	445	5,202
10	Juana sh.p.k	42	39	27	42	30	42	24	0	60	48	47	58	459
11	Sarolli sh.p.k	57	35	65	60	66	49	42	0	53	52	49	60	589
12	Projeksion Energji sha	140	103	121	190	177	140	108	75	58	93	210	99	1,515
13	Albanian Green Energy sh.p.k	3,831	4,427	5,023	4,261	3,465	3,011	2,211	1,315	2,021	2,609	3,215	4,913	40,302
14	Balkan Green Energy sh.p.k	3,418	3,186	3,909	4,108	3,672	3,688	2,156	947	1,230	3,596	3,716	3,564	37,189
15	HEC-i TERVOL-it	0	2,182	4,395	4,322	4,078	2,276	1,725	513	1,250	4,098	4,298	6,458	35,596
16	HIDRO ALBANIA ENERGY	0	284	300	286	293	282	280	401	286	222	224	207	3,065
17	Hec Bishnica 1,2 sh.p.k	0	0	0	0	0	0	0	0	517	717	725	836	2,795
18	DISHNICA ENERGJI sh.p.k	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	70	109	179
19	ELEKTRO LUBONJA sh.p.k	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	215	215
Totali		10,245	13,201	17,003	17,909	16,116	13,470	9,434	5,295	7,223	13,235	15,879	20,030	159,040

Tabela -2.4-

(Burimi ERE)

Per te nxitur nismen private per investime ne ndertimin e HEC-eve te rinj me koncension, me fuqi deri ne 15 MW, Qeveria ka autorizuar KESH-in qe te bleje te gjithë energjine elektrike te prodhuar prej tyre, me cmim te miratuar nga ERE, sipas nje formule nxitese.




Figura 2.10.

(Burimi ERE.)

Pamje nga HEC-i i ri i Tervalit i dhen me koncension



Pamje nga HEC-i i ri i Bishnices i dhen me koncension






Figura 2.11.

(Burimi ERE.)

Ne grafikun e figures 2.12. jane parqitur te ardhurat e arketuara nga subjektet private per shitjen energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et me fuqi deri 15 MW, e cila per vitin 2010 arriti ne mbi 1.1Miliard leke, kundrejt 580.5 milion leke ne vitin 2009, ose 75% me shume.

Ne strategjine e sektorit te energjise, Qeveria Shqiptare ka percaktuar si perparesi te saje, shfrytezimin e potencialit te madh hidroenergjetik te vendit ende te pashfrytezuar. Per te nxitur nismen private per investime ne ndertimin e HEC-eve te rinj me koncension, me fuqi deri ne 15 MW, Qeveria ka autorizuar KESH-in qe te bleje te gjitha energjine elektrike te prodhuar prej tyre, me cmim te miratuar nga ERE, sipas nje formule nxitese e cila i referohet cmimeve mesatare te importit te energjise elektrike plus nje bonus 10%. Diferencimi ne cmim ndermjet HEC-eve privat egzistues dhe atyre qe ndertohen te rinj eshte arsyetuar me ndryshimin e madh ne vleften e investimeve ndermjet ketyre dy kategori objektsh.

Gjate vitit 2009 e ne vazhdim, per shkak te uljes se kerkeses per energji elektrike ne shkalle boterore, si pasoje e krizes ekonomike globale u zvogeluan ne menyre te theksuar cmimet e energjise elektrike ne tregun nderkombetar, e per pasoje edhe cmimet e importit te saje nga vendi yne. Ne keto kushte cmimi i energjise elektrike per HEC-et me koncension deri 15 MW, nga 9.27 lek/kWh qe ishte ne vitin 2009, u zvogelua ne 6 lek/kWh ose me 54.5% me pak, kur ne te njejten kohe cmimi per HEC-et privat egzistues per shkak te vleresimit te cmimit sipas nje metodologjie tjeter, u rrit nga 6.5 lek/kWh ne 7.4 lek/kWh ose me 13.8% me shume.




Figura 2.12.

(Burimi KESH sh.a.)

Ne keto kushte politika nxitese e Qeverise, nepermjet zbatimit te formule qe lidhet me cmimin e importit, u zbeh dhe u pa e arsyeshme qe ne zbatim te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike te ndryshuar te ngarkohet ERE per ti propozuar Kshillit te Ministrave nje metodologji te re llogaritjeje.

Ne figuren 2.13. paraqitet ecurija e cmimeve te HEC-eve me kapacitet deri 15MW, gjate periodhes 2004 deri 2010.




Figura 2.13.

(Burimi ERE)

Gjate vitit 2010 ERE hartoi nje studim per vleresimin e cmimit te unifikuar te HEC-eve me kapacitet deri 15 MW, pavaresisht nga natyra e pronesise. Studimi mori ne analize 4 metoda llogaritjeje dhe vleresoi si optimale metoden e bazuar ne kostot mesatare marginale, te mbeshtetur ne analizen e 80 HEC-eve te ketyre kapaciteteve. Studimi u publikua ne Web-in e ERE-s dhe nga grupet perkatese te interesit u shprehen shume mendime. Problemi themelor nga sygjerimet e paraqitura qendron ne marrjen ne konsiderate te impaktit qe sjell ne cmimet e konsumatoreve fundor penetrimi ne sistem i ketyre HEC-eve per nje periudhe 15 vjecare, si dhe permiresimet ligjore ne kuadrin legal egzistues.

2.5. Eficiencia e prodhimit te energjise elektrike

Karakteristikat e eficiences se prodhimit te energjise elektrike burojne se pari nga natyra e burimeve gjeneruese. Ne nje sistem energjetik, si ky i yni, ku e gjithë energjia elektrike, ose ne rastin e pergjithshem, kur pjesa kryesore e saj, prodhohet nga hidrocentralet, eshte me rendesi te evidentohen tiparet themelore te ketij sistemi prej nga rjedhin me pas edhe perpaesite dhe te metat e tij.

Ne analizen tone jane marre ne konsiderate keto tipare themelore:

- aftesija e akumulimit te energjise elektrike ne forme rezerve potenciale hidroenergjetike,
- aftesija per rregullimin e prurjeve ne menyre vjetore.
- optimizimi i kombinimit te prodhimit me importin e energjise elektrike.
- fleksibiliteti i larte ndaj ngarkeses, cka i lejon te mbuloje lehtesisht pikun e ngarkeses,

- varesija e theksuar e prodhimit te energjise elektrike nga kushtet hidrologjike te motit.
- Shkarkimet e ujit nga rezervuaret.
- Investime relativisht me te medha per ndertimin e tyre dhe kohe me e gjate per perfundimin dhe fujen e objektit ne shfrytezim ne krahasim me TEC-et
- Shpenzime me te vogla shfrytezimi dhe mirembajtje.

Bazuar ne informacionet ditore per situaten elektroenergjetike ne vend, ERE cdo dite e ka ndjekur kete situate dhe e ka reflektuar ate grafikisht ne menyre qe te analizoje dhe te vleresoje eficiencen e shfrytezimit te kaskades hidroenergjetike.

Ne tabelen -2.5- paraqiten te dhena krahasuese per cdo vit te periudhes 2002 – 2010 ndermjet treguesve qe ndikojne drejtepersedrejt ne vleresimin e eficiences se prodhimit te energjise elektrike.


Sikurse vihet re, pamvaresisht se viti 2010 ka qen nje vit i jashtezakonshem nga pikpamja hidrologjike, ERE veren se performanca e KESH-gen ne shfrytezimin e rezerves hidroenergjetike te kaskades se lumit Drin ka qene e kenaqeshme. Konsumi specifik i ujit prej 1.20 m³/kWh tregon se uji eshte shfrytezuar me efikasitet te larte.

Emertimi	Viti								
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5,201	7,702
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1,884	1,911
Çmimi mesatar i importit (Euro/MWh)	30.18	30.15	35.57	40.04	47.81	69.00	79.00	48.69	45.50
Vlera e Importit (000 Euro)	62.53	28.26	20.17	14.63	30.25	195.13	190.94	91.74	86.95
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300	6,593	6,773
Sasia vjetore e Ujit (Miljard m³)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12	6.00	10.85
Derdhjet vjetore te Ujit (Miljard m³)	0	0	0	0	0	0	0	0	1.96
Konsumi Specifik (m³/kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.4	1.04	1.19	1.20
Ndalesat e energjise (GWh)	960	662	556	664	412	891	200	0	0
Ndalesat e energjise (ore/dite)	4.3	2.9	2.3	2.7	1.6	3.4	0.3	0	0

Tabela – 2.5.-


(Burimi KESH, OST)

Niveli ne rezervuaret e kaskadave, ne dallim nga gjithë vitet e mepareshme, eshte administruar ne kushte tejet te veshtira, per shkak te kerkenimit qe shkaktonin superplotat, shpesh befasuese, qe synonin arritjen e niveleve kritike nga njera ane dhe kerkenimit qe shkaktonte rritja e detyruar e shkarkimeve ne permbytjen e ultesires se Shkodres e te Lezhes.



Sasija e ujit vetem ne rezervuarin e Fierzes gjate vitit 2010 rezulton te jete 38.9% me e madhe se prurjet rekord te periudhes 2002-2010, qe i perkasin vitit 2004, ose 80.8%me te larta se prurjet e vitit 2009.

Eshte e rendesishme te theksohet se ne saje te gadishmerise se larte te te gjitha agregateve te HEC-eve nuk eshte derdhur uje pa ju marre energji. Te gjitha derdhjet e ujit kan qene te detyruara nga kushtet e sigurise se digave.



Ne figuren 2.14. jane paraqitur ne menyre grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskades se lumit Drin, per seicilin vit te periudhes 2002-2010, kurse ne grafikun e figures 2.15. shkarkimet ne seicilin muaj te vitit 2010, nga kjo kaskade.

Ne rritjen e efektivitetit te shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike ka ndikuar edhe eksporti dhe shkembimi i energjise elektrike ne situatat e prurjeve te medha si dhe ne transaksionet me perfitim ekonomik ndermjet eksportit dhe importit, te kryera nga ana e KESH-it.

Gjate vitit 2010 KESH sh.a. ka shitur energji elektrike ne tregun rajonal te energjise elektrike per shkak te prurjeve te medha dhe transaksioneve fitimprures duke realizuar nje eksport te pergjithshem prej 2.934 TWh.




Figura 2.16. (Burimi KESH sh.a.OSTsh.a.)

Eksportet e realizuara nga KESH sh.a. jane kryer pa cenuar sigurine e furnizimit te panderprere te vendit me energji elektrike.

EKSPORTI ENERGJISE ELEKTRIKE PER VITIN 2010

Tabela -2.6-

KONTRATA	REALIZIMI			
	Periudha Viti 2010	Sasia MWh	Vlefte €	Vlefte Leke pa TVSH
Totali	2,934,226	119,110,286	16,406,308,623	

Ne tabelen 2.6 jane paraqitur te ardhurat e KESH-it nga eksporti i energjise elektrike te cilat rezultojne mbi 16.4 Miliard leke.

ERE gjykon se per nje sistem gjenerues te energjise elektrike kryesisht me HEC-e, dhe vecanerisht me burime te perqendruar ne mbi 80% te prodhimit vjetor ne kaskaden e Lumit Drin, me prurje qe variojne nga 7-8 m³/sek ne mbi 1,500m³/sek, ne Fierze dhe mbi 4,000m³/sek ne Vaun e Dejes, eshte e nevojshme qe njesija e perpunimit te rezerves hidroenergjetike te mbeshtetet nga nje sherbim i kualifikuar dhe i mirepajisur per prognozimin hidrometeorologjik.

Perforcimi i grupit te perpunimit te rezerves hidroenergjetike (ose Grupit te Regjimit) ne kushtet kur egziston nje risk i larte prognozimi hidrologjik per nevoja energjetike, per nje teritor te gjere te pellgut uje mbledhes, ku vetem per lumin Drin arrin rreth 12,000 km², mendojme se do te justifikohet nga dobija qe do te sillte ne parashikimin dhe parandalimin e pasojave te rezikeshme nga situata te renda hidrologjike.

3. Konsumi i energjise elektrike

Viti 2010, shenon ne menyre te plote dhe perfundimtare konsolidimin e furnizimit te panderprere te konsumatoreve me energji elektrike.

Gjate vitit 2010, sikurse edhe gjate vitit 2009, te vetmet nderprerje energjie kane qene vetem ato per shkak te defekteve ne rrjet ose per shkak te remonteve te paralajmeruara.

Duke qen keshtu, edhe viti 2010 shpreh ne menyre objektive nivelin real te kerkeses vjetore per energji elektrike.

3.1. Kerkesa per energji elektrike

Sikurse shprehet dhe me siper, deri ne vitin 2009 nuk ka pasur nje vleresim te besueshem te kerkeses per energji elektrike. Vetem qe nga viti 2008 kur filloj furnizimi i panderprere me energji elektrike u krijuan premiset per te bere nje vleresim real dhe per te planifikuar me objektivitet kerkesen per energji ne vitet pasues.

Ne figuren -3.1.- ne menyre grafike eshte paraqitur konsumi vjetor i energjise elektrike ne Shqiperi per periudhen 1985 deri ne 2010.




Figura 3.1.

(Burimi ERE)

Rritja mesatare vjetore e kerkeses per energji gjate kesaj periudhe rezulton ne vlefte absolute me 161.5 GWh/Vit. Ne periudhen perpara vitit 2008, per shkak te nderprerjeve te programuara te energjise ky tregues nuk eshte real. Duke ju referuar viteve 2008, 2009 dhe 2010 rritja e kerkeses per energji ne vitin 2009 rezulton ne vlefte absolute me 292GWh me shume ndaj vitit 2008, ose me 4.6% me shume, ndersa ne vitin 2010 me 181GWh ose me 2.74% me shume se viti 2009.

Ne figuren -3.2.- eshte paraqitur nje grafik krahasues i konsumit total te energjise elektrike per cdo muaj, perkatesisht gjate periudhes 2007-2010.




Figura 3.2. (Burimi ERE)

Bilanci i pergjithshem energjetik per vitin 2010, ne te cilin merren ne konsiderate pervec prodhimit edhe importet, shkembimet, konsumi dhe humbjet e energjise elektrike ne sistemin elektroenergjetik, eshte paraqitur ne diagramen e figures -3.4 -.




Figura 3.3. (Burimi ERE)

Ne grafikun e figures 3.3- eshte paraqitur piku vjetor i ngarkese per periudhen 1985 – 2010. Piku ne vitin 2010 shenon 1402 MW dhe ne krahasim me kapacitetin e instaluar te sistemit tone energjetik prej 1531 MW (se bashku me TEC-in e Vlores) ose 1433 vetem me HEC-et, rezulton se aktualisht piku i ngarkeses perben 97.7% te kapacitetit te instaluar te sistemit. Ky raport perfaqson nje ekuiliber te brisht ne qenduesmerine dinamike te sistemit tone energjetik, cka shtron nevojten e fuqizimit te sistemit me burime te rendesishme gjeneruese.

BILANCI ENERGITIK I VITIT 2010




Figura 3.4.

(Burimi ERE,OST,KESH,CEZ.)

Ne vitin 2010, sikurse verehet nga grafiku dhe tabela perkatese eshte arritur konsumi me i madh historik ne vendin tone me 6.773 TWh. Tendence e pergjitheshme e konsumit te energjise elektrike eshte rritja vjetore e kerkeses per energji elektrike mesatarisht me rreth 3%.

Krahas rritjes se kerkeses per energji elektrike eshte rritur edhe piku i ngarkeses nga 420 MW ne vitin 1985 ne 1402 MW ne vitin 2010 me nje rritje mesatare vjetore prej 37.3MW.

Pamje nga Konferenca nderkombetare , Tirane 7 Tetor 2010



3.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike shpreh ne menyre te sintetizuar edhe shkallen e zhvillimit ekonomik-industrial te nje vendi. Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar edhe per vitin 2010 perben 54.9% cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar.

Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkese per energji.

Ne figuren -3.5 - eshte paraqitur ne menyre grafike struktura e konsumit te energjise elektrike sipas kategorive te konsumatoreve per vitin 2009 e shprehur ne MWh.

Nje peshe te rendesishme zene ne konsumin e energjise elektrike edhe konsumatorët buxhetor dhe jo buxhetore, te keta te fundit bejne pjese kryesisht ujesjellesit dhe hidrovoret te cilet jane edhe debitoret me te medhej ndaj OSSH-se

Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas cmimeve te energjise eshte paraqitur ne figuren -3.6 - . Edhe ne kete rast konsumatorët familjare (me cmimet perkatese 7 lek/kWh dhe 13.5 lek/kWh) perbejne peshen kryesore ne te ardhurat e OSSH-se.




Figura 3.5.

(Burimi OSSHsh.a.)

Dominanca e konsumatoreve familjare ne konsumin e pergjithshem te energjise ne vend, per pasoje edhe ne dominancen e te ardhurave te OSSH-se, dhe problemet e mprehta qe lindin nga kjo kategori konsumatorësh me humbjet joteknike te energjise, perbejne nje nga faktoret me problematik ne nivelin e cmimeve te nergjise elektrike, qe ka ndjeshmeri te larte sociale dhe qe kerkon zgjidhje te shpejte.




Figura 3.6.

(Burimi OSSH sh.a.)

Ne grafikun e figure 3.7. ku eshte paraqitur struktura e shitjes se energjise elektrike sipas nivelit te tensionit, verehet se ne tensionin e ulet ku jane te lidhur edhe konsumatoret familjare dhe shumica e bizneseve te vogla shitja e energjise elektrike per keta konsumatore eshte dominuese ne krahasim me nivelet e tjera te tensionit.




Figura 3.7.

(Burimi OSSH sh.a.)

Duhet theksuar se simbas nivelit te konsumit sinjifikativ eshte fakti se rreth 71% e gjithe konsumatoreve te vendit i perkasin bllokut te konsumit deri 300kWh/muaj, ose shtresave te popullsisve me te ardhura me te pakta.




Figura 3.8.

(Burimi OSSH sh.a.)

Nje tregues i terthorte i zhvillimit ekonomik te vendit eshte edhe treguesi i ecurise ne vite te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem. Ne figuren -3.8. eshte paraqitur kjo ecuri gjate periudhes 1985 deri ne 2010.

Tendenca e zvogelimit te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem, mbas vitit 2007 eshte nje prirje pozitive e cila lidhet pervec zvogelimit te humbjeve te energjise elektrike edhe me zhvillimin ekonomik te vendit.

Struktura e konsumit te energjise elektrike nga konsumatorët, per cdo interval konsumi per periudhen Janar-Shtator 2009 eshte paraqitur ne Figuren-3.9.-

Vetem 19.46% e konsumatoreve familjare shpenzojne energji te faturuar mbi 300 kWh/muaj.

Analiza e struktures se konsumit sipas fashave te konsumit si dhe sipas numrit te konsumatoreve per cdo fashë konsumi, lejon qe te analizohet me shume hollesi edhe struktura e cmimeve per konsumatorët familjar ne menyre qe te merren ne konsiderate nje numur i madh variantesh dhe te gjendet zgjedhja optimale.




Figura 3.9.

(Burimi OSSH sha.)

3.2.1. Pesha specifike e energjise se konsumuar ne cdo zone te OSSH-se

Struktura e konsumit sipas shtrirjes gjeografike evidenton faktin se 70 % e konsumit te pergjithshem te energjise elektrike kryhet ne ultesiren bregdetare praneadriatike ne zonat Shkoder, Tirane, Durres dhe Fier, ku eshte e perqendruar edhe pjesa me e madhe e popullsise se vendit si dhe e veprimtarive me te rendesishme te biznesit. Ne figuren -3.10.- eshte paraqitur kjo strukture.




Figura 3.10.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Analiza e struktures se konsumit merr rendesi te madhe edhe per percaktimin e perparetive ne manaxhimin me efektivitet te larte te konsumit te energjise elektrike si dhe ne shperndarjen e investimeve .

3.3. Profili i konsumit te energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike ndikon drejtpersedrejt edhe ne profilin e ngarkeses ose te konsumit te energjise elektrike. Ne figuren -3.11- eshte paraqitur profili i konsumit te energjise elektrike ne nje dite dimri (31 Dhjetor 2010), ku eshte shenuar edhe ngarkesa maksimale per vitin 2010 prej 25.83 milion kWh/dite si dhe profili i konsumit ne nje dite vere (15 Maj 2010) qe i perket ngarkeses minimale per vitin 2010 prej 15.29 Milion kWh/dite.

Tipar karakteristik i ketij profili eshte “gropa” e madhe e ngarkeses ndermjet oreve te nates (24 – 7) ndaj oreve te dites. Ne vlefte absolute ajo arrin deri ne 700MW ose 50% e ngarkeses maksimale. Nje profil i tille tregon se punohet pak ne “turnin e trete”.

Ne dallim nga profili i ngarkeses per nje dite dimri, ne profilin e nje dite vere spikat nje pik ngarkese ne oret e mbremjes (20-23) e cila ka te beje kryesisht me intensifikimin e veprimtarise familjare ne keto ore, gjate stines se veres.

Eshte e rendesishme te theksojme se “gropa” e madhe e ngarkeses ne oret e nates krijon nje mundesi te shkelqyer per KESH-in per te kryer transaksione financiare fitimprures nepermjet shitblerjes se energjise elektrike ne bursen rajonale te energjise.




Figura 3.11.

(Burimi ERE,OST)

Blerja naten e energjise elektrike me cmim me te ulet, dhe akumulimi i ujit gjate oreve te nates, per ta perdorur ditën ne oret e pikut, per te prodhuar dhe shitur ne burse me cmimet e pikut, te njejten sasi energjie, perfaqson nje transaksion financiar fitimprures qe rrit eficencen e burimeve tona gjeneruese. Per

te arritur kete, gjate vitit 2010 u bene ndryshime ne ligjin “Per sektorin e energjise elektrike” i ndryshuar, sipas te cilit KESH sh.a. perjashtohet nga ligji “Per prokurimet publike”, per shitblerje te energjise elektrike.

Profili vjetor i konsumit te energjise elektrike eshte paraqitur ne grafikun e figures -3.12.-. Tipari karakteristik i ketij profili eshte simetria thuaje e plote e konsumit dimer-vere. Gjate periudhes se ngrohje prill-shtator ka nje konsum mesatar pothuajse konstant kurse ne tre muajt paraardhes dhe pasardhes ka nje rritje simetrike te ngarkeses e cila spjegohet me ftohjen e motit dhe perdorimin gradual te energjise elektrike per ngrohje.

Perdorimi i energjise elektrike per ngrohje perben nje dukuri tjeter te demeshme te konsumit te energjise elektrike ne vendin tone. Cdo ndryshim i temperatyres se mjedisit reflektohet menjehere ne konsumin ditor te energjise elektrike, pikerisht te efektit nga perdorimi ose mosperdorimi i ngrohjes elektrike te baneses.

Gjate stines se veres, ne muajt korrik dhe gusht mer forme nje pik i ri ngarkese, i cili nga viti ne vit po behet me evident dhe lidhet me perdorimin gjithnje e ne shkalle me te gjere te pajisjeve klimatizuese.

Diferenca e ngarkeses maksimale nga ngarkesa minimale nuk eshte e njetrajteshme gjate gjithe vitit. Per stinen e dimrit kjo diference eshte 200-300 MW, kurse per stinen e veres eshte 100-150 MW.

Ndersa diferenca ndermjet ngarkeses maksimale dimer dhe ngarkeses maksimale vere eshte e rendit rreth 300 MW dhe perben 30% te ngarkeses maksimale. Keto diferenca mendojme se kushtezohen nga dukurija e perdorimit te ngrohjes elektrike te baneses gjate stines se dimrit.




Figura 3.12.

(Burimi OST sha.)

Konsumi maksimal ditor per vitin 2009 eshte regjistruar ne daten 22 Dhjetor ne vleren 24,170 GWh kurse konsumi minimal ditor eshte regjistruar ne daten 28 Qershor me nje vlere 13,908 GWh me nje ndryshim prej 10,262 GWh ose 42% nga konsumi maksimal.

Piku i ngarkeses gjate vitit 2010 eshte regjistruar ne daten 31 Dhjetor 2010 ora 18 me vlere 1402 MW.

3.4. Importi i energjise elektrike.

Ne zbatim te kerkesave te Modelit Shqiptar te Tregut, importet e energjise elektrike per nevoja publike ne vendin tone, kryhen nga dy furnizues publik, ai me shumice (FPSH) ne perberje te KESH-it dhe nga OSSH (CEZ Shperndarje). Ndersa FPSH importon energji per te plotesuar nevojat e klienteve tarimore, OSSH importon energji per te mbuluar humbjet e energjise elektrike ne sektorin e shperndarjeve

Nje vecori karakteristike e importeve te energjise elektrike gjate vitit 2010 eshte fakti se per here te pare qe mbas vitit 1998, ne bilancin e pergjithshem import-eksport, eksportet jane me te medha se importet dhe vendi yne kthehet ne vend eksportues neto i energjise elektrike.

Nje dukuri e tille erdhi si rezultat i kushteve shume te mira hidrologjike dhe koeficientit te larte te gadishmerise se burimeve gjeneruese, cka beri qe nga prodhimi ne vend te mbulohet kerkesa per konsum dhe te eksportohet energji elektrike.

Ne grafikun e figures -3.13- eshte paraqitur bilanci import-eksport i energjise elektrike per periudhen 1985 – 2010. Sikurse vihet re deri ne vitin 1998, (me perjashtim vetem te vitit 1990) vendi yne ka qen nje vend eksportues neto i energjise elektrike.




Figura 3.13.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Ndryshimi i importeve te vitit 2010 ne krahasim me te meparshmit eshte jo vetem i madh ne sasi por dhe ne koncept. Per shkak te kushteve te favorshme hidrologjike, prodhimi vendit ka qen me i madh dhe importe te energjise elektrike jane kryer vetem nga shoqeria CEZ Shperndarje per te mbuluar, ne perputhje me kerkesat e Modelit Shqiptar te Tregut, humbjet e energjise elektrike.

Ne grafikun e figures -3.14.- paraqitet importi i energjise elektrike per cdo muaj te vitit 2010 si dhe krahasimi me perkateset e viteve 2007, 2008 dhe 2009.




Figura 3.14.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Ne figuren -3.15.- ne menyre grafike eshte paraqitur ecurija e prodhimit, importit dhe konsumit te energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2010




Figura 3.15.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Ne grafikun e figures -3.16.- eshte paraqitur ecurija e importeve te energjise elektrike gjate periudhes 2002 deri 2010. Ne se deri ne vitin 2008 importet jane realizuar vetem nga shoqeria KESH, mbas vitit 2008, me privatizimin e shoqerise se shperndarjes, importet jane kryer per mbulimin e humbjeve nga CEZ Shperndarje dhe per furnizimin e konsumatoreve tarifar nga FPSH i shoqerise KESH sh.a. Ne vitin 2010 importe ka kryer vetem CEZ Shperndarje per mbulimin e humbjeve te energjise elektrike, konform kerkeses se Modelit te Tregut.




Figura 3.16. (Burimi ERE,OSSH,KESH)

Eshte sinjifikativ fakti se gjate viteve 2007- 2008 importet e energjise elektrike jane importet me te medha historike. Nje gje e tille reflekton parimin e rendesishem udheheqes te pergjegjesise shteterore per te garantuar me cdo kusht nje furnizim te pandërprere me energji elektrike te konsumatoreve mbasi energjia e munguar ka cmimin me te larte per ekonomine.

Ne figuren -3.17.- jane paraqitur cmimet e importit te energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2010.




Figura 3.17. (Burimi ERE,OSSH,KESH.)

Sikurse vihet re, qe nga viti 2002 dhe deri ne vitin 2008, kur arrijne pikun, cmimet e importit te energjise elektrike kane ardhur vazhdimisht duke u rritur.

Ne vitin 2008 ne krahasim me vitin 2002 cmimet e importit kan qene 2.63 here me te larta. Mbas vitit 2008 per shkak te uljes se kerkeses per energji elektrike

si pasoje e krizes ekonomike boterore cmimet e importit ne vitin 2010 u ulen me 73.6%.




Figura 3.18.

(Burimi ERE, OSSH, KESH.)

Ne grafikun e figures -3.18.- jane paraqitur financimet qe jane kryer gjate periudhes 2002- 2010 per te siguruar sasite perkatese te energjise elektrike, kundrejt cmimeve perkatese te importit.

Shpenzimet per blerjen e energjise elektrike nga importi ne vitet 2007 dhe 2008 jane rekordi historik i shpenzimeve, dhe kjo jo vetem ne saje te sasive rekord te importuara por edhe ne saje te cmimeve rekord te importit te energjise.

Duke pare keto bilance te importeve te energjise elektrike, mund te thuhet me te drejte se energjia elektrike perfaqson nje produkt me kosto shume te larte qe per pasoje duhet te perdoret me eficience shume te larte.

3.5. Eficienca e konsumit te energjise elektrike.

Ne se ne prodhimin publik te energjise elektrike eficienca e kesaj veprimtarie po vjen duke u rritur nga viti ne vit, nuk mund te themi te njejten gje per tempet me te cilat po permiresohet eficienca e konsumit te energjise elektrike.

Faktoret qe determinojne uljen e eficiences se konsumit te energjise elektrike jane:

- Niveli i larte i humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje. Humbjet totale dhe humbjet jo teknike dhe teknike ne vecanti, kane nivele te papranueshme, cka reflektohet ne nivelin e ulet te faturimeve te energjise elektrike ndaj konsumit te pergjithshem.
- Niveli i ulet i arketimeve te energjise elektrike te faturuar.

Ne grafikun e figures -3.19- eshte paraqitur niveli i humbjeve, arketimeve dhe efektivitetit per seicilen nga zonat e shperndarjes gjate vitit 2010. Me termin efektivitet shprehet rezultati final i eficiences ne konsumin e energjise elektrike qe merr ne konsiderate efektet e perbashketa te nivelit te faturimeve dhe te nivelit te arketimeve.




Figura 3.19. (Burimi ERE,OSSH,)

Humbjet e pergjitheshme ne shperndarje gjate vitit 2010, sipas raportimit vjetor te OSSH-se jane ne nivelin 30.38% te energjise se pergjitheshme te injektuar ne sistemin e shperndarjes, sikurse tregohet ne grafikun e figures 3.20, kurse niveli i arketimeve eshte raportuar me 77.2% te energjise elektrike te fatuar

Koeficienti vjetor i efektivitetit per sistemin e shperndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor te humbjeve dhe te arketimeve) rezulton me 53.74%. Verehet qarte se niveli i efciences ne shperndarje eshte shume i ulet, me gjithate duhet te pranojme se ai eshte rritur me 3.74% ne krahasim me vitin 2009.




Figura 3.20. (Burimi ERE,OSSH,)

Pamje nga Turi Studimor ne Sh.B.A. - Mars 2010-



Ne Rregullatorin
Federal te Sh.B.A.
(FERC)
Washington DC



Ne Shoqaten e
Rregullatoreve te
Sh.B.A.(NARUC)
Washington DC



Ne zbatim te programit te zvogelimit te humbjeve ne shperndarje, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s nr.93, date 30.11.2010, CEZ




Figura 3.21.

(Burimi ERE, OSSH,)

Shperndarje ka detyrimin qe per periudhen 2010-2011 te zvogeloje humbjet me 6% d.m.th. nga niveli 33.92% ne 1 Janar 2010, ti ule ne nivelin 27.92% ne 31 Dhjetor 2011. Ulja me 3.54% gjate vitit 2010 te ben te gjykosh se ky objektivi do te realizohet per periudhen deri ne fund te vitit 2011.

Eficienca e ulet ne konsumin e energjise elektrike vjen si pasoje e nje menaxhimi ende cilesisht te pamajaftueshem te sektorit te shperndarjes nga ana e CEZ-Shperndarje. Privatizimi i OSSH-se deri tani nuk ka reflektuar akoma ndonje kthesa te ndjeshme ne mirmenaxhim. Eshte detyre themelore e CEZ Shperndarje qe te reflektoje thelle ne permiresimin e menaxhimit te shoqerise dhe te realizoje sa me shpejte kthesen pozitive te shumepritur nga konsumatori shqiptar.

Ne sistemin e transmetimit humbjet e energjise elektrike jane ne vleften 256 GWh dhe perbejne 3% te energjise se injektuar ne sistemin e transmetimit. Humbjet totale faktike per vitin 2010, te cilat marrin parasysh humbjet ne shperndarje me 1,910 GWh dhe humbjet ne transmetim me 256 GWh jane gjithesej 2,167 GWh ose 32% e gjithe energjise se injektuar ne sistemin elektroenergjetik te vendit, ose me nje ulje me 3.3% nga viti 2009. Duhet theksuar se kjo tendence pozitive ne reduktimin e humbjeve duhet te konsolidohet dhe te vijojte ne te arthmen me ritme me te larta.

Ne grafikun e figures -3.22.- eshte paraqitur ecurija e humbjeve gjate periudhes 2002 – 2010 kurse ne grafikun e figures -3.23.- eshte paraqitur mardhenia e faturim-arketimeve gjate se njejtës periudhe.

Ne se nuk do te merrej ne konsiderate shlyerja e detyrimeve te prapambetura per energjine elektrike te konsumuar nga subjekte buxhetore dhe jo buxhetore ne muajin Gusht 2010 atehere vlefta e faturimeve nga ana e CEZ Shperndarje do te ishte vetem 70.1% sikurse tregohet ne figuren 3.23.

Shlyerja me korektesi nga te gjithë konsumatorët, e fatures se energjise elektrike eshte nje faktor shume i rendesishem qe do te ndikoje drjtpersedrejt ne zvogelimin e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.




Figura 3.22. (Burimi ERE,OSSH,)

Ne grafikun e figures -3.24.- eshte paraqitur struktura e humbjeve dhe faturimeve per seicilen nga zonat e shperndarjes se OSSH-se per vitin 2010, dhe pesha specifike qe zen ato ne bilancin e pergjithshem te kompanise.

Zonat me treguesit me te ulet te efektivitetit jane Burreli, ku niveli i humbjeve rezulton me 45.1%, niveli i arketimeve me 54.9% te energjise se faturuar




Figura 3.23. (Burimi ERE,OSSH,)

dhe pas tije Kuksi dhe Shkodra me perkatesisht humbjet 44.9% dhe 41.9% kurse arketimet perkatesisht me 55.1% dhe 58.1%. Zona me treguesit me te mire per vitin 2010 paraqitet zona e Gjirokastrës me nje nivel humbjesh 20.9% dhe nivel arketimesh 79.1%

Duhet te theksojme se pamvaresisht se ka nje permiresim te nivelit te humbjeve dhe arketimeve, ne krahasim me vitin 2009, perseri shkalla e performances se CEZ Shperndarje ende eshte larg objektivave te duhur.

Por peshen specifike me te madhe ne nivelin e efektivitetit te konsumit te energjise elektrike e kane zonat e Tiranes, Fierit dhe Shkodres.

Nga nje analize e tille e situates ne zonat e OSSH-se rezulton se per te patur ndryshim te shpejte pozitiv te situates, persa i perket rritjes se efektivitetit, vemendja kryesore ne manaxhim dhe ne investime duhet te drejtohet ne 4 zonat kryesore te permendura me larte, duke mos lene pas dore edhe zonat e tjera problematike.

Ne 30 Prill 2010 CEZ Shperndarje realizoi plotesimin me matesa te konsumatoreve tarifar dhe ligjerisht hoqi faturimin “aforfe” qe deri ne kete peridhe kryhej per te gjithë konsumatorët pa mates te energjise elektrike.

Gjate vitit 2010, sherbimi ndaj klientit, vecanerisht me faturimet e energjise elektrike te konsumuar, nuk ka qen korekt nga ana e CEZ Shperndarje. Ne muajt Nentor, Dhjetor u shenuan rreth 20 mije fatura te leshuara arbitrarisht ne kundershtrim me ligjin dhe kodin e matjes, nepermjet te cilave konsumatorët familjare penalizoheshin me 4,000 kWh energji elektrike, ndersa ata jo familjar me 20,000 kWh nepermjet emertimeve “dem ekonomik” dhe “energji e pamatur”




Figura 3.24.

(Burimi ERE, OSSH,)

ERE plotesimin me matesa te te gjithë konsumatoreve tarifore e konsideron nje objektiv me shume rendesi qe ndikon pozitivisht ne zvogelimin e perdorimit pa limit te energjise elektrike, ne rritjen e arketimeve, zvogelimin e humbjeve jo teknike dhe zvogelimin e kerkeses per energji.

Nje nga treguesit kryesor te efences se perdorimit te energjise elektrike eshte shkalla e mungeses se saj. Energjia e munguar eshte energjia me e shtrenjte, per efekt te impaktit mjaft te rende qe sjell mungesa e energjise elektrike ne jeten

ekonomiko-sociale te vendit. Ky koncept teper racional, ka qene devize e Qeverise Shqiptare qe nga viti 2006. Gjate viteve 2007 dhe 2008 u shpenzuan nga Qeveria, deri ne kufijt e te pamundures, 388 Milion Euro, per importe te energjise elektrike, ne menyre qe mungesa e saj, per shkak te thatesires se skajshme dhe konjukturave aspak te favorshme te tregut rajonal, te ndikonte sa me pake ne jeten e vendit.

Deri ne vitin 2008 furnizimi me energji elektrike eshte kryer me nderprerje te detyruara. Ne grafikun e figuren -3.24.- paraqiten nderprerjet e energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2010. Vetem tre vitet e fundit ne Shqiperi kane munguar nderprerjet e programuara te furnizimit me energji elektrike dhe mund te themi se tashme kjo dukuri eshte konsoliduar.

4. Operatori i Sistemit te Transmetimit

Sistemi i transmetimit te energjise elektrike perfaqson bashkesine e linjave elektrike, n/stacioneve dhe instalimeve te tjera (mjeteve kompensuese etj) qe sherbejne per transmetimin dhe interkoneksionin nderkombetar te energjise elektrike.

Sistemi i transmetimit drejtohet nga Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST), i cili eshte i licensuar nga ERE per te kryer veprimtarine e transmetimit te energjise elektrike. OST eshte shoqeri publike me 100% te aksioneve shteterore.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese per furnizimin e panderprere te konsumatoreve me energji elektrike. Ne kete kuader ai zhvillon sistemin e transmetimit ne perputhje me kerkesen afatgjate te furnizimit te vendit me energji elektrike.

OST dispeceron sistemin elektroenergjetik nepermjet manaxhimit te flukseve te energjise ne sistem duke marre parasysh realizimin e te gjitha sherbimeve ndihmese qe lidhen me qendrushmerine e sistemit si dhe shkembimet me sistemet e tjera.

Nje rol tjetër i rëndësishëm është edhe ai i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike. Në këtë kuader roli i tij nuk ka të bëjë me transaksione financiare që lidhen me importet ose eksportet e energjisë elektrike.

Funksionimi i Sistemit të Transmetimit kryhet në përputhje me ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe dispozitat e Kodit të Funksionimit të Rrjetit i cili miratohet nga ERE.

4.1. Struktura e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

Struktura e OST-se në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në Tabelen -4.1. –

Një nga arritjet më të rëndësishme në sistemin e transmetimit është realizimi me sukses dhe vendosja nën tension të linjave elektrike ajrore të transmetimit me tension 400 kV dhe kapacitet transmetues 1,000 MW, Tiranë – Elbasan dhe Tiranë – Podgorice.

Operatori i Sistemit te Transmetimit ka per objekt kryesor te veprimtarise se tije mirembajtjen, zhvillimin dhe shfrytezimin me efektivitet te larte te rrjetit elektrik te transmetimit ne vendin tone.

Gjate vitit 2010 OST u konsolidua edhe me shume nepermjet krijimit te struktures se rendesishme te Operatorit te Tregut. Ne kushtet kur gjate ketij viti numuri i tregtareve te licensuar te energjise elektrike arriti ne 17 dhe 4 subjekte te tjera jane ne proces trajtimi per miratim, detyrat e operatorit te tregut marrin nje rendesi te madhe per nje alokim transparent te kapaciteteve te transmetimit dhe te interkoneksionit nepermjet nje procesi konkurimi te ndershem ne ankandet e kapaciteteve transmetuese si dhe ne trajtimin e devijimeve dhe disbalancave te ngarkeses per te pasur nje sistem te qendrueshem ne menyre statike dhe dinamike..

NEN/STACIONET E SISTEMIT TE TRANSMETIMIT		
	FUQIA E INSTALUAR	NUMRI
400 kV	750 MVA	2
220 kV	2126 MVA	11
150 kV	40 MVA	1
GJITHSEJ		14

LINJA TE TENSIONIT TE LARTE	
400 kV	319.585 km
220 kV	1128 km
150 kV	34,4 km
110 kV	1216.2 km

LINJAT E INTER-KONJEKSIONIT	
Fierze-Prizren	220 kV (68 km)
Koplik-Podgorice	220 kV (44.75 km)
Bistricka1-Myrtos	220 kV (47 km)
Zemlak-Kardia	400 kV (20 km)
Tirane - Vau Dejes	400 kV (76.137 km)
Vau Dejes - (kufi Mal I Zi)	400 kV (52.248 km)
Tirana2 - Elbasan 2	400 kV (51 km)

Tabela 4.1.

(Burimi OST)

Ne Aneks -2- eshte paraqitur shtrirja ne teren e sistemit te transmetimit te energjise elektrike.

4.2. Operatori i Sistemit te Shperndarjes

Sistemi i shperndarjes se energjise elektrike perfaqson bashkesine e linjave elektrike ajrore dhe kablore, n/stacioneve dhe instalimeve te tjera (kabina transformuese etj) qe sherbejne per shperndarjen e energjise elektrike.

Sistemi i shperndarjes drejtohet nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH), i cili eshte i licensuar nga ERE per te kryer veprimtarine e shperndarjes se

energji elektrike. OSSH eshte shoqeri aksionere me 76% te aksioneve te zoteruara nga Kompania Ceke CEZ dhe 24% nga Qeveria Shqiptare. Procesi i privatizimit te OSSH-se perfundoi gjate vitit 2009 dhe qe nga 1 Qershori i ketij viti, OSSH operon si nje shoqeri private. Ne vitin 2010 OSSH ndryshoi emrin dhe u quajt "CEZ Shperndarje.

OSSH ka per objekt te veprimtarise se vet mbajtjen dhe zhvillimin e nje sistemi te sigurte dhe eficient shperndarjeje per te garantuar nje furnizim me cilesi dhe pa nderprerje me energji elektrike te konsumatoreve te lidhur ne kete sistem. OSSH kryen edhe importet e energji elektrike deri ne ate mase sa te mbuloje humbjet e energji elektrike ne shperndarje.

Funksionet e kryerjes se furnizimit me energji elektrike dhe te gjitha procedurat e faturimit dhe arketimit te energji elektrike te shitur te konsumatoret tarifore kryhen nga Furnizuesi Publik me Pakice (FPP), qe perfaqson nje subjekt publik te pavarur financiarisht dhe organizativisht nga OSSH-ja por qe juridikisht eshte pjese e saj. FPP per furnizimin e konsumatoreve tarifore blen me cmime te rregulluara nga Furnizuesi Publik me Shumice (FPSH), te gjitha energjine elektrike te prodhuar ne vend dhe te importuar prej tij (FPSH), per plotesimin e nevojave te konsumatoreve tarifore.

5.1. Struktura e Sistemit te Shperndarjes

Ne tabelen -5.1.- eshte paraqitur struktura e pergjitheshme e Sistemit te Shperndarjes, nepermjet se ciles realizohet ne praktike furnizimi me energji elektrike i konsumatoreve tarifore te rrjetit te shperndarjes.

Tabela 5.1.

(Burimi OSSH,)

Sistemi i Shperndarjes -2010-	
Numri i Zonave te Shperndarjes	4
Numri i N/Zonave te Shperndarjes	40
Numri i Njesive te Tensionit te Larte	5
Numri i Nen/Stacioneve	165
Nr. N/Stacioneve 110 kV	70
Nr. N/Stacioneve 35 kV	9
Numri i Kabinave	21984
Kabina 6 kV	10648
Kabina 10 kV	8448

Gjate vitit 2010 CEZ Shperndarje u riorganizua ne 4 Zona Shperndarje me emertimet:

- Zona Veriore me qender ne Shkoder.
- Zona Qendrore me qender ne Durres
- Zona Jyglindore me qender ne Korce
- Zona Jugperendimore me qender ne Fier

Ne Aneks -4- eshte paraqitur harta e Republikes se Shqiperise dhe shtrirja gjeografike e seiciles zone, kurse ne tabelen ---- jane paraqitur asetet qe ka ne dispozicion seicila zone..

Tabela -5.2-

ZONAT	CEZ-SHPERNDARJE (OSSH)	QENDER (DURRES)	VERI (SHKODER)	JUG-LINDJE (KORCE)	JUG-PERENDIM (FIER)
Numri i N/Zonave	40	7	12	11	10
Linja 35kV (km)	1131	200	231	400	300
Fuqia MVA	2946	1,000	552	654	740
Transformatore TL	316	61	79	63	113
Siperfaqe (km²)	29176	2,458	10,023	9,219	7,476
Nenstacione	165	31	46	41	47
Konsumatore	1108000	410,000	189,000	248,000	261,000
Kabina ne TM	20056	6,518	5,438	4,100	4,000
Gjatsia e Rrjetit ne TM (km)	13490	2,354	3,763	3,403	3,970
Gjatsia e Rrjetit ne TU (km)	25695	4,155	7,532	8,110	5,898

5. Siguria e furnizimit me energji elektrike

Objektivi themelor i veprimtarive ne sektorin e energjise elektrike eshte pa dyshim furnizimi ne menyre te panderprere dhe me cilesi i konsumatoreve me energji elektrike per sote dhe per te arthmen.

Viti 2010 demonstroi nje furnizim te panderprere te konsumatoreve me energji elektrike dhe per pasoje konsumi prej 6.773 TWh perfaqson edhe kerkesen reale per energji elektrike, e cila sherben si pike mbeshtetje per skenaret e prognozimit te kerkeses per energji elektrike per periudhat afatshkurter dhe afatgjata.

Skenaret e kerkeses per energji elektrike sherbejne per te hartuar skenaret e furnizimit me energji elektrike, dhe ata jane pjese e strategjise kombetare te energjise.

Sigurija e furnizimit, sikurse dihet, perfaqson nje koncept te gjere dhe mjaft kompleks, mbasi eshte funksion i shume variableve, si i skenarit te zhvillimit te burimeve gjeneruese ne vend, i rezerves gjeneruese, i struktures se interkoneksioneve ndershtetore, i shkalles se eficiences se prodhimit dhe konsumit te energjise elektrike, i shkalles se sigurise se rrjeteve dhe sistemeve te transmetimit dhe te shperndarjes, i shkalles se automatizimit te tyre, i kualitetit te manaxhimit te ketyre sistemeve, i dinamikës së zhvillimit te kerkeses per energji etj.

Strategjia e Qeverise Shqiptare per rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike udhehiqet se pari nga shfrytezimi ne maksimum i potencialit te madh hidroenergjetik te vendit i cili eshte ende i pashfrytezuar. Shfrytezimi i tije parashikohet te realizohet kryesisht nepermjet investimeve private. Viti 2010 shenoi nje shkalle te larte pjesmarjeje te investitoreve privat qe u kurorizua me futjennne pune te 5 HEC-eve te rinj te dhen me koncension, me fuqi te pergjitheshme te instaluar 16 MW dhe nje prodhim vjetor me shkalle sigurije 70% prej rreth 50 Milion kWh

Se dyti, nje drejtim i rendesishem eshte diversifikimi i burimeve gjeneruese. Ne kete kuader pervec futjes ne pune dhe fillimit te prodhimit gjate vitit 2010 te TEC-it te Vlores, jane ne proces ndertimi ne shkalle te avancuar rreth 30 HEC-e te rinj te dhen me koncension, me fuqi deri 15 MW seicili..

Nga ana tjeter licensimi i nje numuri te rendesishem investitoresh private per te ndertuar parqe eolike ne teritorin e Shqiperise, me nje fuqi te pergjitheshme te instaluar rreth 1,350 MW dhe prodhim te pritshem vjetor rreth 4.1 TWh, qe parashikon nje investim rreth 2 miliard Euro, perben nje drejtim tjeter te diversifikimit te burimeve gjeneruese ambjentalisht miqesore.

Ne strategjine e vete Qeverija Shqiptare e vlereson nje obsion real edhe ndertimin e nje centrali nuklear me karakter rajonal nepermjet sipermarjes private per te siguruar nje furnizim te sigurte e te qendrushem afatgjate, me energji elektrike ambjentalisht miqesore, te Shqiperise dhe vendeve fqinje ne rajon. Per krijimin e kuadrit te nevojshem legal dhe regullator ne perdoriminpaqesor te energjise nukleare, gjate vitit 2009 u themelua nje agjenci e posacme qeveritare.

Hapa shume te rendesishem ne rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike jane edhe zhvillimi i linjave ndershtetore te interkoneksionit. Ne vitin 2010 perfunduan dhe u vendosen nen tension linjat elektrike ajrore te interkoneksionit me tension 400kV dhe kapacitet transmetues 1,000 MW, Elbasan – Tirane dhe Tirane – Podgorice

Ne shkurt te vitit 2011 eshte parashikuar te komisionohet, me financime te Qeverise Gjermane, linja e interkoneksionit Tirane-Prizren-Prishtine gjithashtu me tension 400 kV dhe kapacitet 1,000 MW. Ne vijim parashikohet te ndertohet edhe linja e interkoneksionit me Maqedonine, duke ju shtuar ketyre dhe dy linjat kablore nenujore te interkoneksionit me Italine. Ne kete menyre Shqiperia brenda nje periudhe afatmesme do te pozicionohet ne menyre shume efektive dhe te sigurte, nga pikpamja e konfiguracionit te sistemeve te transmetimit, ne rajonin e tete energjetik te Evropes.

Linja ajrore e interkoneksionit Tirane-Podgorice eshte ndertuar ne segmentin Tirane-Puke, me shtylla metalike me dy qarqe, nga te cilat njeri qark eshte parashikuar per shtrirjen e linjes se interkoneksionit me Kosoven, dhe ne kete menyre mbetet per tu ndertuar shtyllezim vetem ne segmentin Puke-Prizren.

Ndertimi i linjes elektrike te interkoneksionit me Kosoven e ben reale aspiraten e integritit te dy sistemeve energjetike komplementare Shqiperi - Kosove ne nje sistem energjetik unik me dispecerim te perbashket per te rritur ne maksimum eficiencen tekniko-ekonomiko te shfrytezimit te sistemeve energjetike te te dy shteteve cka do ti sherbeje rritjes se metejshme te sigurise se furnizimit me energji elektrike te ketyre dy vendeve.

Me ftese te KOST-it (Operatorit te Sistemit te Transmetimit te Kosoves) ne muajin Tetor 2010 Kryetari i ERE-s mori pjese ne prezantimin nga nje kompani konsulente gjermane, e financuar nga kfw, te studimit per zgjerimin e rritit elektrik te transmetimit ne sistemin energjetik te Kosoves. Ne diskutimin e vet Kryetari i ERE-s shtjelloi dhe argumentoi idete qe sistemet energjetike te Kosoves dhe Shqiperise te mos konceptohen me si ishuj energjetik, por studimet per te dy sistemet te udhehiqen nga principi i integritit dhe dispecerimit te perbashket me programe optimizimi on-line.

Nepermjet realizimit te nje sistemi unik energjetik per te dy shtetet, behet i mundur dispecerimi i i grafikut unik te ngarkeses, pra dhe i pikut te tije nga HEC-et e Kaskades se lumit Drin duke perjashtuar keshtu ndertimin ne Kosove te HEC-it te Zhurit, me kosto te larte dhe eficience te ulet.

Keto ide u perkrahen nga titullaret e Zyres Rregullatore te Kosoves, te KOST-it dhe KEK-ut (Korporates Elektroenergjetike te Kosoves). Ne konkluzionet e takimit u vendos qe studimi per zgjerimin e sistemit te transmetimit te Kosoves te reflektonte ne konfiguracionin e tij idete integruese dhe njekohesisht edhe nga pala Shqiptare te kryhet nje studim i ketij karakteri.

Integrimi i sistemeve energjetike komplementare dhe zhvillimi ne Kosove i potencialeve te pasura termoenergjetike sikunder ne Shqiperi i potencialeve te pasura hidroenergjetike perbejne nje rruge te sigurte ne rritjen e sigurise se furnizimit me energji elektrike me eficience te larte te te dy vendeve tona.

Investimet gjithnje ne rritje nga shoqerite qe operojne sistemet elektrike te transmetimit (OST) dhe te shperndarje (OSSH) nepermjet zgjerimit dhe modernizimit te tyre si dhe automatizimit ne shkalle te larte, do te sherbejne gjithashtu, brenda nje periudhe afatmesem, jo vetem per rritjen e sigurise se furnizimit, por edhe per rritjen e cilesise se ketij furnizimi.

Projekti i rehabilitimit te vepres hidroteknike ne HEC-et kryesore te vendit, do te rrise ne nje shkalle te rendesishme sigurine ne pune te ketyre objekteve me rendesi te vecante, cka nga ana tjeter i sherben rritjes se sigurise se furnizimit me energji elektrike.

Pamje nga Turi Studimor ne Sh.B.A. - Mars 2010-

Ne Rregullatorin e Shtetit
Masacuset – Boston-



Ne Rregullatorin
e Shtetit - Ohio –
Colombus

Ne Kompanin e Gazit te
Shtetit - Ohio – Colombus



Privatizimi i OSSH pritet të ketë një impakt të rëndësishëm pozitiv gjatë periudhës rregullatore 2010 – 2014 në rritjen e efciencës së konsumit të energjisë elektrike me të pakten 21%, gjë që i shërben gjithashtu rritjes së sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike.

ERE shpreh bindjen se programi kompleks, i rritjes së sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike do të realizohet me sukses.

Kapitulli i Dytë

1. Aktiviteti i ERE në fushën e Gazit Natyror gjatë vitit 2010.

Në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” __Nr.9072, datë 22.5.2003 dhe Ligjin “Për Sektorin e Gazit Natyror” Nr. 9946, datë 30.6.2008, Enti Rregullator i Energjisë gjatë vitit 2010 përsa i përket sektorit të gazit natyror ka patur në vëmendje çështjet kryesore që vijojnë;

1. Plotësimin e metejshëm të kuadrit rregullator të sektorit të gazit natyror me aktet e nevojshme nenligjore,
2. Mbështetjen e projekteve me interes dhe përpjekjeve të kompanive të interesuara për investime në infrastrukturën e gazit natyror në vendin tone.
3. Ndjekjen e zhvillimeve gjeo-politike, ekonomike dhe teknologjike, në sektorin e gazit natyror në nivel global, BE dhe rajon që kanë lidhje direkte me zhvillimet e mundshme të këtij sektori në vendin tone.

Duke qenë se zhvillimet e infrastrukturës së gazit natyror në vend janë direkt të varuara prej zhvillimeve ndërkombëtare janë trajtuar fillimisht këto zhvillime dhe me tej dy pikat e tjera të sipërcituara.

2. Zhvillimet ndërkombëtare në sektorin e gazit natyror dhe efekti i tyre në zhvillimet e këtij sektori në vendin tone.


Ndonese varianti më i fundit i miratuar i Strategjisë Kombëtare e Energjisë ka nevojë të përditesohet dhe reflektojë zhvillimet në vendin tone dhe ato në nivel rajonal e Europian, Strategjia ka përcaktuar nevojën e furnizimit me gaz natyror si një ndër prioritetet e sektorit energjistik të vendit për arsye të sigurisë së furnizimit me energji të vendit dhe është lenda fosile me më pak emisjone të CO₂ etj.

Në shtesë të arsyeve të mësipërme në kushtet kur prodhimi vendas i gazit natyror është i papërfillshëm dhe kur Bashkimi Europian është duke bërë përpjekje të konsiderueshme për diversifikimin e furnizimit me gaz natyror nga pellgu i detit

Kaspik vendi yne ka shanse te medha te perfitoje prej projekteve tranzituese, me konkretisht prej Trans Adriatic Pipeline (TAP) i cili kalon permes vendit tone dhe eshte projekti me i qendrueshem nga pikpamja e leverdise ekonomike. Ky projekt eshte shume i rendesishem per Shqiperine sepse ai krijon siguri te larte furnizimi dhe me kosto me te leverdishme se sa lidhjet alternative si zgjatime te sistemeve te vendeve fqinje.

2.1. Zhvillime gjeo-politike dhe ekonomike te lidhura me sektorin e gazit natyror ne BE, zonen e detit Kaspik dhe rajonin Ballkanik.

Sikurse treguar ne skemen ne vijim jane disa projekte madhore te cilet synojne te kalojne permes Europes Juglindore, prej te cileve tre jane te inicjuara prej vendeve te BE dhe njeri prej Rusise.



Burimi: Qendra Studimore per Sigurine/The Center for Security Studies, ETH Zurich, (www.sta.ethz.ch)

Viti 2011 pritet te jete nje vit vendimtar per ardhmerine e projekteve te paraqitura e per pasoje ka nje intensitet te larte analizash qe evidentojne nje numer arsyesh gjeopolitike, ekonomike e komerciale, dhe vartesine e realizimit te secilit projekt prej disponibilitetit te gazit natyror ne vendet e origjines. Venia ne shfrytezim e fazes se dyte te vendburimit Shah Deniz nga viti 2017 do te mundesoje nje prodhim total gazi natyror prej Azerbaixhanit deri ne 25¹ Miljard Normal M³ (BCM) ne vit prej te cilave 10BCM do te jene prej Shah Deniz 2² por volumet e kerkuara prej Nabucco, ITGI dhe TAP tejkalojne dukshem mundesite reale te Azerbaxhanit cka perben nje prej shkaqeve kryesore te konkuresnces ndermjet tyre.

Nje pershkrim i shkurter i projekteve te sipercituara perfshire zhvillimet kryesore gjate vitit 2010 dhe ato me te fundit si dhe implikimet per vendin tone jepen ne vijim;

¹ "Gas contracts on Shah Deniz 2 to be signed in 2011" Rovnag Abdullayev, head of the State Oil Company of Azerbaijan (SOCAR). 13.November.2010, <http://en.trend.az>

² "Tapping into Greece's future energy needs" Will Vassilopoulos, Philip Pangalos <http://www.economia.gr>.

- **“NABUCCO-pipeline”³**

Eshte projekt infrastrukturor prioritar i BE⁴. Me nje gjatesi prej 3300 km ai synon te sjelle permes Turqise, Ballkanit drejt Europes Qendrore (Baumgarten-Austri) dhe tregjeve te BE cdo vit 31 miljard Normal M³ gazi prej rajonit te Kaspikut fillimisht prej Azerbaixhanit, dhe me vone prej Turkmenistanit dhe Irakut e ndoshta me gjere. Investimi total per Nabucco eshte vleresuar ne 7.9 miljard Euro, por eshte aktualisht duke u rishikuar⁵ dhe raportohet se mund te arrije edhe deri ne 14 miljard Euro⁶. Rendesia e madhe e ketij projekti per BE reflektohet edhe ne vizitat e kryera ne 13 dhe 14 janar 2011 prej vete Presidentit te Komisionit Europian Z. José Manuel Barroso dhe Komisionerit per Energjine Z. Günther Oettinger ne Azerbaixhan⁷ dhe Turkmenistan shoqeruar me nënshkrimin e deklarave angazhuese perkatese.

Vleresimet per projektin Nabucco perfshijne krahas mbështetjes së fuqishme politike prej Komisionit Europian dhe angazhimeve të fuqishme financjare deri në 4 miljard Euro prej EBRD, IFC EIB⁸ dhe kompanive aksionere⁹, edhe qendrime skeptike e kritike¹⁰ qe burojne nga parashikimet pesimiste per nje kerkese me te ulet per gaz natyror per shkak te krizes, si dhe pamundësinë e nje projekti me dimensione të tilla për të funksionuar me kapacitet të plotë që në fillimet e pritshme të tij në vitin 2017 etj edhe sikur ai te ishte i vetmi projekt i cili do te furnizohej me gjithë ssine e gazit te prodhuar. Faktore të tilla kane qene shkak për rezerva të negocjatoreve Azere¹¹ ndaj këtij projekti.

Interkonektori Turqi-Greqi-Itali (ITGI)¹².

ITGI se bashku me projekte te tjera energjetike jane pjese e strategjise tashme te deklaruar te Greqise¹³ per tu bere nje prej pikave qendrore shperndarese

³ www.nabucco-pipeline.com/

⁴ TAP eshte shprehur ne disa raste ne favour te nje trajtimi te barabarte te te gjithë projekteve konkurente perfshire ketu Nabucco dhe ITGI, te dy keta te fundit kane patur mbështetje politike dhe subvencione prej BE. “The U.S. Perspective on Eurasian Energy” Remarks by Ambassador Richard L. Morningstar, Special Envoy for Eurasian Energy 2010 Black Sea Energy and Economic Forum, Istanbul, Turkey, September 30, 2010.

⁵ www.nabucco-pipeline.com

⁶ “European gas pipeline costs double” guardian.co.uk, Sunday 20 February 2011

⁷ Deklarata e perbashket per shtyp thekson se “Azerbaxhani dhe Komisioni Europian angazhohen per nje objektiv te perbashket: Azerbaxhani do te furnizoje mjaftuesherisht gaz per te mundesuar krijimin e Korridorit te Jugut. Se bashku, Europa dhe Azerbaxhani do te kontribojne per infrastrukturen e furnizimit me gaz te BE” http://ec.europa.eu/energy/infrastructure/strategy/2020_en.htm

⁸ “Brussels, 6 September 2010. The signing of the mandate letter by the three International Financial Institutions (IFIs) marks the start of the appraisal process of the Nabucco project, a required step towards a potential financing package of up to EUR 4 billion” www.nabucco-pipeline.com

⁹ The project’s participants include the Austrian OMV, Hungarian MOL, Bulgarian Bulgargaz, Romanian Transgaz, Turkish Botas and German RWE.

¹⁰ “Czech Gas Association: Nabucco is economically irrational” ČTK 18 FEBRUARY 2011, <http://praguemonitor.com/2011/02/18/czech-gas-association-nabucco-economically-irrational>

¹¹ Interview Azerbaijan’s top negotiator Elshad Nassirov ‘We do not want to depend on only one pipeline’ 15 November 2010 By Rudolf ten Hoedt www.europeanenergyreview.eu

¹² <http://www.igi-poseidon.com>

energjetike te Ballkanit (energy hub). Ne kete kuader Greqia shikon me me interes furnizimin e Shqiperise si nje zgjatim i sistemit te saj te gazit natyror dhe kjo shpjegon edhe mungesen e mbeshtetjes se nevojshme te Greqise ndaj TAP¹⁴. Lidhese Turqi-Greqi-Itali eshte projektuar te furnizohet me 11 - 12 BCM prej gazit Kaspik i cili do te tranzitohet pergjate sistemit te transmetimit turk te kompanise Botas dhe me tej mbasi furnizon tregun grek nje sasi prej 8 BCM, anashkalon Shqiperine nepermjet nje rruge me te gjate dhe ne thellesi me te medha te detit Jon per tu bashkuar me sistemin italian ne zonen e Barit. Ky projekt eshte nje joint venture e Edison dhe Operatorit te Transmetimit Grek DESFA. Investimi i projektit varion sipas burimeve te ndryshme nga 2.5¹⁵ deri ne 3.4 Miljard Euro¹⁶ nderkohe qe projekti ka perfituar nje subvencion prej 100 milion Euro prej BE per pergatitjen e projektit teknik.

- **Trans Adriatic Pipeline (TAP)**¹⁷

Eeshte projekti i propozuar fillimisht nga EGL dhe Statoil te cileve ne 20 Maj¹⁸ te vitit 2010 ju bashkua edhe EON Ruhrgas me 15% te interesave. Angazhimi i EON Ruhrgas ploteson dimensionin komunitar te projektit. TAP eshte i listuar prej Komisionit Europian si projekt nderlidhes me interes Europian prej TEN-E project (Trans European Networks – Energy). Njekohesisht TAP ka bere nje distancim i qarte ndaj furnizimeve te mundshme me gaz Iranian ne perputhje me kerkesat e komunitetit nderkombetar¹⁹. Statoil ka nderkohe 25% te interesave te vendburimit Shah Deniz II i cili eshte aktualisht burimi i vetem i furnizimit per te cilin konkurojne te tre projektet. Shume analiste e vleresojne pozicionin e Statoil ne Shah Deniz II si shume te favorshem per TAP. Ky projekt do te kete fillimisht nje kapacitet prej 10 BCM i mundshem per t'u zgjeruar deri ne 20 BCM ne funksion te disponibilitetit te gazit ne burime. Kosto e tij vleresohet ne 1.6 Miljard Euro. Nje nga anet me te forta te TAP eshte komercialiteti i tij dhe TAP ne disa prononcime te vetat ka kerkuar trajtim te barabarte mbi baza komerciale per te gjitha projektet qe konkurojne. Mbas permiresimeve te kapaciteteve te infrastrukturave egzistuese ne Turqi dhe Greqi TAP do te shkeputet si nje tubacion me vete prej Selanikut ne drejtim te Korces dhe do te kaloje permes Shqiperise ne lartesi deri ne 1800 metra per te vazhduar me tej permes Adriatikut ne thellesi deri ne 820 m dhe bashkohet me rrjetin italian te gazit prane Barit. Ne Shqiperi projekti synon te aktivizojte edhe vendburimet egzistuese tashme te shfrytazuara te gazit dhe strukturat kripore si stokazhe nentokesore te cilat se bashku me distancin me te shkurter dhe thellesite me te ceketa te detit i japin projektit avantazhe konkuresore ne raport me dy konkurentet e tjere Nabucco

¹³ Congressional Research Service «Greece Update» Carol Migdalovitz Specialist in Middle Eastern Affairs December 16, 2009, .

¹⁴ Anastasios Giamouridis “Gas in Greece and Albania, Supply and Demand Prospects to 2015” faqe 87, Oxford Institute of Energy. NG 39, December 2009.

¹⁵ www.energja.gr/article_en.asp?art_id=22625

¹⁶ «EU pushes Nabucco and ITGI merger” 17.02.2011 <http://www.en.trend.az>

¹⁷ <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/>

¹⁸ Brussels, May 20, 2010 “Statoil and EGL today announced the divestment of a combined stake of 15% in the Trans Adriatic Pipeline Project (TAP) to E.ON Ruhrgas - a leading energy provider”. www.trans-adriatic-pipeline.com

¹⁹ Ketu do te ishte mire te kishte ndonje reference se kur TAP e ka bere kete prononcim.

dhe ITGI. Nje pjese e gazit pritet qe ne menyre te natyrshme te furnizojte edhe konsumatorit e tregut shqiptar nderkohe qe projekti do te lejojte rrjedhjen e gazit edhe ne drejtimin e kundert duke permiresuar keshte ndjeshem sigurine e furnizimit jo vetem per Shqiperine por per te gjithe rajonit. Per gjithe keto arsye rendesia e ketij projekti per vendin tone eshte shume e madhe. TAP ka kryer tashme vleresimin e trajektores se projektit dhe ndikimin ne mjedis ne Shqiperi, Greqi dhe Itali. TAP ka bere njekohesisht edhe nje prezantim tjetër prane ERE te parametrave ekonomiko-financjare te projektit dhe ka shprehur synimin per te aplikuar per perjashtim prej te drejtes se hyrjes se paleve te treta, por ende nuk ka paraqitur ndonje kerkese zyrtare per kete qellim dhe ne dijenine e ERE nuk ka bere as ndonje aplikim prane qeverise shqiptare ne perputhje me Vendimin perkates per ndertimin e infrastrukturave te reja per sektorin e gazit natyror.

Rivaliteti mes projekteve per gazin Kaspik (Shah Deniz II) po behet gjithmone e me i nxehte sa me shume po afrohet momenti i vendimit perfundimtar. Shume analiste parashikojne qe nje vendim perfundimtar nga ana e Azerbaxhanit se me cilin(et) projekt(e) do te kontraktoje gazin e Shah Deniz II pritet te merret ndoshta gjate muajit Mars ose ne vijim. Kjo ben qe vitit 2011 do te jete nje vit shume i rendesishem per zhvillimet infrastrukturore ne BE dhe ne menyre te vecante ne zonen tone. Nenshkrimi e ketyre marveshjeve megjithate edhe ne rastin me pozitiv do te mundet te bente qe gazi te rridhte ne tubacione vetem ne vitin 2016 ose 2017. Per shkak te investimeve te konsiderueshme eshte e pritshme qe pjesa dominuese e kontratave ne mos te gjitha te jene afatgjata dhe investitorit te kerkojne perjashtim prej te drejtes se hyrjes se paleve te treta.

Zhvillimet e negociatave jane shume intensive dhe kane gjeneruar edhe ide si ajo e bashkimit te te gjithe projekteve konkurruese ne nje te vetem, qofte kjo te pakten vetem per zonen e Turqise ndonese nuk kane munguar as kunder reagimet.

- **“South Stream”²⁰**

Eshte nje projekt i promovuar prej Rusise me nje kapacitet prej 63 BCM dhe nje kosto qe vleresohet te varioje nga 15 deri ne 25 Miljard Euro. Ai eshte projekt alternativ i Nabucco dhe konsiderohet shpesh si konkurenti kryesor i ketij te fundit. Ky projekt shikohet me shume si nje rruge e re tranzitimi e gazit rus qe aktualisht tranziton permes Ukraines. Tensionet e mardhenive Ruso-Ukrainase, nevoja e rikonstruksionit te tubacionit egzistues si dhe perpjekja per te ruajtur pozicionin dominues ne importet e gazit te BE jane shtytesit kryesore te ketij projekti. Per ruajtjen e ketij pozicioni Rusia ka negociuar me vendet Kaspike per ta tranzituar gazin e tyre permes Rusise drejt tregjeve Europiane²¹. Projekt ideja e South Stream ndonese ende e pazhvilluar ne detaje degezohet ne zonen e Ballkanit per te cuar nje pjese te gazit drejt Europes qendore dhe nje pjese drejt jugut te Italise. Degezimi qe mendohet te kaloje drejt jugut te Italise duket se sikurse

²⁰ <http://south-stream.info>

²¹ “Gazprom, SOCAR Sign Addendum to Boost Azerbaijani Gas” the annual volumes of gas purchase will grow to 2 billion cubic meters starting from 2011 and to more than 2 billion cubic meters from 2012. OAO Gazprom Friday, September 03, 2010. <http://www.rigzone.com>

projekti ITGI (Intekonektori Turqi-Greqi-Itali) po e anashkalon Shqiperine pamvaresisht kostove me te larta qe ka nje trajektore e ketille. Perfaqesues te larte Ruse kane shprehur megjithate gadishmerine per degezime te mundshme prej magjistralit kryesor per te furnizuar Shqiperine por leverdia ekonomike e nje variant i tille do te duhej te analizohej me kujdes.

3. Risi teknologjike; Gazi i Argjilave nje mundesi potenciale per furnizimin e vendit me gaz natyror qe ka nevoje per studime.

Eshte per tu theksuar se nje prej risive me te fundit teknologjike ne sektorin e gazit natyror eshte shfrytezimi komercial i gazit te argjilave deri pak kohe me pare te pashfrytezueshme per shkak te pershkueshmerive te ulta qe karakterizojne keto shtresezime dhe pengojne prodhim me debite komerciale te vendburimeve. Shtetet e Bashkuara te Amerikes fale zhvillimit te teknologjive te carjeve hidraulike te shtesave arigjilore kane arritur brenda shume pak viteve te shnderohen nga importues ne eksportues i gazit natyror duke sjelle edhe ulje te konsiderueshme sidomos ne cmimet e LNG per shkak te mos terheqjes se sasive qe pritej te konsumoheshin prej tyre.

Pare keto zhvillime, shume vende te tjera ne bote jane duke i kushtuar vemendje te vecante kesaj mundesie. Shqiperia si vend i provuar rezervash hidrokarbure dhe perberje gjeologjike te favorshme ka shanse te medha qe te kete rezerva te konsiderueshme gazi argjilash. Nje ceshtje e tille do te ishte mire te studjohej me detaje prej specialisteve me eksperience te institucioneve shqiptare. Kjo behet edhe me e rendesishme ne se merret ne konsiderate rritja konstante e cmimeve te energjive fosile.

4. Mbështetja e projekteve me interes dhe e perpjekjeve te kompanive te interesuara per investime ne infrastrukturen e gazit natyror ne vendin tone.

Sikurse permendur edhe me siper TAP eshte e vetmja kompani dhe me e rendesishmja qe ka treguar interes per zhvillimin e sektorit te gazit natyror ne Shqiperi e per pasoje vemendja e ERE ndaj saj ka qene inkurajuese dhe mbeshtetese.

TAP ka bere prane ERE disa prezantime rreth projekt idese dhe progresit te pergatitjes se projektit teknik dhe komponenteve te tjera te tij.

TAP ka prezantuar prane ERE variantet e studjuara te gjurmave te mundshme te projektit dhe seleksionimin e variantit me te mire te mundshem. Ne kete kontekst TAP po asistohet prej ERE per te evituar mbivendosje me projekte te tjere energjitike si parqe eolike apo HEC-e pergjate gjurmes se tubacionit.

TAP ka bere gjithashtu ne nentor 2010 nje prezantim te parametrave ekonomiko financjare te projektit dhe ka shprehur synimin per te paraqitur kerkese per perjashtim nga e drejta e hyrjes se paleve te treta ne tubacion por ende nje kerkese e tille nuk eshte paraqitur zyrtarisht prane ERE. Plotesimi i nje kerkese te tille

duhet te plotesohet ne bashkepunim edhe me rregullatoret e vendeve te tjera sic jane Greqia dhe Italia ko-ordinim i cili pritet natyrshem te behet prej TAP por deri me tani nuk ka te dhena se TAP ka paraqitur te tille kerkese tek RAE (Greqi) dhe tek AAEG (Itali). Mendojme se nje vonese e tille duhet te vije si shkak i prioriteteve te tjera te ekipit drejtues ne momentin aktual nderkohe qe ERE eshte duke studjuar eksperience te ngjajshme ne vende te tjera. ERE ka shprehur nga ana e vet vleresimin per rendesine e ketij projekti por edhe prishmerine qe ky projekt do te ofroje gjithashtu nje burim te ri energjie me kosto te aresyeshme per ekonomine e vendit.

5. Arritjet e ERE ne sektorin e gazit natyror gjate 2010 dhe sfidat per te ardhmen

5.1. Zhvillimi i kuadrit rregullator

Me mbeshtetjen e USAID gjate vitit 2010 grupi i punes per gazin natyror perfundoi dokumentin e Procedurave te Licensimit per Sektorin e Gazit Natyror te cilat me tej u vune ne dispozicion te te gjithe paleve te interesuara per te paraqitur komentet e tyre. Eshte per t'u permendur bashkepunimi i ngushte me Sekretariatin e Komunitetit te Energjise se Vjenes te cilet ndihmuan ne nje numer permiresimesh te ketij dokumenti te rendesishem. TAP si pale direkte e interesuar beri komente te shumta te cilat u morren me shume kujdes ne konsiderate nga grupi i punes.

Dokumenti i Procedurave te Licensimit per sektorin e Gazit Natyror eshte tashme i miratuar prej Bordit te Komisionereve te ERE.

Krahas Procedurave te Licensimit grupi i punes ka bere nje pune serioze pergatitore edhe per nje numer dokumentash te tjere sikurse jane;

- Procedurat per trajtimin e perjashtimit prej aksesit te paleve te treta
- Licensat model per nje numer aktivitetesh ne sektorin e gazit natyror.

Vemendje e vecante i eshte kushtuar zhvillimit te njohurive mbi modelet e ndryshme te tregut te gazit natyror. Per kete aresye ne bashkepunim me Sekretariatin e Komunitetit te Energjise dhe konsulentin e USAID u organizua ne Tirane ne datat 26 dhe 27 Maj 2010 nje workshop me pjesemarrje e specialisteve te ERE, METE dhe AKBN per te ndare njohuri dhe per te diskutura modelet e ndryshme alternative per formesimin e tregut te gazit natyror ne Shqiperi sikurse ceshtje te tjera qe lidhen me zhvillimin e sektorit.

Duke qene nje sfide komplekse por edhe nje proces reformimi edhe per vendet e tjera te rajonit me nivel shume me te larte zhvillimi te sektorit te gazit natyror Sekretariati i Komunitetit te Energjise organizoi edhe nje workshop tjetër te dedikuar serish ne modelet e tregut ku specialiste te ERE morren pjese dhe njohuri shume te dobishme.

5.2. Zhvillimi i mardhenieve me partneret dhe ndjekja e zhvillimeve te sektorit

ERE ka bere prezent interesat e vendit tone per zhvillimin e infrastruktures se gazit natyror ne te gjithë takimet qe ka marre pjese prane perfaqesuesve te Komisionit Europian, Sekretariatit te Komunitetit te Energjise, Rregullatoret e vendeve fqinje dhe partnere, kompanive te interesuara dhe specialisteve te ndryshem qe jane takuar.

Vemendje e vecante ne aktivitetin e saj gjate vitit 2009 ERE i ka kushtuar bashkepunimit me rregullatoret analoge ne vendet e rajonit e me gjere. Ne kete kuader jane ndertuar bazat per bashkepunime dhe shkembime eksperiencash ne fushen e rregullimit te sektorit te gazit natyror me rregullatorin Italian, Turk, Grek, Kroat etj. Ne menyre te vecante shume frytdhense ka qene pjesmarrja aktive ne grupin e punes se gazit i ngritur ne kuadrin e Komunitetit te Energjise dhe lehtesuar prej Sekretariati te Vjenes si dhe pjesemarrja ne shume takime europiane dhe rajonale dedikuar ceshtjeve te gazit natyror.

Duke e vleresuar shume te rendesishem mundesimin e furnizmit te vendit me gaz natyror nepermjet alternativave me te favorshme ERE Komisioneri per gazin ne ERE dhe personeli kane ndjekur me vemendje zhvillimet ne shkalle globale dhe rajonale dhe kane marre pjese ne aktivitetet qe kane te bejne me zhvillimin e ketij sektori.

5.3. Sfida per te ardhmen per zhvillimin e sektorit te gazit natyror

Burimet njerezore te ERE te dedikuara per gazin natyror ngelen ende shume te kufizuara dhe kjo edhe per shkak te mos miratimit ende te struktures se re te propozuar prej saj ne perputhje me sfidat e reja.

Formimi i burimeve njerezore te specializuar eshte i rendesishem edhe per aresyen se Shqiperise ne rast te nje zhvillimi te shpejte te sektorit ne funksion te fatit te projektit TAP nga vendimi i pritshem, do ti duhet te kete te pakten nje Operator te Sistemit te Transmetimit. Ligji lejon krijimin te me shume se nje Operatori dhe eksperiencat e vendeve te tjera tregojne se ato mundet te jene edhe publike edhe private. Ciladoqofte forma e cila mundet të gjendet me e përshtatshme në momentin e duhur do të ishte me shume vlere krijim i nje strukture berthame e cila do të mundej të përgatitej për zhvillimet që priten në të ardhmen sikurse do të mundet të ishte me e qarte për variantet që jene me me shume interes për vendin. Per me teper egzistojne shume struktura organizative te OST-te gazit te cilat ofrojne mundesi shume te mira formimi dhe identifikimi oportunitetesh zhvillimit.

Pamje nga Turi Studimor ne Sh.B.A. – Mars 2010-



Ne Kompanine e Gazit te Lenget ne Boston



Ne Rregullatorin e Shtetit
- Ohio – Columbus

Pjesa e Dyte

Analize e Veprimtarise te Entit Rregullator te Energjise

Kapitulli i Pare

1. Funkzioni rregullator dhe struktura e funksionimit te ERE-s.

Struktura dhe menyra e organizimit dhe funksionimit te Entit Rregullator te Energjise eshte e mbeshtetur ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003, "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9946, date 30.6.2008 "Per Sektorin e Gazit Natyror".

ERE eshte nje person juridik publik, me seli ne Tirane dhe perbehet nga Bordi i Komisionereve me nje Kryetar dhe 4 antare, te cilet kane funksion vendim-marres dhe emerohen nga Kuvendi i Shqiperise. Pervec Bordit eshte edhe personeli teknik i organizuar ne 4 drejtori dhe perkatesisht ne Drejtorine e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut, Drejtorine e Cmimeve dhe Tarifave, Drejtorine Juridike, te Mbrojtjes se Konsumatorit dhe te Mardhenieve me Publikun si dhe Drejtorine e Administrate, Finances dhe Burimeve Njerezore.

Aktualisht ne ERE punojne gjithesej 32 punonjes, nga te cilet 4 jane punonjes ndihmes. I tere personeli teknik gezon statusin e Nepunesit Civil.

Ne Aneks-1- eshte paraqitur bllok-skema e struktures organizative te ERE-s se bashku me numurin perkates te punonjesve.

ERE e ushtron veprimtarine e vet ne perputhje me ligjet "Per Sektorin e Energjise Elektrike" dhe "Per Sektorin e Gazit Natyror" dhe eshte autoriteti i vetem rregullator ne Shqiperi ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.

ERE si nje institucion i pavarur ne sektorin e energjise, ushtron pergjegjesite e veta ne keto drejtime kryesore:

- Ne licensimin e shoqerive qe kryejne veprimtari ne sektorin e energjise elektrike apo te gazit natyror.
- Ne percaktimin e tarifave te shitjes me pakice ose me shumice te energjise elektrike si dhe te tarifave per lidhjen dhe hyrjen ne rrjetet e gazit natyror dhe te hapsirave te depozitimit apo te instalimeve te gazit natyror te lenget.
- Ne mbrojtjen e interesave te konsumatoreve ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.
- Ne monitorimin dhe kontrollin e kontratave dhe sherbimeve te te licensuarve dhe sigurise se furnizimit ne sektoret e energjise.
- Ne miratimin e kodeve te funksionimit te rrjeteve dhe te matjes si dhe te rregulloreve apo akteve te tjera nenligjore ne sektoret e energjise.
- Ne nxitjen e efciences, konkurences dhe permiresimin e cilesise se sherbimit ne sektoret e energjise.

Burimet e financimit te ERE-s perbehen nga pagesat e regullimit te te licensuarve dhe nga pagesat e licencave ne sektoret e energjise.

ERE paraqet brenda 31 Marsit te cdo viti ne Kuvend, nje raport vjetor per gjendjen ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror si dhe te veprimtarise te ERE-s, perfshire veprimtarine financiare dhe auditimin e veprimtarive fiskale te saje.

Burimet njerezore te ERE-s jane te organizuara ne tre njesi themelore :

- a- Bordi i Komisionereve
- b- Stafi i ekspertizes teknike
- c- Stafi mbeshtetes.

1.1. Struktura organizative dhe menyra e funksionimit te ERE-s

1.1.1 Bordi i Komisionereve:

Ne strukturen e Bordit te Komisionereve bejne pjese:

- 1- Kryetari i Bordit.
- 2- Kater antare te Bordit.
- 3- Keshilltari i Bordit.
- 4- Sekretaria e Bordit.

Gjithesej 7 punonjes.

Bordi i Komisionereve te ERE-s eshte trupa vendim-marese per te gjitha veprimtarite e rregulluara ne tregun e energjise elektrike dhe gazit natyror. Bordi perbehet nga 4 antare dhe kryetari, te cilet emerohen nga Kuvendi i Shqiperise me nje mandat 5 vjecar.

Bordi shprehet ne trajtimin e gjith problematikes qe trajton, me vendime, te cilat merren ne mbledhje te hapura dhe te njoftuara qysh me pare ne faqen e internetit dhe ne tabelen e njoftimeve te ERE-s. Mbledhjet e Bordit regjistrohen ne audio.

Antareve te Bordit ju vihen ne dispozicion nga stafi teknik te gjitha materjalet me spjegimet dhe informacionet e kerkuara lidhur me ceshtjet qe do te trajtohen per vendimmarrje ne mbledhjet e Bordit.

Bordi ka detyrimin qe te mblidhet jo me pak se nje here ne muaj ne mbledhje formale por ai mblidhet per trajtim problemesh specifike edhe ne takime informuese dhe konsultative.

Gjate vitit 2010 Bordi i Komisionereve ka zhvilluar 44 mbledhje formale, ne te cilat jane marre 119 vendime. Vec mbledhjeve formale Bordi ka zhvilluar edhe takime informuese dhe konsultative cdo here qe ka qen e nevojshme. Ne aneksin 5 jane paraqitur vendimet per ceshtjet kryesore te vendosura gjate vitit 2010.

Vendimet e Bordit, vetem me 3 perjashtime jane marre me shumice te plote (unanimitet) te antareve pjesmarres.

Kryetari i Bordit eshte njekohesisht edhe Drejtor Egzekutiv i ERE-s. Gjate vitit 2010 Kryetari i Bordit ka nxjerre per zbatimin praktik te problemeve qe kerkonin zgjidhje 123 Urdhera, nga te cilet, 41 per zhvillimin e seancave degjimore per zgjidhjen e ankesave te konsumatoreve dhe 82 per organizimin e grupeve te monitorimit te te licensuarve, te tregut, si dhe per organizimin e grupeve te punes

Drejtoria e Burimeve Njerzore, Administrative, Finances




Zj. Julinda Çarka



Zj. Eda Gjergji



Zj. Aferdita Bushi



Zj. Elvana Haxhi


(Drejtores)



Z. Edmond Harroku



Zj. Farie Meta



Zj. Alba Malo



Z. Alban Muça



per hartimin e studimeve, rregulloreve apo akteve te tjera ne sherbim te sektorit te energjise.

Vendimet e Bordit te Komisionereve botohen ne Fletoren Zyrtare te Republikes dhe juridikisht perfaqsojne titull egzekutiv. Apelimi ndaj tyre mund te behet vetem ne Gjykate.

Veprimtaria e ERE-s monitorohet nga Drejtoria e Monitorimit te Kuvendit te Shqiperise. Komisioni i Kuvendit i cili ndjek veprimtarine e ERE-s dhe tek i cili ERE raporton dhe komunikon per informim apo per zhvillim seancash degjimore eshte Komisioni i Veprimtarise Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit.

1.1.2. Stafi i Ekspertizes Teknike:

Eshte i organizuar ne tre drejtori dhe nje sektor:

1. Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave te Energjise Elektrike, me 5 punonjes.
 2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit, me 7 punonjes.
 3. Drejtoria e Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, me 5 punonjes.
 4. Sektori i mardhenieve me jashte me 1 punonjes
- Gjithesej 18 punonjes.

1.1.3. Stafi Mbeshtetes:

Eshte i organizuar ne Drejtorine e Administrate-Finances dhe Burimeve Njerezore me gjithesej 7 punonjes.

1. Drejtor, 1 Arketar-arkivist-magaziner, 1 Specialist IT, 3 shofere dhe 1 Sanitare.

Struktura ekzistues e ERE-s, sipas Vendimit te Kuvendit te Shqiperise Nr 181, date 5.5.2008 , perbehet nga gjithesej 32 punonjes.

Ne Aneksin "A1", bashkalidhur, paraqitet organograma dhe numri i punonjesve te struktures egzistuese te ERE-s.

Mosha mesatare e puonjesve ne vitin 2010 ishte 40.1 vjet.

Me perjashtim te 4 punonjesve te sherbimit, i tere personeli prej 28 punonjesish, eshte me arsim te larte. Te gjithe punonjesit zoterojne gjuhen angleze dhe 30% e tyre zoterojne te pakten edhe nje gjuhe tjeter. 21.4% e punonjesve jane me grade shkencore (3 doktore shkencash dhe 3 me graden master). Gjate vitit 2010 vazhdojne studimet pa shkeputje nga puna edhe 3 kandidat per "Master ne Ekonomi"

Nga 28 punonjes administrativo – teknik, 17 prej tyre ose, 60.7% jane femra. Ne pozicionin vendim-marres, femrat zen 20% te vendim-maresve, ndersa ne pozicionet drejtuese ato zene 53.8%, te personelit drejtues. 5 nga punonjesit tane bejne pjese ne jeten akademike universitare si pedagogje te jashtem.

I tere personeli vendim-marres i eshte nenshtuar trajnimeve ne shkollat e specializuara evropiane te rregullimit ne fushen e energjise. Te njejtat parime jane respektuar edhe per personelin drejtues dhe punonjesit e tjere, duke ndjekur te

njejtat shkolla, por me programe per nivele te ndryshem qe nga fillestaret dhe deri te personeli me pervoje.

Financimet per kualifikimin dhe trajnimin e personelit ne rreth 80% te shumes, jane mbuluar nga buxheti i ERE-s, kurse pjesa tjeter eshte sponsorizuar nga shoqatat evropiane dhe amerikane te rregullatoreve si ERRA, NARUK, MEDREG dhe rregullatore te tjere, me te cilet kemi marredhenie bashkepunimi.

E tere baza logjistike e ERE-s eshte e ndertuara sipas koncepteve dhe teknologjise bashkekohore, po keshtu edhe mjediset e punes jane te pajisura dhe te ndertuara ne menyre qe te krijojne kushte optimale per realizimin e detyrave nga cdo punonjes.

1.2. Trajtimi i Burimeve Njerezore te ERE-s

Edhe per vitin 2010 persa i takon fushes se Burimeve Njerezore eshte zbatuar me perpikmeri Ligji nr.9367 date 07.04.2005” Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjit nr.9049, date 10.04.2003” Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publik”.

Jane plotesuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga te 9 zyrtaret (qe mbartin kete detyrim). 8 Zyrtare i kane plotesuar brenda afateve kohore.

Gjithashtu kemi marre pjese rregullisht ne trajnimet e organizuar nga ILDKP.

Ne muajin shkurt u krye nje kontroll nga inspektoret e ILDKP, nga ana e te cileve nuk u kostatua asnje shkelje ligjore.

Ne zbatim te Vendimit nr.181, date 05.05.2008 te Kuvendit te Shqiperise per miratimin e struktures dhe organikes eshte zbatuar me perpikmeri Ligji nr.9584 date 11.07.2006, ”Per pagat shperblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe te institucioneve te tjera te pavarura te krijuara me ligj.” si dhe Vendimi nr.901, date 19.12.2007 i ndryshuar me vendimin nr.1001, date 2.7.2008 ”Per miratimin e struktures dhe te niveleve te pagave te nepunesve civil/nepunesve te kabineteve dhe punonjesve mbeshtetes ne administraten e disa institucioneve te pavarura “.

Ne vijim te Ligjit nr.9072, date 22.5.2003 ” Per Sektorin e Energjise” i ndryshuar, per perzgjedhjen, emerimin dhe promovimin ne detyre te personelit eshte zbatuar ligji nr.8549, date 11.11.1999 i “Statusit te nepunesit civil”

Ne zbatim te ligjit nr.10 160, date 15.10.2009 “Per rregullimin e sherbimit te transportit per funksionaret publik dhe nepunesit civil, ERE me urdher te brendshem zbatoi ligjin i cili hyri ne fuqi me 19.11.2009, si dhe formularin e autorizimit per levizjen e punonjesve te institucionit.

1.3. Administrimi i burimeve financiare te ERE-s

Ne fushen e administrimit dhe finances jane zbatuar me korektesi legjislacionet perkatese per administrimin e financave te ERE-s, te tille si ligji nr.9072 date 02.05.2003 “ Per sektorin e energjise elektrike” me ndryshimet perkatese, ligji

nr.9643, date 20.11.2006 per “ Prokurimet Publike” te ndryshuar, Ligji nr.9228, date 29.4.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe te tjera legjislacione.

Jane zbatuar te gjitha afatet kohore ne lidhje me dorzimin e realizimin e rregjistrit te prokurimeve te fondeve publike, ne perputhje me ligjin e prokurimeve duke i asistuar te gjitha procedurat perkatese edhe asistence juridike

Ne fillim te vitit 2011 u pergatit bilanci i ERE-s per vitin 2010, dhe ne vijim do te pergatitet ne perputhje me nevojat e ERE-s, projekt- buxheti per vitin 2011. Plani i te ardhurave dhe shpenzimeve eshte miratuar ne Bordin e Komisionereve dhe per respektimin e tij Bordi eshte informuar ne menyre periodike. Bilanci i ERE-s eshte audituar nga nje ekspert kontabel i Autorizuar dhe rezultati eshte miratuar ne Bordin e Komisionereve.

Nga ana e institucionit eshte kryer inventarizimi i pasurise qe ERE ka ne administrim. Per sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit qe ERE u ka caktuar te licensuarve. Per vitin 2010 te ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit jane realizuar 99%.

Bilanci i shpenzimeve te kryera nga ERE, si pjese e permbushjes se detyrimit ligjor per te garantuar nje pune normale te institucionit, si edhe me pare kane konsistuar ne permbushjen e nevojave me te domosdoshme qe ka pasur ERE gjate vitit, ku permendim si me kryesoret:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, tatimet mbi te ardhurat, per te cilat institucioni yne ka shlyer te gjitha detyrimet dhe nuk eshte debitor.
- pagesat per konsulenca
- Publikimet per informim te opinionit publik
- Pagesat per shlyerjet e detyrimeve te sherbimeve si uje, energji elektrike, telefon per te cilat institucioni yne gjithashtu nuk eshte debitor, shpenzime per sherbime te domosdoshme per mbarvajtjen e punes si dhe amortizimi i aktiveve te qendrushme te trupezuara.etj.
- Tarifat e primit te sigurimit te detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorike, si dhe taksat vjetore te regjistrimit.

Gjithashtu jane kryer procedurat e prokurimeve ne kuader te blerjeve te vogla (si pjese e Komisionit te blerjeve Vogla) ne zbatim te ligjeve te prokurimeve per fondet publike.

Gjate vitit 2010 eshte kryer rikonstruksioni i zyrave shtese per zgjerimin e ERE-s me mjedise te tjera, ne perputhje me nevojat ne rritje, per nje veprimtari normale te institucionit. Zgjerimi eshte bere ne godinen egzistuese

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjate vitit 2010 eshte audituar nga nje ekspert kontabel i regjistruar dhe i licensuar per kete aktivitet bazuar ne ligjin nr.10091, date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”. Ne vijim te ketij paragrafi paraqitet raporti perkates i ekspertit kontabel.

2. Veprimtaria e ERE-s per Cmimet dhe Tarifat e Energjise

2.1. Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike per vitin 2010

Bazuar ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 per sektorin e energjise (i ndryshuar), perkatesisht ne nenet 26, 27 dhe 28 sidhe akteve te tjera nenligjore, qe burojne prej tij, ERE ushtron pergjegjesine ligjore per percaktimin e tarifave te aktiviteteve te rregulluara qe realizohen ne sektorin e energjise elektrike.

Ne kete kontekst nje nga veprimtarite kryesore te ERE-s gjate vitit 2010 ishte shqyrtimi i aplikimeve per tarifat e reja nga ana e te licensuarve ne sektorin elektroenergjetik perfshire veprimtarite e prodhimit, furnizimit publik me shumice , transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice te energjise elektrike per klientet tarifore.

Mbi bazen e nje analize te plote dhe te kujdesshme te treguesve teknike, ekonomike dhe financiare, te paraqitur nga te gjitha shoqerite e rregulluara, perfshire KESH sh.a, TEC-Vlore sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sha. ne mbeshtetje te kerkeses se tyre per te ardhura dhe permes nje procesi tejet transparent ERE percaktoi tarifat dhe cmimet per veprimtarite e mesiperme per vitin 2011, te cilat Bordi i Komisionereve te ERE-s i miratoi me Vendimet Nr.95, 96, 97, 98, 99,100, 101,102 te dates 07.12.2010.

2.1.1. Metodologjite dhe procedurat e percaktimit te cmimeve e tarifave.

ERE ne mbeshtetje te Ligjit 9072, date 22.05.2003 ka hartuar dhe miratuar metodologjite per llogaritjen e tarifave te aktiviteteve te rregulluara ne sektorin e energjise elektrike, te cilat jane miratuar perkatesisht me vendimet Nr.76,77,78 dhe 79 date 26/06/2008 te Bordit te Komisionereve.

Nga ana tjeter per te garantuar nje proces transparent dhe te drejte te percaktimit te tarifave u zbatua me korrektesi Vendimi Nr.21 date 18.03.2009 i Bordit te Komisionerve te ERE-s mbi "Rregullat e praktikës dhe procedurave te ERE-s" i cili percakton etapat dhe procedurat permes te cilave duhet te kryhet procesi i aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit te tarifave te energjise elektrike.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per klientet tarifore/fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te kater shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht nga ana e ERE-s.

2.1.2. Tarifa e prodhimit te energjise elektrike per KESH sh.a

Me 1 Shtator 2010, KESH sha. i licensuar per prodhimin e energjise elektrike paraqiti ne Entin Rregullator te Energjise aplikimin per rishikimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike per vitin 2011(periudha e dyte rregullatore).

Drejtoria e Cmimeve dhe Tarifave



Zj. Lavdi Konjari



Zj. Raimonda Islami



Z. Enton Shabaj

(Drejtores)



Zj. Elida Mata



Zj. Doris Çarçani



Tarifa e propozuar nga ana e KESH/Gen per prodhimin e energjise elektrike per vitin 2011 ishte 1.12 leke /kWh, pra me nje rritje prej 180 % nga tarifa e meparshme e vitit 2010 prej 0.4 leke/kWh.

Llogaritja e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga ana e ERE bazohet ne metodologjine e llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin nr. 77, date 26.06.2008 si dhe ne Deklaraten Rregullatore, te miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009.

Te ardhurat e kerkuara per te mbuluar shpenzimet operative dhe ato kapitale per vitin 2011 per KESH Gen, llogariten ne shumen 4,582 milion leke nga 4,712 milion te kerkuara nga shoqeria. Ndryshimi vjen per shkak te saktesimit qe specialistet e ERE-s gjate seancave teknike bene ne menyre te argumentuar lidhur me disa prej zerave te shpenzimeve operative te Shoqerise.

Keto te ardhura te kerkuara u korrigjuan ne zbritje per shumen 1,900 milion leke, te cilat perfaqesojne rreth 11 % te te ardhurave shtese nga eksporti i energjise elektrike te realizuar ne vitin 2010, si rrjedhoje e kushteve te favorshme hidrike. Eshte per t'u theksuar se pothuajse pjesa me e madhe e te ardhurave nga eksporti, rreth 89% i jane akorduar **KESH-it dhe nuk i jane kthyer klienteve tarifore**, kjo me qellim qe KESH Gen te kete ne dispozicion mjete financiare te mjaftueshme per te perballuar situatat e veshtira hidrologjike me te cilat mund te perballtet ne vitet e ardhshme si dhe per perballimin e kostove te kredive aftshkurtra (overdraftete) te trasheguara nga vitet 2007 dhe 2008, ne perputhje me piken 5.7 te Modelit Shqiptar te Tregut.

Duke ju referuar vendimit te ERE-s nr. 95 dt 7.12.2010, tarifa e gjenerimit prej 0.63 leke/kWh rezulton e rritur me 57.5% krahasuar me ate te vitit 2010 prej 0.4 leke/kWh. Tarifa re e propozuar do te krijoje nje situatë financiare normale per realizimin e veprimtarise se Shoqerise KESH sh.a dhe arritjen e objektivave ekonomike nga ana e Kompanine Publike te Prodhimit KESH.

2.1.3. Tarifa e sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice.

Me 1 Shtator 2010, KESH sha., i licensuar per furnizimin me shumice te energjise elektrike, paraqiti ne Entin Rregullator te Energjise aplikimin per rishikimin e tarifes se sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike per vitin 2011, me ane te te cilit kerkoi rishikimin e tarifes nga 2.03 leke/kWh ne 3.97 leke/kWh me nje rritje prej rreth 95%. Nje tarife e tille argumentohet si me poshte:

Nga perfshirja e prodhimit te nje sasie te konsiderueshme energjie elektrike nga TEC-Vlora sh.a i cili ka kosto operimi relativisht te larta per shkak te lendes djegese.

Nga pagesa e 50% te Overdrafteve (per nje shlyerje te plote te tyre brenda 2 viteve) te marra, nga bankat per vitin 2007 dhe 2008. Keto kredi jane marre per mbulimin e kostove per importimin e energjise elektrike gjate ketyre dy viteve .

Llogaritja e tarifes se furnizimit me shumice te energjise elektrike nga ana e ERE-s eshte bazuar ne:

- Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike" si dhe Deklaraten Rregullatore, te miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009;

ERE pas analizes qe i beri aplikimit te kompanise gjate nje periudhe rreth 3 muaj si dhe dhe pas seancave te shumta teknike te organizuara per kete qellim si dhe ne zbatim te Metodologjise se llogaritjes se tarifeve , korrigjoi ne zbritje te ardhurat e kerkuara vjetore ne aplikim nga Shoqeria.

Keto korrigjime konsistuan ne:

- Reduktimin nga 246 GWh ne 24 GWh te sasise se energjise elektrike te planifikuar per t'u shitur tek FPP nga ana e TEC-Vlore.
- Korrigjimin e te ardhurave te teperta te trasheguara nga viti 2010 per nje vlere rreth 1,782 milion leke, per aresye te mosvenies ne pune te TEC- Vlore dhe si pasoje e mos konsumit te lendes djegese te parashikuar per kete qellim (te cilen TEC-Vlora e kishte blere ne vitin 2009 dhe e kishte gjendje) e cila ishte parashikuar si kosto ne tarifen e vitit 2010.

Ne zbatim te metodologjive te llogaritjes se tarifave, kjo shume e te ardhurave te teperta duhet kompesuar/axhustuar ne periudhen pasardhese. Nese ne tarifen e vitit 2010 nuk do te ishte perfshire kjo e ardhur e kerkuar (rezerve) tarifa e FPSH-se do te rezultonte 1,45 leke/kWh dhe jo ajo e miratuar 2,03 leke/kWh ;

Gjithashtu u be koregjimi i cmimit te energjise te blere nga hidrocentralet e vegjel me kapacitete deri ne 15 MW nga 6.85 leke/kWh ne 7.1 leke/kWh.

U konsideruan te aresyeshme kostot per mbulimin e kredive afatshkurtra te marra nga KESH sh.a per shumen 772 milion leke ne muajt Tetor-Nentor 2010 dhe u perfshine ne te ardhurat te kerkuara per vitin 2011

Mbeshtetur ne argumentat e siperpermendur, tarifa e sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike, e miratuar nga ERE, mbulon kostot e operimit per nje veprimtari normale si dhe koston e kredive te marra ne situata te veshtira likuiditeti, per pagesen e detyrimeve qe lidhen me faturat e importit te energjise elektrike.Duke marre ne konsiderate te gjitha korrigjimet e mesiperme, sidhe mbas analizave tekniko-ekonomike,

seancave degjimore teknike dhe publike, te ardhurat e kerkuara vjetore te FPSH per vitin 2011 rezultuan 6,278,722 mije leke, dhe tarifa perkatese prej

Pamje nga Mbledja e Bordit Komisionerereve per cmimet dhe tarifat e energjise elektrike per vitin 2011, (7 Dhjetor 2010)





1.48 leke/kWh nga 2.03 leke/kWh qe ishte ne vitin 2010 pra me nje ulje prej 27% krahasuar me ate te periudhes se mepareshme rregullatore.

2.1.4. Cmimi i energjise elektrike per HEC-et egzistues deri ne 10 MW

Mbeshtetur ne Ligjin e Energjise Elektrike dhe aktet e tjera nenligjore, ERE ka autoritetin dhe pergjegjesine e rishikimit te çmimeve te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga prodhuesit e vegjel egzistues (koncesionare apo private) me fuqi te instaluar deri ne 10 MW si dhe te prodhuesve te rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW.

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et egzistues eshte zbatuar “Metodologjia per llogaritjen e cmimit te unifikuar per shitjen e energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW” miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr.5, date 26.01.2007.

Bazuar ne llogaritjet e bera nga ERE çmimi i shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga te licensuarit koncesionare dhe private, me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, per periudhen 01 Janar 2011 – 31 Dhjetor 2011 u vendos 7.57 leke/kWh.

2.1.5. Cmimi i energjise elektrike per HEC-et e rinj deri 15 MW

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW eshte zbatuar ”Metodologjia per percaktimin e cmimit unik te energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW te dhene me koncension ne baze te Ligjit Nr. 9663, date 18.12.2006 “Per Koncensionet”.

Per te nxitur investimet per shfrytezimin e rezerves hidroenergjetike te vendit, ne te gjitha rjedhat ujore, Qeveria adoptoi nje politike te tille qe e kushtezonte cmimin e shitjes se energjise elektrike, te prodhuar nga keto subjekte, te shoqeria publike KESH sh.a. me çmimin mesatar te importit te vitit paraardhes.

Sipas metodologjise se siperpermendur, per llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike eshte perdorur formula ne vijim;

$$P_u = P_i * 1.1 * R_{ex}$$

ku :

“**P_u**” eshte cmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW,

“**P_i**” eshte cmimi mesatar i importit te energjise elektrike te realizuar nga KESH sh.a. (ne funksionin e FPSH) ne vitin paraardhes,

“**R_{ex}**” - norma mesatare e shkembimit Leke/EUR te publikuar nga Banka e Shqiperise per vitin parardhes.

Persa i perket cmimit mesatar te importit duhet vene ne dukje se gjate vitit 2010, KESH sh.a. nuk importoi energji elektrike per shkak te situates se mire hidrike. Per kete arsye, ne mungese te cmimit mesatar te importit per vitin 2010 te KESH sh.a. ne funksionin e Furnizuesit Publik me Shumice, ERE eshte mbeshtetur ne te dhenat e importit te shoqerise CEZ Shperndarja sh.a. per mbulimin e humbjeve per vitin 2010 bazuar ne arsyetimin qe cmimi mesatar i importit per vitin 2010 nga ana e CEZ Shperndarja sh.a. perfaqeson nje ekuivalent te pranueshem per cmimin mesatar te importit te KESHsh.a. per arsye se:

- perfaqeson cmimet dhe situaten e tregut Rajonal.
- ka qene objekt i monitorimit te ERE-es per sa i takon procedurave te blerjes.

Duke zbatuar kete metodologji llogaritjeje cmimi i energjise elektrike nga HEC-et e rinj qe jepen me koncension me fuqi te instaluar deri ne 15 MW rezulton me 6.89 leke/kWh ose 9 % me i ulet se cmimi per HEC-et egzistues me fuqi deri 10 MW (prej 7.57 leke/kWh) te cilet ndodhen ne shfrytezim.

ERE eshte e mendimit se nje dukuri e tille, qe vjen si rezultat i variacionit te cmimit te importit te energjise elektrike ne vite te ndryshem, nuk perputhet me politiken e Qeverise per nxitjen dhe inkurajimin e investimeve per ndertimin e ketyre hidrocentraleve. Ne keto kushte ERE i ka sugjeruar Qeverise qe nje gje e tille te menjanohet. Nje sugjerim i tille eshte mare ne konsiderate nga ana e Qeverise dhe aktualisht po punohet per te percaktuar nje zgjidhje sa me te pershtateshme duke u mbeshtetur dhe ne pervojen e vendeve te tjera.

2.1.6. Tarifa e sherbimit te transmetimit te energjise elektrike

Operatori i Sistemit te Transmetimit i licensuar per veprimtarine e transmetimit te energjise elektrike paraqiti aplikimin per tarife te vitit 2011 prane ERE-s me date 31.08.2010.

Kerkesa e OST sh.a. permbante nje nivel te ardhurash te kerkuara vjetore prej 4,292 milion leke, te ciles i korespondonte nje tarife mesatare per sherbimin e transmetimit prej 0.73 leke/kWh, pra nje rritje prej 21.6 % krahasuar me tarifen aktuale prej 0.6 leke/kWh.

Rritja e kerkeses per te ardhura per vitin 2010 nga ana e OST sh.a mbeshtetet ne kostot shtese te shlyerjeve te borxheve afatgjata qe lidhen me nje plan teper ambicioz investimesh, qe do ti sherbejne fuqizimit te rrjetit te transmetimit.

ERE ne llogaritjen e tarifes se transmetimit eshte mbeshtetur ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike, te miratuar me Vendimin nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Mbas rishikimit dhe korrigjimit ne zbritje te te ardhurave te kerkuara per vitin 2011 nga ato te parashikuara prej OST sh.a nga njera ane dhe rritjes se sasise se energjise qe parashikohet te levrohet ne rrjetin e transmetimit nga ajo qe planifikoi fillimisht OST nga ana tjeter, ne zbatim te metodologjise perkatese tarifa e transmetimit per vitin 2011 u vendos 0.60 leke/kWh duke mbetur e njejte me tarifen e transmetimit per vitin 2010.

Tarifa e miratuar eshte rezultat i te ardhurave te kerkuara vjetore per te mbuluar te gjitha shpenzimet (OPEX dhe CAPEX) te llogaritura ne shumen prej 3,649 milion leke dhe sasise totale te energjise te parashikuar te livrohet ne rrjetin e transmetimit prej 6,082 GWh.

2.1.7. Tarifa e sherbimit te shperndarjes dhe e furnizimit me pakice te energjise elektrike per konsumatorët fundore per vitin 2011

Shoqeria OSSH sh.a. ne funksionin e saj te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes si dhe te Furnizuesit Publik me Pakice paraqiti ne ERE me date 31.08.2010 aplikimin per tarifen e shperndarjes se energjise elektrike si dhe ate te furnizimit me pakice per klientet tarifore per vitin 2011, si periudhe e dyte rregullatore.

Ne aplikimin e saj OSSH sha, ne funksion te operatorit te shperndarjes dhe te furnizuesit me pakice, per vitin 2011 kerkoj sa me poshte:

- Te ardhura per aktivitetin e shperndarjes dhe te furnizimit me pakice ne masen 45,798 milion leke duke mos parashikuar rritje te tarifes per veprimtarine e furnizimit me shumice (nga KESH-i) dhe te transmetimit (nga OST-ja).

Nje kompensim te llogaritur nga OSSH sh.a per vitin 2009 dhe 2010 (4,667 milion leke) per efekt te kompensimit te humbjeve dhe amortizimit per keto vite sidhe kompensimin per borxhin e keq prej 1,460 milion leke dhe gjate vitit 2011.

Cmimi mesatar me pakice per klientet tarifore u kerkua qe te ishte 10.98 leke /kWh ose 15 % me i larte se cmimi mesatar ekzistues.

Shqyrtimi dhe miratimi i ketyre tarifave nga ana e ERE-s u bazua:

- ne Vendimin Nr.79 date 26.06.2008 te Bordit te Komisionereve te ERE-s “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se shperndarjes se energjise elektrike” ,
- ne Deklaraten Rregullatore te miratuar nga ERE me Vendimin Nr.12, date 03/03/2009
- ne. Vendimin Nr.46 te Bordit te Komisionereve date 14.06.2010“ Mbi kerkesen e OSSH-se lidhur me nivelin e humbjeve te energjise per vitin 2008”.
- Ne vendimin Nr.84 date 15.11.2010” Per miratimin e aplikimit te CEZ Shperndarje sh.a per miratimin e planit te investimeve te vitit 2011”
- Ne vendimin Nr.93 date 30.11.2010 “ Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit”

Sipas Deklarates Rregullatore OSSH-se i njihet e drejta qe me ane te mekanizmit te kompensimit te bej vleresimin e te ardhurave te munguara te periudhes se meparshme rregullatore per tu reflektuar ne te ardhurat e perlllogaritura per priudhen rregullatore aktuale, konkretisht te vitit 2011.

Pas shqyrtimit te kujdesshem te kerkeses se OSSH sh.a., si dhe pas sqarimeve dhe informacionit shtese te dhene ne seancat teknike, ERE vendosi t'i njohe CEZ Shperndarje:

- te ardhura te arsyeshme per veprimtarine e shperndarjes dhe te furnizuesit publik me pakice nje shume prej 40,356 milion leke per vitin 2011.
- tarife te sherbimit te shperndarjes 6.30 leke/kWh
- tarifat per klientet fundore tarifore te paraqitura ne tabelen 6.1 me poshte

Ne perfundim te analizave dhe metodologjise se perdorur cmimi mesatar me pakice per konsumatoret tarifore rezultoi 9.53 leke/kWh qe eshte i njejte me cmimin mesatar te miratuar nga ERE per vitin 2010.

Ky cmim mesatar shperndahet tek grupet e konsumatoreve tarifore sipas tabelës -6.1-

Sikurse shihet ne tabelen perfundimtare te cmimeve te percaktuara nga ERE ruhet edhe per vitin 2011 faturimi me blloqe konsumi per konsumatoret familjare duke respektuar te njejtin kufi prej 300 kWh per bllokun e pare dhe mbi 300 kWh per bllokun e dyte. Ne grafikun e figures -6.1.- eshte paraqitur struktura e tarifes per konsumatoret familjare. Analiza e kesaj strukture eshte kryer duke i siguruar OSSH-se te ardhurat e nevojshme nga klientet ne perputhje me bilancin financiar te parashikuar per vitin 2011.

E rendesishme eshte te theksohet se kjo strukture cmimi e konsumatoreve familjare dekurajon perdorimin e energjise elektrike per ngrohje te mjedisit, mbasi sikurse eshte vertetuar nga nje sere studimesh, konsumi i energjise elektrike per ngrohje fillon ne nivelin e konsumit mbi 300 kWh ne muaj. Egzistojne te gjitha mundesite qe ngrohja e mjedisit te realizohet me lende te tjera energjetike alternative. Me interes eshte gjithashtu fakti se 71 % e konsumatoreve familjar shpenzojne me pak se 300 kWh/muaj.

Per te pasur nje transformim te shpejte te gjendjes, persa i perket rritjes se eficiences se konsumit te energjise elektrike e gjithë vemendja duhet te perqendrohet ne permiresimin me ritme te larta te situates ne OSSH, mbasi ky ka qene edhe nje nga qellimet kryesore te privatizimit te kesaj shoqerie.




Figura-6.1-

(Burimi ERE)

Ne grafikun e figures -6.2.- eshte paraqitur ecuria e cmimeve te energjise elektrike gjate periudhes 2005-2009, ku shume domethenes eshte fakti qe cmimet konsumatoreve jo familjar u ulen me 18% per te kaluar keshtu ne tendencat e sotme perendimore ku cmimet per jo familjaret jane me te ulta se ato te familjareve.

Ne se efienca e konsumit te enrgjise elektrike ne vendin tone do te ishte me e mire, cka nenkupton se humbjet e energjise elektrike, teknike dhe jo teknike, do te ishin brenda standarteve te kerkuara, atehere si pasoje e prodhimit me kosto me te ulet te energjise elektrike nga burimet hidro, edhe cmimet e energjise elektrike do te ishin me te ulta.




Figura-6.2-

(Burimi ERE)

Tabela 6.1.

(Burimi ERE,)

Cmimet e shitjes me pakice per konsumatorët tarifore, te miratuar nga ERE per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2011					
Niveli i Tensionit	Kategorite e Konsumatoreve	Viti 2011			
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi I energjise ne pik (leke/kWh)	Cmimi I energjise reaktive (leke/kVAr)	
TENSIONI I LARTE	Kliente te Transmetimit TL me asetë te zoteruar prej tyre				
	Industri	6.20	6.51	0.93	
	Tregeti & sherbime				
	Bujqesi				
	Te tjere				
	Kliente te furnizuar ne N/S 110 kV te shperndarjes				
	Industri	8.00	8.40	1.20	
	Tregeti & sherbime	8.00	8.40	1.20	
	Bujqesi	8.00	8.40	1.20	
	Te tjere	8.00	8.40	1.20	
TENSIONI I MESEM	Kliente te furnizuar ne 35 kV				
	Industri	8.50	8.93	1.28	
	Tregeti & sherbime	8.50	8.93	1.28	
	Bujqesi	8.50	8.93	1.28	
	Te tjere	8.50	8.93	1.28	
	Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV				
	Industri	9.10	9.56	1.37	
	Tregeti & sherbime	10.00	10.50	1.50	
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	7.46	1.07	
	Bujqesi	8.70	9.14	1.31	
	Te tjere	9.70	10.19	1.46	
	Buxhetore	11.50	12.08	1.73	
	TENSIONI I ULET	Kliente te furnizuar ne TU			
		Industri	10.50		
Tregeti & sherbime		12.20			
Furra buke, prodhim mielli		7.60			
Bujqesi		10.50			
Te tjere		12.00			
Buxhetore		14.00			
Familjare					
Blloku I pare deri ne 300 kWh		7.70			
Blloku I dyte mbi 300 kWh		13.50			
Tarifa fikse e sherbimit te furnizimit per leximin "zero" (leke/muaj)		200			
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)		8.00			
Mesatare Totale		9.53			

Orari gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik eshte:

1 Nentor – 31 Mars Ora 18:00 – 22:00

1 Prill - 31 Tetor Ora 19:00 – 23:00

2.1.8. Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike ne tregun e BE-se, viti 2009

Karakteristike e sistemit tarifar per konsumatorët fundor ne vendet e BE-se eshte adoptimi i nje strukture tarifore te mbeshtetur ne 6 blloqe konsumi per konsumatorët industriale dhe ne 5 blloqe konsumi per konsumatorët familjare. Blloqet jane te ndertuar sipas konsumit vjetor ne kufijt qe paraqiten ne tabelen -6.2 -

Tabela 6.2.

(Burimi ERE,)

Tipi i Konsumatorit	Konsumi vjetor i energjise elektrike ne MWh/Vit					
	< 20	20 - 500	500 – 2,000	2,000 - 20,000	20,000 - 70,000	70,000 - 150,000
Industriale	< 20	20 - 500	500 – 2,000	2,000 - 20,000	20,000 - 70,000	70,000 - 150,000
Familjare	< 1.0	1.0 – 2.5	2.5 - 5	5 – 15	>15	--

Ne grafikun e figures -6.3.- jane paraqitur tarifat e energjise elektrike para dhe pas taksimit (TVSH-se)per konsumatorët jo familjare, per te gjitha vendet e BE-se, ne cent euro/kWh dhe ne lek/kWh (duke ju referuar kursit te kembimit 1Euro = 130 leke) per nje konsum mujor 41,000 – 164,000 kWh. Cmimi mesatar i energjise elektrike si BE per konsumatorët industrial ne kete bllok konsumi eshte 12.97 centEuro/KWh (ose 16.86 Lek/kWh).

CMIMET E ENERGIJISE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET JO-FAMILJAR TE VENDEVE TE BE-se,Viti 2009
(Per nje konsum mujor 41000 - 164000 kWh)




Figura 6.3.

(Burimi Rregullatori Italian,)

Ne grafikun e figures 6.4. jane paraqitur cmimet e enrgjise elektrike per konsumatorët familjar per nje konsum mujor 200-400 kWh. Ne kete rast cmimi mesatar i energjise elektrike si BE rezulton 16.91 Euro cent/kWh (ose 21.98 Lek/kWh).

CMIMET E ENERGJISE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET FAMILJAR TE VENDEVE TE BE-se, VITI 2009
(Per nje konsum mujor 200 - 400 kWh)




Figura 6.4.

(Burimi Rregullatori Italian,)

3. Veprimtaria e ERE-s ne Sektorin e Licensimit per Vitin 2010

Sektorin e Licensimit gjate vitit 2010 ka kryer nje veprimtari te gjere per licensimin e subjekteve ne veprimtari te ndryshme ne sektorin e energjise.

Gjate vitit 2010, jane paraqitur 34 aplikime per licensim. Per 25 nga keto aplikime, Bordi i Komisionereve vendosi licensimin e tyre ndersa 9 aplikime jane ne proces licensimi.

Jane kryer procedurat dhe eshte dhene statusi i klientit te kualifikuar nga ana e Bordit te Komisionereve per kater aplikues.

Ne tabelen ----- paraqiten licensimet e kryera sipas llojit te veprimtarise gjate viti 2010.

Tabela -7.1 -

AKTIVITETI I LICENSUAR	NUMURI I LICENSAVE TE MIRATUARA
Prodhim i energjise elektrike	12
Furnizues i kualifikuar i energjise elektrike	3
Tregtues i energjise elektrike	8
Modifikim i Licences ekzistuese	1
Rinovim i Licences ekzistuese	1

3.1. Licensimet ne veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike

- Ne fushen e prodhimit te energjise elektrike operojne 51 shoqeri nder te cilat 47 shoqeri jane licensuar per kete veprimtari dhe 4 shoqeri jane ne proces licensimi.

Tabela -7.2-

Lloji I Impjanteve	Shoqerite prodhuese	Numri i impjant eve	Kapaciteti i instaluar (MW)		Kapacitet e ne pune gjate vitit 2010 (MW)	Prodhimi 2010 (MWh)
H/C	KESH sha	6	1475	1 701.5	1 ,475	7 552 318
	Privat/Koncesion	92	226.5		42	159 040
TEC	TEC-Fier (KESH sha)	1	159	256	0	0
	TEC-Vlora	1	97		97	28 749
Impjante Eolike	Private	7	1277	1 277	0	0
Impjante Biomase	Private	1	230	230	0	0
GJITHSEJ		108	3, 464.5	3, 464.5	1,573	7, 711, 358

- Ne tabelen -7.2- paraqiten disa te dhena mbi kapacitetet prodhuese te energjise elektrike ne Shqiperi.

Gjate vitit 2010

- Jane licensuar per aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike 12 shoqeri private per te realizuar prodhim te energjise elektrike ne 17 impjante hidro (H/C-e) Fuqia e instaluar e ketyre H/C-eve eshte 64.12 MW
- Jane ne process Licensimi edhe 4 shoqeri te tjera per prodhim energjie elektrike nepermjet 12 impjanteve hidrike (H/C-e), me nje fuqi te instaluar 24.6 MW.

•

Ne tabelen 7.3. paraqiten te dhenat per shoqerite e licensuara dhe ne proces licensimi per vitin 2010

Subjekti prodhues	Licensuar	Afati licenses	Hidrocentrali	
HIDROALBANIA Energji shpk	Vendimi nr.11 dt.08.02.2010	7/2/2040	HEC Borje	1.5 MW
	Vendimi nr.11 dt.08.02.2010	7/2/2040	HEC Oreshke	5.6 MW
	Vendimi nr.11 dt.08.02.2010	7/2/2040	HEC Cernaleve	2.95 MW
	Vendimi nr.11 dt.08.02.2010	7/2/2040	HEC Cernaleve	13.27 MW
Power Elektrik Slabinje shpk	Vendimi nr.10 dt.08.02.2010	7/2/2040	HEC Sllabinje	9.3 MW
HEC Bishnica 1,2 shpk	Vendimi Nr.23 dt.23.03.2010	22/03/2040	HEC Bishnica II	2.5 MW
C & S Construction Energy shpk	Vendimi Nr.34 dt.21.04.2010	20/04/2040	HEC Rapuni I	4 MW
	Vendimi Nr.34 dt.21.04.2010	20/04/2040	HEC Rapuni II	4.1 MW
HydroEnergy shpk	Vendimi Nr.25 dt.29.03.2010	28/03/2040	HEC Murdhar I	2.68 MW
	Vendimi Nr.25 dt.29.03.2010	28/03/2040	HEC Murdhar II	1 MW
“Venerg “ shpk	Vendimi Nr. 51, date 05.07.2010	04.07.2040	Hec Dardhe	4 MW
“Dishnica Energy” shpk	Vendimi 53, date 19.08.2010	18.08.2040	Dishnice	0.2 MW
Elektro Lubonje” shpk	Vendimi Nr.54, date 25.08.2010	24.08.2040	Lubonje	0.3 Mw
“Koka & Ergi Energy Peshk” shpk	Vendimi Nr. 73, date 11.10.2010	10.10.2040	Hec Peshke	3.43 MW
”Ansara Koncension” shpk	Vendimi Nr. 89, date 15.11.2010	14.11.2040	Hec Labinot –Mal	0.25 MW
”Energy Plus” shpk	Vendimi Nr. 110, date 22.12.2010	21.12.2040	Hec Pobreg	9 MW
Selca Energji shpk	Vendimi Nr.39 dt.05.05.2010	4/5/2040	HEC Selce	0,4 MW
Hec Vlushe shpk	Ne proces Licesnimi		Hec –Vlushe me fuqi	14.2 MW
Hec Dunice shpk	Ne proces Licesnimi		Hec – Trebinje 1 me fuqi	0.39 MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec – Treginjje 2, me fuqi	0.68 MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec – Dunice me fuqi	0.75 MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec - Potgozhan me fuqi	0.692 MW
	Ne proces Licesnimi		Hec – Kalivac me fuqi	0.73 MW
”Korkis 2009” shpk	Ne proces Licesnimi		Hec – Belesova 1 me fuqi	0.150 MW
	Ne proces Licesnimi		Hec –Belasova 2 me fuqi	0.280 MW
Hec Dragoshtunje shpk	Ne proces Licesnimi		Hec – Zanore me fuqi	1.2MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec – Dragoshtunje me fuqi	3.1 MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec – Sheja me fuqi	1.6 MW;
	Ne proces Licesnimi		Hec – Ura me fuqi	0.8 MW

Drejtoria e licensimit dhe Monitorimit



Z. Adriatik Bego



Z. Agim Nashi



Z. Erind Kraja



Z. Kristaq Zhupa

(Drejtor)



Zj. Eva Hyna



Zj. Merita Islami



3.2. Licensimet ne veprimtarine e tregtimit te energjise elektrike

Tabela - 7.4 -

Shoqeri Tregtare	Te dhena te licensimit
GSA shpk	Vendimi nr. 79 dt.21/12/2007 Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008
Spahiu Gjanc shpk	Vendim nr. 34 dt. 08/06/2007 Vendimi nr. 35 dt. 08/06/2007 Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008
Universi shpk	Vendimi nr.113 dt. 24/09/2008
Gen – I Tirana shpk	Vendimi nr.130 dt 02/12/2008
Enpower albania shpk	Vendimi nr.08 dt 04/02/2009
KESH sha	Vendimi nr. 23 dt. 25/03/2009
Wonder Power sha	Vendimi nr. 34 dt. 07/05/2009
EFT Albania shpk	Vendim nr.53 dt 03/08/2009
EGL Albania sha	Vendim nr.92 dt 08/12/2009
CEZ Trade Albania shpk	Vendimi nr.1 dt.20/01/2010
Alpiq Energy Albania shpk	Vendimi Nr.27 dt.02.04.2010
CABLE SYSTEM shpk	Vendimi Nr.36 dt.27.04.2010
400 KV shpk	Nr.37 dt.27.04.2010
“HYDRO ENERGY” SHPK	Nr. 25.05.2010
“YLLIAD “ SHPK	NR. 108, date 22.12.2010
“ENERGY PLUS” SHPK	Nr. 109, date 22.12.2010
“Rudnap Energy Tirana” shpk	Nr. 88, date 15.11.2010
“Energy Partner Al” shpk	Ne pritje per licensim
Hec Vlushe	Ne pritje per licensim

Hec Dragoshtunje	Ne pritje per licensim
Hec Dunice	Ne pritje per licensim

- Ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike jane pajisur me licence dhe kane aktivitet 17 shoqeri .
- Vetem gjate vitit 2010, jane pajisur me licence 8 shoqeri per aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike dhe 4 te tjera jane ne process licensimi

Furnizues te Kualifikuar ne vitin 2010

Tabela -7.5-

1	“CEZ Trade Albania” shpk	Furnizues i Kualifikuar	Nr. 02, date 20.01.2010
2.	“Alpiq Energy Albania” shpk	Furnizues i Kualifikuar	Nr. 28, date 02.04.2010
3.	“EGL Albania” sha	Furnizues i Kualifikuar	Nr. 44, date 07.06.2010

Kliente te kualifikuar ne vitin 2010

Tabela -7.6-

1	Fabrika e cimentos Elbasan	Klient i Kualifikuar i Energjise Elektrike	Nr. 42, date 31.05.2010
2.	Fabrika e cimentos Fushe – Kruje	Klient i Kualifikuar i Energjise Elektrike	Nr. 43, date 31.05.2010
3.	City Park	Klient i Kualifikuar i Energjise Elektrike	Nr. 92, date 30.11.2010
4.	Colacem Albania	Klient i Kualifikuar i Energjise Elektrike	Nr. 91, date 30.11.2010

Ne Aneks 4 eshte paraqitur i plote Rregjistri i te licensuarve ne aktivitetet e sektorit te energjise elektrike

4. Veprimtarija e ERE-s ne monitorimin e Tregut te Energjise Elektrike

4.1. Monitorimi i Tregut te Energjise Elektrike

Ne zbatim te ligjit Nr.9072, date 22.5.2003 “Per sektorin e energjise elektrike” i ndryshar, nei 8, pika 2 geramat f) dhe g) si dhe neni 63, ERE-ja ka autoritetin dhe detyrimin per te monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar sherbimet e operatoreve te licensuar ne lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdherave te ERE-s.

4.1.1. Parimet e Monitorimit te Tregut te Energjise Elektrike

Monitorimi i te licensuarve ne tregun e energjise elektrike eshte realizuar gjate vitit 2010 ku pervec strukturave te specializuara jane angazhuar edhe specialiste nga strukturat e tjera perberese te ERE-s.

Monitorimet jane kryer bazuar ne Rregullat e Tregut si dhe te rregulloreve perkatese qe veprojne pjesmamrresit e tregut.

Keto monitorime jane kryer bazuar ne plane tematike paraprake dhe organizuar ne menyre te tille qe te monitorohen ne vazhdimesi rezultatet e pjesmarresve te tregut te energjise elektrike.

Procesi i monitorimit eshte kryer duke ndjekur periodikisht hapat e meposhteme :

- Mbledhja dhe perpunimi i rezultateve periodike(mujore) dhe informacioneve.
- Perpunimi i rezultateve dhe percaktimi i vlerave te indikatoreve te performances.
- Raportim i analizes se treguesve te performances se pjesmarresve te tregut te energjise elektrike prane Bordit te Komisionereve te ERE-s.
- Diskutim i zgjeruar i problematikave ne mbledhjet periodike te Bordit te Komisionereve te ERE-s.
- Percaktim i qendrimit te ERE-s lidhur me performancen e opraoreve si dhe pergatitja e qendrimeve dhe rekomandimeve per to.
- Identifikim i ceshtjeve per monitorim ne terren.
- Kryerja e monitorimeve ne terren dhe analizim
- Percaktim i qendrimit dhe rekomandimeve te ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet.

4.1.2. Monitorimi i KESH Sh.a

Gjate vitit 2010, sektori i monitorimit te tregut dhe grupe te vecanta pune te ngritura prane ERE-s kane kryer tre monitorime per aktivitetin e prodhimit dhe eksport-importit per shkak edhe te situates emergjente gjate kesaj periu dhe. Klasifikimi si shitje ne kushtet e prurjeve te medha eshte bere ne perputhje me Rregullat dhe Procedurat e Shitjes se Energjise Elektrike. Per rezultatet e ketyre monitorimeve eshte raportuar prane Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Si rrezultat i situates se favorshme hidroenergetike gjate vitit 2010 KESH Sh.a ka shitur 2,934,226.000 kWh me nje vlere 119,101,562.21 EURO.

4.1.3. Monitorimi i CEZ Shperndarje Sh.a

Nje pjesmarres i rendesishem i Tregut te Energjise Elektrike eshte kompania CEZ Shperndarje Sh.a e cila ne zbatim te Modelit te Tregut te Energjise Elektreke ka pergjegjesine per importin e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne Rrejtin e Shperndarjes. Ne Deklarten Rregullatore percaktohen rregullat dhe procedurat me te cilat CEZ Shperndarje Sh.a do te realizoje importet e energjise elektrike.

Gjate vitit 2010 jane kryer dy monitorime per te verifikuar zbatimin e rregullave dhe proceduarave te importeve te realizuara nga CEZ Shperndarje.

Ne perfundim te monitorimit te periudhes Janar-Qershor 2010, u konstatua diference ne plotesimin e sasise se energjise elektrike per mbulimin e humbjeve per kete periudhe. Nga ana e ERE-s u la detyre per plotesimin e diferencave te shkaktuara gjate kesaj periudhe, detyre e cila u plotesua deri ne fund te vitit 2010. Gjate vitit 2010 CEZ Shperndarje Sh.a ne zbatim te Rregullave te Tregut ka ngritur strukturen perkatese per parashimin e ngarkeses me baze orare per furnizimin e panderprere per energji elektrike te konsumatoreve tarifore.

4.1.4. Monitorimi i OST Sh.a

Ne vitin 2010 jane kryer ne OST Sh.a dy monitorime per zbatimin e Rregullave te Tregut. Nga keto monitorime u konstatuan mangesi dhe u lane detyra per rolin qe duhet te luaje Operatori i Tregut per funksionim normal dhe transparent te tregut.

Nga ana e OST Sh.a u krye riorganizimi i struktures se operatorit te tregut.

Gjate vitit 2010 jane miratuar “ Rregullat per Garancite Financiare per Rregjistrimin ne Tregun e Energjise Elektrike”, “ Marreveshja per Pjesmarrje ne Treg” si dhe “ Rregullorja per Proceduren e Rregjistrimit ne Tregun e Energjise Elektrike”. Keto rregulla bejne te mundur zhvillimin e nje tregu transparente dhe funksional ne zbatim te Direktiva te Bashkimit European.

5. Veprimtaria e ERE-s ne Sektorin Juridik dhe Mbrojtes së Konsumatorit

Një pjesë e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në sektorin e energjisë elektrike. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë miratuar gjate vitit 2010 apo janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me mjaft rëndësi.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nenligjore nga ana e ERE është bërë në çdo rast duke marrë parasysh së pari tu krijojë palëve të treta mundësi njohje me përmbajtjen e dokumentave, mundësinë për dëgjimin e paleve të interesuara nëpërmjet dërgimit të opinioneve apo komenteve të ndryshme apo edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen e elektronike të ERE-s. Nëpërmjet këtij procesi ERE ka synuar marrjen e komenteve dhe njohjen me këndvështrimin e palëve të treta për rregullimin e tregut të energjisë elektrike përmes akteve nënligjore që ERE miraton. Po ashtu edhe finalizimi i procesit garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun.

Në mënyrë më të detajuar gjatë vitit 2010, ERE ka miratuar si dhe ka në proces aktet rregullatore që vijonë më poshtë të grupuara në:

- Aktet nenligjore të miratuara nga ERE,
- Ndryshime në legjislacionin primar të Sektorit të Energjisë Elektrike.

5.1. Aktet nënligjore të miratuara nga ERE

Udhëzuesi për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo Modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST.


Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit



Zj. Eriola Sadushi




Z. Eduard Elezi
(Drejtor)



Zj. Entela Çipa



Zj. Eltona Dragoti



Zj. Ela Nikaj



Gjatë vitit 2010 nga ERE u përpunua dhe përpilua drafti përfundimtar i “Udhëzuesit për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a”. Ky udhëzues u miratua me vendimin nr.2 datë 10.01.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të botuar në Fletoren Zyrtare n.6, datë 31.01.2011, në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Nr. 9072, datë 22.05.2003, me shtesat dhe ndryshimet përkatëse, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shërbimit të transmetimit të përcaktuar nga ERE, si dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionet kryesore të OST sh.a, në përputhje me licensën e dhënë nga ERE. Nëpërmjet këtij udhëzuesi përcaktohet mënyra, formati i aplikimit dhe tarifat përkatëse, sipas të cilave paguhen lidhjet e reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit të lidhjeve ekzistuese, në rrjetin elektrik të OST sh.a. Këto pagesa kryhen në funksion të shpenzimeve që ndërlidhen me këto procese.

5.1.1. Rregullat dhe Proçedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2010 ERE në zbatim të nenit 8, pika 2 gërma ”l“, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe VKM Nr.338, datë 19.03.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar, rishikoi “Rregullat dhe Proçedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike”. Këto ndryshime të kërkuara nga KESH sh.a janë miratuar se fundmi me vendimin nr. 1, datë 10.01.2011 dhe merrnin në konsideratë situatën tejet të mirë hidrike të vitit të kaluar si rezultat i prurjeve të mëdha të lumit Drin. Me këto ndryshime

mundësohen procedura të thjeshta e operime të shpejta gjithmonë nga ana e KESH sh.a bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e shitjes së energjisë elektrike pa cënuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klienteve, duke mos e kushtëzuar procesin e shitjeve të energjisë elektrike nga KESH sh.a me procesin e blerejeve të energjisë elektrike si dhe duke saktësuar se KESH sh.a është përgjegjës për përcaktimin në sasi dhe në kapacitet, të energjisë elektrike që do të shitet sipas procedurave të kësaj rregulloreje si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj e që bazohet mbi optimizimin e përdorimit të burimeve energjetike sipas planifikimit të kryer nga KESH sh.a

5.1.2. Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksioneve

Në proces përpunimi nga ana e ERE-s janë edhe rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të cilat gjejnë mbështetje në ligjin nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” i ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me VKM Nr. 338, datë 19.3.2008 dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin Nr. 68, datë 23.6.2008. Këto Rregulla specifikojnë procedurat dhe kriteret e ankandit për alokimin e kapaciteteve disponibël ndërkufitar ndërmjet zonës së kontrollit të OST sh.a dhe Operatoreve të Sistemit të Transmetimit fqinjë në linjat e interkonjeksionit në të dyja drejtimet përfshirë linjat Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Kosovë dhe Shqipëri-Mali i Zi.

5.1.3. Rishikimi i Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Tariforë

Gjatë vitit 2010, ERE nisi procesin për rishikimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Tariforë, pasi kontrata aktuale që rregullojnë marrëdhëniet konsumator – furnizues, reflektonte situatën në të cilën u hartua dhe miratua kjo kontratë, gjendjen e sistemit elektronergjetik, gjatë vitit 2005, në kushtet e një mungese të burimeve të furnizimit nga burimet hidrike vendase, si dhe në kushtet e pamjaftueshmërisë së linjave të interkonjeksionit. Në kushtet aktuale, pas procesit të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, duke marrë në konsideratë detyrimin sipas Deklaratës Rregullore për miratimin e kushteve të reja të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, por edhe kërkesat për një kontratë të re të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë, të paraqitura nga subjekte të ndryshme në seancat

dëgjimore publike të organizuara nga ERE, u vlerësua e nevojshme ndërhyrja në kontratën aktuale për ta përmirësuar dhe përshtatur atë me standartet e reja që pritet të miratohen duke garantuar një mbrojtje më të plotë të konsumatorit në marrëdhënien e tij me kompaninë.

5.1.4. Standartet e Cilësisë së Furnizimit me Energji Elektrike

Paralisht me rishikimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike ERE ka përpunuar gjatë vitit 2010, një draft Rregullore për Cilësinë e Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike, e cila ka për qëllim të krijojë kushtet e një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë me energji elektrike, të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të përcaktojë treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Gjithashtu për herë të parë në këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe detyrimet e ndërsjellta në rastet e mosrespektimit të detyrimeve të furnizuesit me energji elektrike dhe përfituesit të shërbimit, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje. Në kaptituj të veçantë kjo rregullore përcakton Rregullat e vazhdueshmërisë së Furnizimit; Rregullat për cilësinë tregtare të Shërbimit; Rregullat për cilësinë e Tensionit.

5.1.5. Mbi Dhënien e Statusit të Klientit të Kualifikuar

ERE me vendimin nr. 107, datë 10.12.2010, miratoi “Nivelit e Konsumit Vjetor të Energjisë Elektrike “Për Përfitimin e Statusit të Klientit të Kualifikuar për vitin 2011.” Ky miratim u bë në mbështetje të nenit 48, pika 1, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe Ligjit nr.9501 datë 03.04.2006, “Për Ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë. Qëllimi i përcaktimit të Nivelit të Konsumit Vjetor, nga ana e ERE-s, është që të gjithë klientet familjarë dhe jo familjarë të energjisë elektrike të kenë mundësi në zgjedhjen e furnizuesit dhe rrjedhimisht të drejtën për të përfituar statusin e klientit të kualifikuar. Në këtë mënyrë plotësohet më mirë harmonizimi i legjislacionit tonë në sektorin e energjisë me angazhimet e marra nga ana Republikës së Shqipërisë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në mënyrë të veçantë pjesës që lidhet me përcaktimin e pikës 3, të Shtojcës “A”, ku thuhet se: *Secila Palë Kontraktuese duhet të sigurohet që klientë të kualifikuar brenda kuadrit të Direktivave të Komunitetit European 2003/54/EC dhe 2003/55/EC do të jenë:*

- i) Nga 1 janari 2008, të gjithë konsumatorët jofamiljarë;
- ii) nga 1 janari 2015 të gjithë konsumatorët.

5.1.6. Amendimet ne legjislacionin primar ne sektorin e energjise elektrike

Ligji nr. 10361 date 16.12.2010 “ Per disa ndryshime ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”

Më datë 16.12.2010, Kuvendi miratoi Ligjin nr.10361, date 16.12.2010 "Për një shtesë në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Detyrimet kryesore për ERE-n, në funksion të këtyre ndryshimeve konsistojnë në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore si më poshtë:

- Miratimi i rregullave dhe procedurave, sipas të cilave bëhen shkëmbimi, blerja dhe shitja e energjisë elektrike nga dhe te furnizuesit/tregtarët vendas dhe të huaj. (neni 2 në ligjin e sipercituar).

- Miratimi i kontrates tip të propozuar nga DPM-ja për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet Subjekti/organi i autorizuar me shpërndarësin për verifikimin e tipit të miratuar të aparateve matëse të energjisë elektrike, kur vendosen në treg përherë të parë dhe/ose në përdorim (instalim) nga subjekti i autorizuar, dhe për inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, të kolaudimit, të vulosjes, si dhe të mirëmbajtjes së tyre, nga subjekti/organi i autorizuar. (neni 3 pika 9).

- Miratimi i metodologjisë për Llogaritjen e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, (neni 3 pika 14)

5.1.7. Trajtimi i proceseve gjyqësore

Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, gjatë vitit 2010, ka ndjekur edhe në një sërë çështjesh gjyqësore që kanë patur zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Apelit Tiranë si edhe në rrethin e Beratit.

Mosmarrëveshjet që janë trajtuar në këto gjykime kanë qënë kryesisht ankimime nga subjektet e licënuara nga ERE dhe ankesa të qytetarëve (konsumatorëve) për mbifaturime të energjisë elektrike.

Kryesisht ERE ka marrë pjesë në cilësinë palës së e tretë në këto gjykime dhe në katër raste ERE ka qënë palë e paditur, respektivisht me gjyqet e OSSH sh.a për cmimet e energjisë elektrike për vitin 2010 dhe humbjet e po këtij viti (objekti: Konstatim i pavlefshmërisë absolute për shkak të paligjshmërisë dhe pathemelsisë së Vendimit të ERE-s nr.98 date 15 Dhjetor 2009, “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a për periudhën 1 Janar 2010 – 31 Dhjetor 2010, nr.100 datë 15 Dhjetor, 2009 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 Janar

2010 - 31 Dhjetor 2010, dhe nr.105, datë 28 Dhjetor 2009, “Mbi ankimin e OSSH sh.a mbi Vendimet e Bordit të Komisionerëve nr.98 datë 15.12.2009 dhe nr.100, datë 15.12.2009 anulimin dhe ose shfuqizimin e tyre dhe detyrimin e ERE-s për të nxjerrë aktet administrative në përputhje me Ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe objekti: Kundërshtim i Vendimit nr.86, datë 06.11.2009, të Entit Rregullator të Energjise për mos marrjen në konsideratë të ankimit të OSSH sh.a dhe lënien në fuqi të Vendimit nr.77, datë 16.10.2009), procese këto për të cilat gjykata vendosi pushimin e gjykimit me kërkesë të palës paditëse. Një proces tjetër gjyqësor ende në shqyrtim është ai ndërmjet ERE-s dhe njërit prej ortakëve të dy shoqërive të licensuara nga ERE, me objekt : Konstatim i pavlefshmërisë së vendimeve të ERE-s përkatësisht nr.69 dhe 70 datë 12.12.2007, etj....). Nga ana tjetër ERE është në proces gjyqësor në cilësinë e personit të paditur edhe me një konsumator me objekt padie: Shfuqizimi i pjeshëm i faturës së energjisë elektrike të muajit Qershor 2010, lëshuar nga OSSH sh.a, Drejtoria e Zonës Tirana 2.

6. Mbrojtja e konsumatorit nga efekti monopol i tregut

6.1. Parimet e mbrojtjes së konsumatorit

Kuadri rregullator mbi të cilin mbështetet e gjithë veprimtaria e ERE-se, i kushton një rëndësi të vecante mbrojtjes së interesave dhe garantimit të drejtave të atyre pjesëmarrësve të tregut që nuk kanë mundësinë dhe aftësinë e duhur për të njohur dhe për të patur aksesin e nevojshëm si në kuadrin ligjor ashtu edhe në aspektin teknik të funksionimit të tregut, duke u ekspozuar kështu ndaj shkeljeve të mundshme të drejtave të tyre nga efekti monopol i tregut të energjise.

Për këto arsye, fuqizimi i rolit aktiv të konsumatoreve në treg, mireinformimi dhe mbrojtja e interesave të tyre, në mënyrë të vecante të konsumatoreve familjare, është një nga sfidat më të rëndësishme dhe prioritetet kryesore të ERE-s. Fuqizimi i konsumatoreve konsiston në punën për :

6.1.1. Garantimin e Cilesise se Sherbimit te Shperndarjes dhe Furnizimit te energjise elektrike

Cilesia e sherbimit te furnizimit me energji elektrike, në mënyrë të vecante në kontekstin e procesit të privatizimit dhe të liberalizimit të sektorit të energjise elektrike, ze një vend të rëndësishëm të aktivitetin e Rregullatorit. Përcaktimi, matja dhe monitorimi i tyre është një nga ceshtjet më themelore ku është përqendruar aktiviteti i ERE-s gjatë këte viti.

Për këte qëllim, duke u mbështetur kryesisht në eksperiencën Europiane,

ERE, hartoi dhe publikoi Draftin e Rregullores per Cilesine e Sherbimit te Shperndarjes dhe Furnizimit te energjise elektrike, i cili ne aspektin e mbrojtjes se konsumatoreve, eshte nje nga dokumentat kryesore qe do te krijoje kushtet e nje sherbimi te garantuar per furnizim te panderprere (brenda limiteve te lejuar) me energji elektrike, te konsumatoreve ne sistemin e shperndarjes se energjise elektrike. Keto standarte percaktojne :

- rregullat per vazhdueshmerine e furnizimit me energji elektrike nepermjet evidentimit te nderprerjeve te energjise elektrike ne sistemin e shperndarjes si dhe klasifikimin e nderprerjeve
- rregullat e cilesise tregtare te sherbimit.
- treguesit dhe parametrat e cilesise se tensionit te energjise se furnizuar

6.1.2. Sigurimi transparences

ERE, gjate procedurave te miratimit te kuadrit rregullator, dhenien e licensave per veprimtarite e ushtruara ne sektorin e energjise, miratimin e tarifave te shitjes me pakice te energjise elektrike, si dhe procesin vendimarrës, (mbledhjet e Bordit te Komisionereve), bazuar ne Rregulloren e Praktikës dhe Procedurave zbaton kriterin e transparences dhe te konsultimit me palet e interesuara dhe me publikun.

Ne kete proces perfshihen publikimet e bera ne median e shkruar te vendimeve te ERE-s per fillimin e procedurave te shqyrtimit te aplikimeve per license, te tarifave, apo te hartimit te rregullores apo akteve te tjerave rregullatore, konsultimi me te licensuarit, palet e interesuara si dhe shoqatat qe perfaqesojne konsumatorët. Mendimet dhe verejtjet e tyre, analizohen dhe nepermjet nje procedure transparente iu behet e ditur te interesuarve qendrimi i ERE-se per marrjen parasysh apo jo te tyre.

Ketu do te permendim seancat degjimore publike te organizuara nga Instiucioni jone ne lidhje me shqyrtimin aplikimit te Kompanive publike per rishikimin e tarifave dhe cmimeve per vitin 2011, seanca te cilat jane konsoliduar tashme si nje institucion qe sigurojne maksimumin e transparences duke siguruar qe konsumatorët final te kete gjithë informacionin e duhur lidhur me sherbimin dhe koston me te cilen i sigurohet ky sherbim.

Gjithashtu dhe mbledhjet vendimarrëse te Bordit te Komisionereve te ERE-s jane te hapura per publikun, duke marre pjese ne to si perfaqesues METE, Kuvendi i Shqiperise, Autoriteti i Konkurences, perfaqesues te Kompanive publike si dhe subjekte te interesuar.

6.1.3. Garantimi i aksesit te paleve te treta ne rrjet

Lidhur me garantimin e aksesit te paleve te treta ne rrjetin e shperndarjes, roli i rregullatorit eshte te nxise hapjen e tregut ne menyre qe konsumatoret e energjise te perfitojne sherbime cilesisht me te mira nga konkurenca ne treg. Hapja e tregut shtyn kompanine te konkurroje per shtim te konsumatoreve duke u ofruar atyre sherbime te shpejta dhe te besueshme.


Ne kete drejtim, mund te permendim disa hapa te rendesishem te ndermarra nga ana e ERE-s per hapjen e tregut dhe garantimin e aksesit te paleve te treta ne rrjet, si psh : hapja e tregut per te gjithë konsumatoret jofamiljare dhe familjare, miratimin e tarifave te vecanta per sherbimin e transmetimit dhe te shperndarjes.

6.1.4. Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave te Konsumatoreve

Trajtimi i drejtperdrejte i ankesave te konsumatoreve te energjise elektrike, konsiderohet nga ana e ERE-se si nje nga treguesit kryesore, i cili kontribon ne monitorimin e cilesise se sherbimit qe ofron Furnizuesi nga kendveshtrimi i konsumatorit dhe qe sherben per identifikimin e problemeve konkrete te furnizimit me energji elektrike te klienteve.

Pamje nga workshopi me Rregullatorin Cek, Tirane





Trajtimi me perkushtim, transparence, paanshmeri dhe brenda afateve ligjore te ankesave te konsumatoreve, mbetet nje nga aspektet me te rendesishme te veprimtarise se ERE-se. Gjate vitit 2010, konstatojme nje rritje shume te ndjeshme te numerit te konsumatoreve qe i drejtohen drejtperdrejte ERE per zgjidhjen e ankesave te tyre, kundrejt Kompanise se Furnizimit. Kjo rritje deshmon per forcimin e autoritetit te ERE-se dhe ndergjegjesimin e konsumatoreve per rolin e ERE-s si nje autoritet i pavarur ne mbrojtje te interesave te konsumatoreve te energjise elektrike

Gjate vitit 2009 jane rregjistruar ne ERE rreth 80 ankesa, nga te cilat 50 ankesa nga kliente familjare, 25 nga kliente jofamiljare dhe 5 nga subjekte te licensuara.

Prane ERE-se u rregjistruan **rreth 350** per gjate gjithë vitit 2010. Ne kete numer nuk perfshihen konsultimet e bera me konsumatore te ndryshem qe i

jane drejtuar ERE, si dhe informacionet dhe orientimet e dhena nepermjet telefonatave apo e-mail.

Problematika kryesore e trajtuar gjate viti 2010, ka konsistuar ne:

- Aplikimi ne menyre te kunderligjshme nga ana e CEZ Shperndarje i “demit ekonomik” apo “energji e pamatur” per kundravajtesit e energjise elektrike.
- Trajtimi i ankesave lidhur me nderprerjet dhe cilesine e tensionit te energjise elektrike, te bera nga Komuna dhe subjekte te ndryshme.
- Probleme te mbifaturimit - qe konsistojne ne faturime dukshme te gabuara, mosrespektim te afateve te leximit te matesit;
- Probleme te matjes se energjise elektrike - Pajisje me aparat mates kryerjen e kontrollit te aparatit mates, mosrakordimi i vleres se faturuar aforfe me gjendjen reale te matesit.
- Probleme te lidhjes dhe transferimit te kontratave – vonesa ne lidhjen e kontratave, mostransferim te kontratave per objektet qe figurojne debitore.

Per sa i takon, aplikimit te “demit ekonomik” dhe “energji e pamatur”, ERE ka monitoruar dhe studiuar me kujdes të gjithë procedurën e ndjekur nga ana e CEZ Shpërndarje Sh.a. dhe ka konstatuar se aplikimi i «Dëmit Ekonomik» apo “Energji e Pamatur” është kryer në mënyrë abuzive dhe arbitrare pasi këto veprime nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, pasi me ndryshimet e bera ne Ligjin nr.9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, denimi i kundravajtesve te energjise elektrike sipas kesaj procedure, ishte shfuqizuar

Për këto veprime të pabazuara në ligj, ERE me vendimin nr. 90, datë 15.11.2010 të Bordit të Komisionereve, dënoi me gjobë në shumën 350 000 lekë kompaninë CEZ Shpërndarje Sha, “Për moszbatim të kushteve të përcaktuara në License dhe konkretisht të pikës 3.1, të Licensës për Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike”. Gjoha në fjalë i korrespondon shumës maksimale që ERE mund të vendosë për dënimin e shkeljeve të ndryshme që mundet të kryhen nga nje i Licensuar në bazë te nenit 64 të Ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar).

Në bazë këtij vendimi, të gjitha faturimet e kryera nga ana e CEZ Shpërndarje Sh.a. ndaj klientëve familjare dhe jofamiljare, me emërtimin “Dëm Ekonomik” apo “Energji e Pamatur” pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9997, datë 22.09.2008, u konsideruan të paligjshme dhe pas insistimit të ERE-s, Kompania CEZ krye anulimin total të tyre duke bere edhe publikimin ne Web dhe ne media. Procesi eshte ne monitorim nga ana e ERE-s.

Lidhur me problematikat e tjera te evidentuara, per trajtimin dhe zgjidhjen e tyre nga ana e ERE-se jane organizuar **rreth 40 seanca degjimore**, duke e grupuar problematiken. Ne keto seanca, jane ballafaquar shqetesimet e konsumatoreve me Kompanine dhe jane dhene udhezime nga ana e ERE-s te cilat jane te detyrueshme per Kompanine, per zgjidhjen e problemeve te konstatuara me konsumatoret.

Gjithashtu jane kryer ne prezence te konsumatorit qe ankohet dhe te Kompanise **kontrolle dhe verifikime per rreth 40 kliente qe kane paraqitur ankesen ne ERE**. Kerkesat per kontrolle dhe verifikime te sistemit te matjes jane shtuar shume gjate ketij viti dhe shtesa me kete ritem e ben te veshtire plotesimin e ketyre kerkesave nga ERE-e.

Do te permendim faktin se me kerkesen e ERE-se, eshte bere e mundur ngritja nga ana e CEZ-it, ne Tirane dhe ne Durres, te Qendrave te Kujdesit ndaj Klientit, te cilat vertet mund ti permendim si nje instrument i ri i Kompanise per te rregjistruar dhe zgjidhur ankesat e konsumatoreve, por duke qene ne nje faze fillestare, nga monitorimet kemi konstatuar se ka vonesa ne trajtimin e kerkesave dhe te ankesave te konsumatoreve, si rezultat i mosrakordimit ndermjet Departamenteve brenda Kompanise. Nepermjet takimeve te organizuara, Enti ka dhene rekomandimet e tij, per permiresimin e punes se ketyre qendrave, sipas eksperiencave me te perparuara te vendeve te zhvilluara, ne menyre qe te realizohet rregjistrimi dhe zgjidhja e shpejte e ankesave te konsumatoreve drejtperdrejte ne keto qendra, pa qene nevoja qe konsumatori ti drejtohet ERE-se apo Gjykatave. Jemi ne monitorim te vazhdueshme te ketij aktiviteti dhe do te mbajme edhe qendrimin e duhur ne lidhje me perfomancen e tyre.

Nje impakt ne sherbimin qe i ofrohet konsumatorit, sidomos pas e privatizimit te Kompanise se Shperndarjes, luan edhe zgjidhja e problematikes qe kane subjektet e subjektet e licensuara qe operojne ne tregun e energjise elektrike si dhe mosmarreshjet midis tyre. Ketu do te permendim trajtimin e mosmarreshjeve midis KESH Sh.a. - CEZ Shperndarje Sh.a. per problematika te ndryshme, CEZ - OST, CEZ – Furnizues. Nga ana ERE-se jane trajtuar edhe mosmarreshjet ndermjet HEC-ve te vegjel dhe KESH-it, per mosrakordim te sasise se energjise se prodhuar nga keto HEC-e dhe problematika te tjera te matjes se energjise se prodhuar etj..

Analiza e problematikave te verejtura tek ankesat e konsumatoreve, sherben per te bere permiresimet e nevojshme te kuadrit rregullator, me qellim permiresimin e sherbimit te ofruar per konsumatoret nga Kompania.

7. Mardheniet me publikun dhe median

7.1. Procedurat e informimit publik

Ne menyre qe te garantoje per nje publik te gjere dhe per mediat nje njohje me te thelle te veprimtarise se ERE-s dhe per te vleresuar me mire efikasitetin e perhapjes se mesazheve te saj, ERE nder detyrat kryesore ka ate te publikimit te informacionit per kushtet e kryerjes se sherbimeve nga Kompanite e licensuara ne sektorin e energjise, me qellim qe te garantoje transparence maksimale, ne funksion te permirosimit te sherbimeve te ofruara perdoruesve te rrjetit te energjise elektrike si dhe konsumatoreve finale.

Per te permbushur kete detyrim institucional dhe per te siguruar nje mbeshtetje te rendesishme ne strategjine e komunikimit, ERE ka rritur perpjekjet per informimin e konsumatoreve nepermjet zhvillimit te iniciativave te reja te komunikimit.

Veprimtaria e komunikimit e kryer nga ERE, i kane dhene prioritet aspekteve te ndryshme dhe kane konsoliduar imazhin e saj ne aktivitetin e rregullimit.

7.1.1. Maredheniet me median e shkruar dhe vizive

Per sa i takon aktivitetin me median e shkruar dhe vizive, pervec rritjes se raporteve te komunikimit, gjate kesaj periudhe eshte konsoliduar dialogu me median nepermjet realizimit te intervistave te shumta televizive, nderhyrjeve ne publik per shpjegimin e qendrimeve te ERE-s lidhur me ceshtje te ndryshme sensitive per publikun, si miratimi i cmimeve etj, realizimi i deklaratave te shpeshta per shtyp, ashtu edhe duke organizuar takime dhe mbajtur kontakte te vecanta me media e gazetare qe mbulojne kete sektor.

ERE gjithashtu prej 2 vjetesh ka maredhenie insitucionale me ATSH, ku kryen nje shkembim te rendesishem te informacionit me kete agjensi prestigjioze lajmesh.

Gjithashtu perfaqesues te ERE-s kane pjese ne emisione te ndryshme televizive per te informuar dhe sqaruar publikun mbi tema te vecanta me interes per konsumatorin ne te cilat eshte patur kujdes kryerja e komunikimit me nje gjuhe te thjeshte dhe te kuptueshme.

Jane forcuar gjithashtu maredheniet me strukturat e komunikimit te institucioneve kryesore si Parlamenti, Autoriteti i Konkurences, METE, etj.

7.1.2. Komunikimi nepermjet ngjarjeve dhe aktiviteteve

Eshte per tu evidentuar fakti se nga ana e ERE-s konsiderohen vecanerisht efektive organizimi dhe pjesemarrja ne aktivitetet te cilat organizohen ne kuader te mbrojtjes se konsumatoreve nga Organizata te ndryshme te mbrojtjes se konsumatoreve si brenda dhe jashte vendit. Keto takime sherbejne per te promovuar funksionet institucionale te ERE-s, si dhe detyrat e veprimet e saj ne drejtim te mbrojtjes se konsumatoreve.

Ketu do te permendim pjesemarrjen ne aktivitetet e Zyres per Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK) ne Tirane dhe vendosjen e maredhenieve institucionale me Konfindustrian, duke marre pjese ne menyre aktive ne Forumet dhe takimet e organizuara prej tyre.

Gjithashtu nje rol te rendesishem ne kete drejtim luan edhe pjesemarrja ne Grupin e Punes se Mbrojtjes se Konsumatorit te ECRB (Sekretariati i Komunitetit te Energjise ne Vjene), Forumet Sociale dhe Work Shop-et per Planet Sociale te Veprimit ne kuader te ECRB, ku prezanton iniciativat e ndermarra prej saj ne permiresimin e kuadrit rregullator te sektorit te energjise elektrike dhe merr pjese ne Benchmarket rajonale.

7.1.3. Komunikime me pjesetaret e tregut

ERE ka fuqizuar bashkebesedimin me pjesetaret e tregut ne sektorin e energjise elektrike, duke organizuar takime periodike me Kompanite Publike KESH, OST, CEZ Shperndarje. Do te permendim ketu edhe te licensuarit per prodhimin e energjise nga HEC te vegjel, te rinj dhe ata ekzistues, me Shoqaten e Tregtareve te Energjise, etj. Ne keto takime informohen dhe diskutohet me pjesetaret e tregut lidhur me kuadrin rregullator te miratuar nga ERE si per problematiken qe ata ndeshin gjate operimit ne treg.

7.1.4. Komukime te brendshme

Ne drejtim te komunikimit te brendshem, nje rendesi te vecante i eshte kushtuar shperndarjes se materialeve me karakter informues dhe komukimeve te ndryshme tematike me investitoret dhe persona te interesuar kryesisht mbi kuadrin rregullator lidhur me burimet e rinovueshme, eficences dhe kursimit te energjise si dhe mbi modalitetet e paraqitjes se ankesave.

7.1.5. Publikime institucionale

Me qellim qe te rrise transparencen per aktivitetin e kryer dhe te perhape imazhin e saj, ERE publikon ne menyre kartografike Raportin Vjetor te kryer ne Kuvendin e Shqiperise. Githashtu te gjithe vendimet dhe aktet e Entit Rregullator, publikohen ne Fletoren Zyrtare.

ERE kryen gjithashtu raportime ne Sekretariatit e Komunitetit te Energjise, Asamblese se MEDREG (Organizata e Rregullatoreve te Mesdheut), ERRA (Organizata e Rregullatoreve te Europes Juglindore), te cilat jane te aksesueshme online.

7.1.6. Komunikime ne Web

Si nje nga aktivitetet me strategjike per te zhvilluar nje aksion efikas ne drejtim te informimit te publikut, ERE ka zhvilluar komunikimin nepermjet faqes se saj ne Web. Kjo veprimtari konsiston si ne zgjerimin e permbajtjes se kesaj faqeje, ashtu edhe nepermjet propozimit te sherbimeve te reja. Web site i ERE-s, eshte pasuruar me materiale te reja, si kuadri rregullator i miratuar, vendimet e Bordit te Komisionereve te ERE-s, si dhe rubrika te reja - publikime dhe konsultime per publikun, ne te cilen gjate kesaj periudhe jane shtuar te gjitha materialet e aplikimeve te Kompanive per rishikimin e tarifave, relacionet e ERE-se qe kane sherbyer per marrjen e vendimeve, studimet e kryera (Studimi i Konsumit ne familje), etj.

Ky fakt konstatohet edhe me rritjen e korespondences qe ERE trajton online, ashtu dhe me pergjigjen e pyetjeve dhe kerkesave te shumta te konsumatoreve qe vine ne kete drejtim.

Gjithashtu nje informacion te pasur faqja e Web-it ka edhe ne gjuhen angleze, ne te cilen jane aksesibel te gjitha aktet dhe vendimet e miratuara nga ERE, si dhe informacione te tjera.

8. Marredheniet nderinstitucionale dhe nderkombetare te ERE-s

8.1. Konferenca per 15-vjetorin e ERE-s

Viti 2010 shenoi dhe 15 vjetorin e krijimit te Entit Rregullator te Energjise si institution rregullator i pavarur qe funksionon me ligj. Ne date 7 tetor 2010 me rastin e ketij pervjetori nen kujdesin e vecante te ERE-s u zhvillua Konferenca nderkombetare me titull: Sektori Shqiptar i Energjise, Sfidat dhe Roli Rregullator.

Ne kete Konference moren pjese rreth 100 te ftuar midis te cileve perfaqesues te larte te Qeverise Shqiptare, politikeberes, perfaqesues te Parlamentit Shqiptar, perfaqesues te Rregullatoreve ne rajon, ne Evrope e me gjere, perfaqesues te biznesit, medias dhe eksperte te larte te sektorit energjitik. Konferenca u pershendet dhe ndoq nga Ministri i Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes, autoritete te shquara kombetare e nderkombetare si: Presidenti i NARUC (Shoqata e Rregullatoreve te Amerikes), Kryetari i Sekretariatit te Komunitetit te Energjise

ne Vjene, Kryetari i ERRA-s, 25 Kryetare te Enteve Rregullatore te Evropes Juglindore, Zv/Kryetar i MEDREG (Shoqata e Rregullatoreve te Mesdheut), i cili eshte njekohesisht Kryetari i Autoritetit Rregullator te Italis, si dhe kompanite e fuqishme qe operojne ne sektorin e energjise si KESH, OSSH, OST dhe pjesetmarres e te licensuar te tjere ne sektor.

Ceshtjet kryesore ne kete konference perfshine; sigurine e furnizimit dhe aspektete rregullatore, eficiencen e energjise, furnizimin me gaz natyror dhe kuadrin neneligjor te tij, cilesine e furnizimit dhe mbrojtjen e konsumatoreve. Ne Konference u trajtuan dhe diskutua mbi ceshtje te rendesishme lidhur me rolin rregullator per sektorin e energjise ne Shqiperi, arritjet e tij dhe sfidat per te ardhmen e ketij sektori. Pasi u evidentua eksperiencia 15- vjecare e Entit Rregullator dhe arritjet e ketij institucioni ne zhvillimin e sektorit te Energjise elektrike, u theksua se ecja perpara e reformave ne kete sektor vendos sfida te reja ne sigurimin dhe permiresimin e cilesise se sherbimit te furnizimit me energji elektrike tekonsumatoreve si dhe ne plotesimin e kuadrit rregullator i cili do te ndihmoje zhvillimin dhe transformimin e vazhdueshem te ketij sektori nepermjet funksionimit eficient te tregut te energjise elektrike dhe zhvillimit te konkurrences ne kete sektor.

8.2. Veprimtaria nderinstitucionale dhe nderkombetare e ERE-s

Nje vend te rendesishme dhe vemendje te vecante ne veprimtarine e ERE-s per vitin 2010 ze zhvillimi i marredhenieve nderinstitucionale brenda vendit dhe marredheniet nderkombetare multilaterale dhe bilaterale.

Ne zhvillimin e marredhenieve nderinstitucionale nder te cilat mund te permendim marrdheniet me Kuvendin e Shqiperise, Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes (METE), Ministrine e Integritimit, Autoritetin e Konkurrences, Avokatin e Popullit, si dhe institucione te tjera ne vend.

8.2.1. Marredheniet e ERE-s me Kuvendin e Shqiperise

ERE gjate vitit 2010 ka vazhduar te ndjeke nje forme bashkepunimi dhe informimi periodik duke pasqyruar hap pas hapi veprimtarine institucionale ne zbatim te vendimit te Byrose se Kuvendit No 29 date 09.02.2008 "Per ngritjen e Sherbimit te Monitorimit te institucioneve qe raportojne dhe informojne Kuvendin". Ne kete kuader Keshilltarja e Kuvendit pergjegjese per kryerjen e ketij sherbimi ka ndjekur nga afer dhe eshte njohur ne menyre te hollesishme me veprimtarine e ERE-s, si dhe ka asistuar ne mbledhjet e Bordit te Komisionereve.

ERE e ka informuar Kuvendin mbi zhvillimet korente ne sektorin e energjise, ku pervec paraqitjes ne Kuvend te Raportit vjetor, ERE ka paraqitur informacion ne drejtim te ceshtjeve te mprehta qe kane te bejne me Tregun e Energjise, me hartimin e akteve nenligjore, me procesin e post-privatizimin si dhe per cmimet dhe tarifate e energjise elektrike. ERE ka qene dhe nje nga Institucionet qe ka mbajtur prezantim ne Kuvend ne Workshopin rajonal per Marredheniet e Kuvendit te Shqiperise me Institucionet e pavaruara ku dhe ka paraqitur natyren e ketyre marredhenieve bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Si dhe ka marre pjese ne

workshopin e organizuar nga Keshilli per Bashkepunim rajonal dhe Sekretariati i Komunitetit te energjise ne Kuvend.

8.2.3 Marredheniet e ERE-s me METE-n

ERE ka bashkepunuar me METE-n gjate vitit 2010 persa i perket zgjidhjes se ceshjeve dhe sfidave te ndeshura ne procesin e rregullimit te sektort te energjise ne Shqiperi.

ERE ka kontribuar qofte permes propozimeve te dala prej saj apo permes dhenies se opinionit per ndryshime e propozuara, qofte dhe nepermjet pjesemarrjes aktive ne Grupeve nderinstitucionale te Punes per rishikimin e Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te Projekt- Ligjit te energjive te rinovueshme, te Projekt-Ligjit te Koncesioneve, pergatitjen e rregullave dhe procedurave te lejuara per ndertimin dhe perdorimin e tubacioneve dhe infrastruktures se gazit natyror, ka marre pjese si dhe ne ceshtje te tjera qe kane te bejne me tregun e energjise elektrike, me te licensuarit dhe me te gjitha palet e pjesemarrrese ne sektorin e energjise ne Shqiperi.

Ne kuadrin e ngritjes dhe funksionimit te rregjistrimit elektronik te bizneseve ERE ka marre pjese ne workshopet e organizuara nga METE si dhe ka dhene kontributin e saj nepermjet hedhjes ne kete rregjister te akteve qe ERE miraton. Ne seantat e organizuara nga ERE , METE eshte therritur si perfaqesuese dhe ka dhene opinion mbi ceshtjet qe lidhen me kontraten e furnizimit me energji elektrike KESH-CEZ. ERE do te vazhdoje ta vleresoje dhe do ta kete nje nder perparesite e saj bashkepunimin me METE-n. ERE ka qene anetare e rregullt e Grupit te punes te ngritur nga METE per Plotesimin e Pyetesorit te BE-se Kapitulli mbi Energjine.

8.2.4. Marredheniet e ERE-s me Ministrine e Integritimit

Per vitin 2010 ERE ka komunikuar dhe bashkepunuar me Ministrine e Integritimit ne drejtim te perditesimit me informacion te Planit kombetar per zbatimin e Marrveshjes se Stabilizim Asociimit per periudhen 2010-2014. ne kete kuader ERE ka rishikuar aktet e parashikuara ne PKZMSA dhe ka dhene kontributin e saj ne drejtim te plotesimit te kerkesave qe vijojne nga Direktivat e BE-se. Konkretisht ne perputhje dhe ne plotesim te Direktives 54/2003, ne kuader te Traktatit te Komunitetit te Energjise.

8.2.5. Marredheniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrences

Ne vijim te mardhenieve te ERE-s me Autoritetin e Konkurrences bazuar ne marrdhenien e Institucionalizuar mes ketyre dy institucioneve ne kuader te Memorandumit te Mirekutimit te nenshkruar mes ERE-s dhe Autoritetit te Konkurrences qe prej dates 17.01.2007, gjate vitit 2010 eshte bashkepunuar per shmangien e shkeljes se konkurrences nga operatoret, duke krijuar rregulla konkurruese ne mbrojtje te interesave te konsumatoreve. ERE ka kerkuar rregullisht mendimin e Autoritetit per aktet nenligjore qe lidhen me zhvillimin e tregut te energjise perpara se te miratohen nga ERE, ne procesin e llogaritjes se tarifave dhe cmimeve te energjise elektrike, ne percaktimin e analizave se rishikimit

te nivelit të humbjeve etj. ERE ka marrë pjesë në seancat që ka zhvilluar Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të hetimeve dhe investigimeve për sektorin e energjisë elektrike duke shprehur qendrimin e saj dhe duke sqaruar çeshjet e këtij tregu si dhe marrëdhëniet kontraktuale. Po kështu ERE i ka dërguar të gjitha aktet e saj nënligjore Autoritetit të Konkurrencës për dhenie mendimi përpara miratimit të tyre. Si dhe ka ndjekur workshopet e organizuara nga ky institucion mbi analizat statistikore. Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe të dhënat ndërmjet të dy institucioneve do të vijojnë dhe në të ardhmen bazuar në një vullnet të gadishmeri të ndërsjellte.

8.2.6. Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit

Keto dy institucione kanë një angazhim të ndërsjellte institucional që është mbrojtja e konsumatorëve të energjisë elektrike.

Në këto kuadër, ERE ka mbajtur marrëdhënie të afërta institucionale me Avokatin e Popullit duke kryer dhe takime të përbashkëta në drejtim të shkëmbimit të mendimeve dhe dhenies së sqarimeve të nevojshme për cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, për procesin e vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe për kontratat e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve. Institucioni i Avokatit të Popullit do të përfshihet gjithnjë në të gjitha procedurat dhe seancat degjimore që do të zhvillohen vecanerisht për tarifën e energjisë elektrike dhe kontratat e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

8.2.7. Marrëdhëniet ndërkombëtare

Duke patur gjithnjë në fokus forcimin institucional, rritjen e njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj, përfaqësimin e vendit në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare, përputhjen dhe eharmonizimin e praktikave në ndjekje të praktikave të vendeve të BE-së, si dhe në vlerësimin e vendosjes së bashkëpunimeve të frytshme në dobi të sektorit të energjisë në vend. Duke patur në konsideratë keto qëllime, ERE ka vazhduar marrëdhëniet multilaterale me organizata ndërkombëtare si ERRA, MEDREG, NARUC, Sekretariati i Vjenës etj. si dhe ka vendosur marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore si motra, si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare lidhur me energjinë.

8.2.8. Marrëdhëniet multilaterale të ERE-s:

- ERE si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) merr pjesë në takimet e Asamblese së Përgjithshme të Kryetareve të ERRA-s, takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve, si dhe të Grupit të Punes mbi çështjet ligjore që zhvillohet në vendet anëtare të ERRA-s. ERE gjithashtu ndjek dhe trajnimet e organizuara nga ERRA, të cilat gjatë vitit 2010 kanë konsistuar në trajnimin për tregjet e energjisë dhe tarifën, në trajnimin e stafin e ri të rregullatorëve. Këto vit në datë 8 Tetor 2010 me mbështetjen dhe nën kujdesin e ERE-s u zhvillua në Tiranë takimi i rradhës i Kryetareve të ERRA-s ku morën pjesë rreth 25 Kryetare të Enteve Rregullatore të

Evropes Juglindore dhe EuroAzise, ky takim u ndoq dhe nga Presidenti i NARUC, perfaqesues te Fortum, KEMA etc. Ne kete takim u shkembye informacion mbi zhvillimet ne te fundit dhe sfidat qe shfaqen para rregullatoreve prezent, si dhe u diskutua per ceshtje te tjera te rendesishme si efienca e energjise dhe siguria e furnizimit ne keto vende.

- ERE si anetare e Shoqates se Rregullatoreve te vendeve te Mesdheut per energjine elektrike ka pjesemarrje aktive ne takimet e grupeve te punes per energjite e rinovueshme dhe ceshtjet e gazit, si dhe takimet e Asamblese se Pergjithshme te saj. Kjo eshte nje mundesi e vlefshme ne drejtim te njohjes se e mundesive dhe potencialeve energjetike te Vendeve te Mesdheut dhe vendosjes se nje klime mirekuptimi dhe bashkepunimi te rregullatoreve te ketyre vendeve per ceshte te interesit te ndersjellte te tyre.
- ERE ne bashkepunim me NARUC (Shoqata e Enteve Rregullatore te SH.B.A-se) dhe me mbeshtetjen financiare te USAID, ERE ka zhvilluar ne Mars te vitit 2010 nje aktiviteti partnershipi ne fushen e gazit natyror, ne Rregullatoret e Washingtonit, Bostonit dhe Ohajos. Kjo eksperience u vleresua si nje ndihmese per ERE-ne hartimin e akteve nenligjore per rregullimin e sektorit te gazin natyror.
- ERE ne kuader te Traktatit te Komunitetit te Energjise gjate vitit 2010 ka marre pjese aktive ne Forumet e Athines dhe aktivitetet e Komunitetit te Energjise te organizuara nga Sekretariati i Vjenes. Ka bashkepunuar se afermi me kete Sekretariat duke ndjekur takimet e rregullta te Grupeve te Punes per ceshtjet e konsumatoreve, te energjise dhe tregut rajonal te energjise, si dhe gazit natyror.

Pamje nga raportimi i ERE ne Kuvend (Mars 2010)





Ne Konferencen e
Kryetareve te
Rregullatoreve te
ERRA, Budapest

Gjithashtu ERE ka marre pjese dhe ne trajnimet dhe workshopet e organizuara nga ky Sekretariat per cilesine e sherbimit, paketen e trete legjislative dhe modelet e tregut te energjise dhe gazit natyror. Gjithashtu me iniciativen e ERE-s eshte zhvilluar ne Tirane nje workshop mbi modelin e tregut te gazit ne bashkepunim me Sekretariatit e Vjenes, dhe ku organizem ka qene pjese aktive me komentetet dhe sygjerimet e tij per legjislacionin sekondar qe ERE po harton per sektorin e gazit natyror ne Shqiperi. Duke perfituar nga keto aktitete dhe eksperienca e rregullatoreve me te perparuar evropiane synohet harmonizimi i legjislacionin, praktikat dhe procedurat me qellim krijimin e një tregu rajonal të energjisë, transparent, konkurues, jo diskriminues dhe me akses te barabarte per te gjithë pjesmarresit.

8.2.9. Marredheniet bilaterale te ERE-s

Marredheniet bilaterale te ERE-s per vitin 2010 kane synuar forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e bashkepunimeve te frytshme ne dobi te sektorit te energjise ne vend. Ne kete kuader ERE ka punuar ne drejtim te

bashkepunimit bilateral bazuar ne marreveshjeve bilaterale, ku mund te permendim ate te nenshkruar me Entin Rregullator Italian, me te cilin jane kryer gjate vitit dy workshope te ndersjellta me qellim shkembimin e eksperiences per tarifat, legjislacionin dhe ceshtjet e tregut. Po keshtu eshte ri-nenshkruar marrveshja me Rregullatorin e Turqise ne Tirane duke shtuar si fushe bashkepunimi pervec energjise elektrike dhe ate te gazit natyror. Dhe per vitin qe vjen do te planifikohen veprimtari konkrete per te perfituar nga eksperiencia e Rregullatorit turk ne sektorin e gazit natyror. ERE gjithashtu ka bashkepunuar dhe me mbajtur marrdhenie te aferta me shume institucione rregullatore te rajonit e me gjere sic mund te permendim Rregullatoret e Kosoves, Maqedonise, Çekise etj; Me kete te fundit eshte organizuar ne Tirane dhe nje workshop Ne aktivite e perbashketa me keta rregullatore theksi eshte vene ne ceshje te mprehta qe lidhen me eksperiencen e procesit te post-privatizimit dhe rregullimin e tregut te energjise, si dhe eshte kerkuar mbeshtetje teknike nepermjet organizimit te vizitave studimore dhe kualifikimeve ne drejtim te ngritjes profesionale te stafit te Rregullatorit.

8.2.10. Pjesemarrja ne konferenca dhe aktivite nderkombetare

Persa i perket pjesemarrjes se ERE-s ne konferenca dhe aktivite nderkombetare, gjate vitit 2010 i dukshem ka qene interesi i ERE-s per tu njohur me eksperiencat energjitike evropiane dhe me gjere ne shkalle boterore nepermjet pjesemarrjes se saj ne aktivite nderkombetare ku mund te permendim Forumet Evropiane per Energjine dhe Gazin, Konferencat Evropiane dhe te Evropes Juglindore per Energjite te rinovueshme, Konferencen e Investimeve per energji ne vendet e Evropes Juglindore, Forumin e KransMontanes, Forumin e Mesdheut per Energjine, Konferencat per tregjet Evropiane dhe Konferencat e organizuara per ceshtjet e gazit ne vendet e rajonit, si dhe ne workshopet e organizuara mbi rolin e rregullatoreve ne ceshtjet e energjive te rinovueshme, eficiences se energjise dhe sigurise se furnizimit.

Pjesa e Trete

Veprimtaria financiare e ERE-s gjate vitit 2010 dhe Raporti i Auditit Kontabel te Regjistruar

Shenimet Shpjeguese

Te pergjithshme:

ERE eshte nje institucion publik qe operon ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe si e tille aplikon rregullat e percaktuara nga Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

ERE eshte nje institucion publik qe operon ne varesi direkte nga Kuvendi I Shqiperise me funksion rregulator te operatoreve qe prodhojne, transmetojne e shpermdajne energjine elektrike dhe gazin natyror. ERE nuk financohet nga buxheti i shtetit, por e realizon funksionin e vet nepermjet te ardhurave qe vijne nga kuotat e paguara nga operatorët e tregut. Administrimi I fondeve behet ne menyre rigoroze nepermjet hartimit e zbatimit te buxhetit vjetor ne vazhdimesi nga "Drejtoria e Burimeve Njerezore, Administrim Finances..." si dhe kontrollit nga Drejtimi I Larte. ERE aplikon metoden e kontabilitetit me Baza Monetare, te modifikuar ne fund te vitit per detyrimet ndaj shtetit dhe amortizimin.

Spjegime per zerat e Bilancit:

Shenimi 1

Shifra 27.589.928,52 Leke perfaqeson gjendjen ne ilogarite bankare si me poshte:

		BKT		kursi 31.12.2010	
Banka ne Dollare	ALL	48,351.68		464.92 \$	104 lek/dollar
Banka ne GBP	ALL	-	£	-	
Banka ne Euro	ALL	1,017,442.01		7,331.86 €	138,77 lek/euro
Banka ne Leke	ALL	23,666,579.18			
Tirana Bank					
Banka ne Dollare	ALL	-			
Banka ne GBP	ALL	-			
Banka ne Euro	ALL	-			
Banka ne Leke	ALL	1,107,555.65			
Fond i ngurtesuar (limit kreditimi per 5 karta)	ALL	1,750,000.00			
	ALL	27,589,928.52			

Shenimi 2

Arkat jane mbyllur me gjendjen zero. Teprica e fundit te vitit eshte derdhur ne banke.

Ne Dollare	-
Ne Euro	-
Ne Leke	-

Shenimi 3

Llogaria "Debitore & Kreditore te Tjere" eshte zvogeluar per shumen 40.054,5 Leke shifer e mbartur nga viti 2009 dhe e arketuar gjate vitit 2010.

Shenimi 4

Shifra 1.595.613,73 Leke perfaqeson gjendjen e materialeve te konsumit te biera brenda buxhetit te vitit 2010.

Shenimi 5

Shuma 1.079.162,54 Leke perfaqeson gjendjen e inventarit ne perdorim.

Shenimi 6

Aktivet Afatagjata Materiale jane paraqitur ne bilanc me vleren e tyre neto. Pasqyra e Aktiveve dhe Amortizimit tregon ndryshimet e ilogarive te ketij grupi si dhe vleren e amortizimit te ilogaritur. Llogaria "Ndertesa" ka nje rritje per vleren e investimit te filluar, si faze studimore (vlera ne bilanc 223.858 ALL), ne vitin 2009 dhe te perfunduar ne Prill 2010 (ne vlere 3.945.812 ALL). Ajo perfaqeson nje rikonstrukcion te godines se zyrate te administrates, ne pronesi te Ministrise se Ekonomise, por ne perdorim (kontroll) nga ERE.

Shenimet Shpjeguese

Shenimi 7

Ne grupin e detyrimeve ndaj te treteve jane perfshire:


Detyrimet per pagat eDhjetorit te punonjesve	2,182,621.00	Leke
Detyrimet ndaj shtetit per Sigurime Shoq.Shend.(Dhjetor)	646,730.00	Leke
Detyrimet ndaj shtetit per tatimin mbi te ardhurat(pagat Dhjetor)	820,294.00	Leke

Shenimi 8

Ne zerin Kapitali ka nje rritje nga viti I meparshem qe perfaqeson nje tejkalim te te ardhurave te realizuara ndaj shpenzimeve te vitit.

Drejtores e Burimeve Njerezore, Administrim Finance
dhe Marredhenie me Jashte

Aldrita Bushi



KRYETARI ERE-s

Bujar Nepravishta






Tel: 069 22 42 198
e-mail: lidapune@yahoo.com

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Z.Bujar Nepravishta
Kryetar i Entit Rregullator te Energjise,
Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Ne kemi audituar llogarite vjetore te ERE-s qe perbehen nga Bilanci Kontabel i dates 31.12.2010 dhe Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve per ushtrimin e mbyllur ne kete date.

Pergjegjesite e Drejtimit per Pasqyrat Financiare.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave Financiare ne perputhje me:

- Standartet Kombetare te Kontabilitetit
- Ligjin 9072, date 22.5.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", te ndryshuar, dhe Ligjin 9946, date 30.06.2008 "Per Sektorin e Gazit Natyror", qe rregullojne veprimtarine e pergjithshme te ERE.

ERE eshte nje Person Juridik Publik dhe eshte autoriteti i vetem rregullator ne Shqiperi ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror. Pra ERE eshte nje institucion publik dhe si i tille nuk synon rezultatet fitimprures. Por ne te njejten kohe ERE nuk eshte nje institucion buxhetor, ajo Nuk Financohet nga Buxheti i Shtetit. Shpenzimet administrative per funksionimin e ERE-s perballohen nga kuotat monetare qe i paguajne Operatoret e Sektorit te Energjise Elektrike dhe Gazit, ne menyren dhe shumat e percaktuara ne Ligj.

Ne perputhje me karakteristikat e mesiperme, Objektivi kryesor i kontabilitetit te ERE-s eshte te siguroje miradministrimin e fondeve dhe aktiveve te veta ne sherbim te qelimit te saj. Kjo gje realizohet nepermjet hartimit, ndjekjes dhe raportimit te sakte te Buxhetit te Institucionit, te miratuar nga Bordi i Komisionereve.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte te shprehim nje opinion mbi kete bilanc, bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u be duke respektuar teknikat profesionale dhe etike me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese ky bilanc nuk permban anomali materiale. Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te dhene bazat per opinionin tone te auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tone, Bilanci financiar dhe Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve paraqesin ne menyre te plote, te sinqerte dhe me vertetesi, ne te gjitha aspektet materiale, gjendjen e Aseteve, Burimet e krijimit te tyre, te ardhurat dhe shpenzimet e ERE-s ne daten 31.12.2010.

Elida MITI
EKSPERT KONTABEL I RREGJISTRUAR

Tirane me 22.02.2010

1

Pjesa e Katert

Perfundime dhe Rekomandime

Duke sintetizuar nga analiza e pasqyruar ne kete raport vjetor, disa perfundime dhe rekomandime, te cilat ERE i vlereson me shume rendesi per tu evidentuar dhe per te sherbyer si pika orientimi ne te ardhmen, per fokusimin e veprimtarive ne sektorin e energjise.

Sfidat kryesore me te cilat ballafaqohet sektori i energjise ne vendin tone eshte e domozdoshme qe ne radhe te pare te njihen mire nga te gjitha nivelet e interesuara dhe te te realizohet nje angazhim i harmonizuar i te gjitha paleve ne menyre qe ato te parballohen me sukses.

ERE si nje institucion ekspertize shteterore e ka per detyre ti analizoje dhe ti evidentojte ato, ne menyre qe duke koordinuar veprimet, te arrihet shkalla e kerkuar e suksesit.

ERE e vlereson si nje arritje shume te rendesishme gjate vitit 2010 konsolidimin e metejshem te furnizimit pa nderprerje te konsumatoreve me energji elektrike. Viti 2010 vleresohet nga ERE si viti me furnizimin me te mire historik te vendit me energji elektrike. Konsumi i ketij viti shpreh gjithashtu edhe kerkesen reale per energji elektrike dhe sherben si nje pike e forte mbeshtetje per planifikimin e nevojës per energji elektrike ne te ardhmen.

Viti 2010, shenon mbas 12 vitesh, qe nga viti 1998, kthimin e vendit tone nga nje vend importues neto i energjise elektrike ne nje vend eksportues. Gjate vitit 2010 u eksportuan 2.93 TWh energji elektrike, nga e cila u realizuan rreth 120 Milion € te ardhura.

Gjate vitit 2010 u realizua nje ulje prej 3.58% e nivelit te humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje, nga niveli 33.92% ne vitin 2009 ne 30.34% ne vitin 2010. Me gjith kete permiresim i cili duhet te konsolidohet dhe te vijoje me tempe te larta edhe ne te ardhmen mbasi sfida themelore mbetet sfida per te rritur me ritme te shpejta eficiencen e konsumit te energjise elektrike. Humbjet e pergjitheshme te energjise elektrike prej 30.34% dhe niveli i arketimeve prej 77.4%, gjate vitit 2010, jane tregues te nje efience shume te ulet te konsumit te energjise elektrike, e cila vleresohet me 53.9%.

Duke qene se 97% e humbjeve te pergjitheshme jane humbje ne sektorin e shperndarjes se energjise elektrike, te cilat per vitin 2010 u raportuan 30.34%, sfida per rritjen e efienes ne konsumin e energjise elektrike perben sfiden kryesore ne veprimtarine e OSSH-se ne vitet qe vijne.

Gjate vitit 2010, ne perputhje me kerkesen e Deklarates Rregullatore, u krye nga nje kompani e njohur konsulente (Price Waterhouse) studimi per vleresimin e nivelit te humbjeve teknike ne shperndarje. Niveli i humbjeve teknike ne shperndarje rezultoi nga studimi 15.2% e nivelit te humbjeve te pergjitheshme ne shperndarje, per pasoje, per her te pare u arrit te percaktohet ne rruge shkencore

ndarja e nivelit të humbjeve teknike nga ato jo teknike. Në këto mënyra, për vitin 2010, duke qenë se humbjet teknike vlerësohen 15.2% dhe humbjet totale në shpërndarje 30.34%, humbjet jo teknike rezultojnë 15.14%.

Në 30 Prill 2010, CEZ Shpërndarje deklaroi përfundimin e kompletimit të konsumatoreve tarifor me matës të energjisë elektrike dhe u hoq ligjerisht, duke filluar nga 1 Maji 2010 i ashtuquajtur "faturim aforfe".

Nga pikpamja hidrologjike viti 2010 vlerësohet si një vit i jashtëzakonshëm, me reshje dhe prurje të lumenjve me një shkallë sigurije rreth 2%.

Nga pikpamja energjetike ky vit u shoqërua me një prodhim të jashtëzakonshëm të energjisë elektrike prej mbi 7.7 TWh, vetëm nga HEC-et publik, privat dhe me konncension.

Nga pikpamja mjedisore ky vit u shoqërua me permbytje në shumë rajone të vendit por në mënyra të vecante në Ultesirën e Shkodrës dhe Lezhës.

